

Janar 2015
Numri: 82
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro




SPROVA E PASURISË



Arsyeja dhe Filozofia

IRI



Një notar profesionist mund të notojë në ujëra të thella pa frikë, duke shijuar në këtë mënyrë bukuritë nënujore. Nuk ka asnjë problem për një besimtar cilësor, i cili ka njohuri të mjaftueshme rreth fesë së tij, të shëtisë nëpër kulturat e popujve të tjerë. Problem është të notosh në ujëra të thella pa ditur not. E rrezikshme është të përballesh me kulturat, botëkuptimet dhe rrymat e tjera filozofike, pa pasur njohuritë e duhura rreth Islamit. Në këtë rast ekziston rreziku për të mbetur nën ndikimin e tyre.

Një tjetër problem që ka sjellë filozofia, është përpjekja e disa pseudofilozofëve dashamirë dhe admirues të filozofisë perëndimore, për ta bazuar mendimin islam mbi themele filozofike. Kjo është një përpjekje tinëzare për të vendosur arsyen mbi shpalljen hyjnore.

TË
RËNË



SHQIPËRI: Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"; Shkodër; Shqipëri | Mob: +355 67 607 8484 | E-mail: rev.etika@gmail.com

KOSOVË: Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin; Prizren; Kosovë | Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI: Drvarska 28; Stara Carsija; Skopje; Makedonija | Mob: +389 7042 8245

Njeriu, duhet të zotërojë psikologjinë e sprovës në çdo marrëdhënie që ai ka me pasurinë. Kjo është ajo që pret Islami prej tij.

Pikësëpari, çfarë është pasuria? Marrëdhënia me pasurinë, është marrëdhënie prone apo amaneti?

Cila është forma e përfitimit të pasurisë me të cilën është i kënaqur Krijuesi?

A mund të shpenzohet pasuria jashtë kënaqësisë së Zotit?

Çfarë kujdesi kërkon marrëdhënia midis besimit në botën tjetër dhe pasurisë?

Çfarë ndjenje i jep myslimanit zotërimi i pasurisë në kuadrin e përgjegjësisë ndaj shoqërisë në të cilën jeton?

Po, të gjitha këto, kërkojnë një pjekuri shpirtërore.

Kurani, e përmend, e analizon dhe e korrigjon gjendjen psikologjike të njeriut në marrëdhënie me pasurinë, në momentin kur ai e dhuron atë, pra, gjendjen e ndjenjave që përjeton kur po ia jep dikujt tjetër pasurinë.

Për shembull, të lexojmë këtë ajet:

"O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në Allahun dhe Ditën e Fundit. Ai shëmbëllen me një gur të lëmuar e të mbuluar me dhé, mbi të cilin bie shi me rrebesh dhe e lë të zhveshur. Ata nuk kanë kurrfarë dobie nga veprat që kanë bërë, sepse Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin mohues." (Bekare, 264)

Këtu, Allahu i Madhëruar vë gishtin mbi ata që e shpenzojnë pasurinë për t'u dukur dhe kur e bëjnë këtë, i fyejnë e i lëndojnë nevojtarët. Madje ata nuk besojnë as në Allahun dhe as në Ditën e Fundit. Për rrjedhojë, mirësia që bën njeriu, i cili nuk i beson këto dy kushte të besimit, shkon dëm dhe ai nuk përfiton asgjë prej saj. Një dhurim i tillë, kthehet në diçka e cila fshihet siç fshin shiu dheun mbi një gurë të lëmuar.

Për këtë arsye, kur të dhurojmë, brenda nesh nuk duhet të gjendet asnjë lloj ndjenje fyese dhe lënduese. Pra, duhet të dhurojmë duke e pastruar zemrën nga këto ndjenja.

Në vazhdim të këtij ajeti, përshkruhet një lloj tjetër individi dhe krejt i kundërt:

"Ata që shpenzojnë pasurinë e vet për të kërkuar kënaqësinë e Allahut dhe që e forcojnë veten me punë të mira, shëmbëllojnë me një kopsht të mbjellë në rrafshnaltë, në të cilin bie shi i bollshëm, andaj jep fruta dyfish. Nëse nuk i bie shi i bollshëm, i bie shi i imët që i mjafton. Allahu i sheh mirë punët që bëni ju." (Bekare, 265)

Një, ndjenja për të fituar kënaqësinë e Allahut, dy, përpjekja për të forcuar bujarinë e shpirtit... Kur dhurohet me këto dy ndjenja, begatohesh si pronari i një toke në majë të malit, e cila vaditet nga shira të bollshëm.

Besimtar, është njeriu në zemrën e të cilit është e gjallë ndjenja e bujarisë; njeriu që nuk ka frikë nga bujaria; ai që nuk kaplohet nga shqetësimi i harxhimit të pasurisë.

Përmbajtja



12




10

Sprova e myslimanit me pasuri
Prof. dr. Hasan Kamil Jellmaz



34

Shpërdorimi i kohës
Osman Nuri Topbash



30



22

Të sprovuarit me pasuri
Aishe Shener

5 Psikologjia e sprovës

Ahmet Tashgetiren

14 Shejtani dhe nefsi

Prof. dr. Sulejman Derin

16 Sprova e pasurisë

Prof. dr. Mehmet Gërmez

19 Mendja e munguar

Muhammed Gazali

20 Këmisha prej zjarri

Idris Arpat

25 Njeriu dhe bota tjetër


Duran Ekizer

26 Toleranca

Ali Riza Temel

28 Kibla e zemrës, Kibla e trupit


Ibrahim Arpaxhë



56

Kuptimi i jetës 30
Semih Jollaçan
Një Ajet - Një Hadith 32

Dhikri 42
Salih Zeki Meriç
Si u bënë sahabë? 46
Adem Saraç
Sa bukur është të duash 47
Sadik Dana
Ebu Seleme Mahzumi (r.a.) 48
Mustafa Erish
Asketizmi dhe pasuria 50
Nuredin Nazarko
Karzi Hasen 52
Ahmet Basher
Ndriçimi i ajeteve përgëzues 54
Xhafer Durmush
Besimtari është njeri i angazhuar 56
Nuredin Jëlldëz



39

**Strehohem tek Allahu
prej shejtanit dhe djallëzive**
Prof. dr. Omer Çelik



44

Edukimi fetar dhe këndimi i Kuranit
Nurullah Dag



Psikologjia E SPROVËS

Ahmet Tashgetiren

Marrëdhënia e njeriut me Islamin, në fakt është një marrëdhënie e cila përfshin të gjithë jetën e tij psikologjike. Marrëdhënie zemre. Marrëdhënie ndjenjash. Nëse nuk ka mangësi në planin ndjenjë-zemër, edhe punët që bëjmë me duart, këmbët, sytë, veshët, pasurinë dhe jetën tonë, fitojnë vlerën e një “vepre” pa mangësi.

Thelbi i pa mangësisë, është bërja e punës “për hir të Allahut”. Dhe për këtë, duhet që ndjenja se “*ne i takojmë Allahut*”, të ketë formuar të gjithë botën e vetëdijes sonë.

Jeta është amanet,

Pasuria është amanet,

Fëmija është amanet,

Dhe të gjitha mundësitë e forcat tona janë amanet.

Janë amanet, sepse çdo mundësi që hyn në jetën e njeriut, është një dhuratë hyjnore. Ato janë dhënë

veç për një periudhë kalimtare. Më vonë, një ditë do të kërkohet llogari në lidhje me faktin se si janë përdorur ato.

Pajisja me këtë lloj psikologjie, është e pashmangshme për myslimanin. Ose e thënë ndryshe, aq sa e shëndetshme është pajisja me këtë lloj psikologjie, aq e shëndetshme është edhe marrëdhënia e myslimanit me të gjitha këto dhurata hyjnore, pra marrëdhënia në respektimin e amanetit.

Nëse kjo psikologji pëson dëme, edhe njeriu pëson lëkundje dhe përplasje në lidhje me drejtimin e jetës, pasurisë, fëmijës dhe të gjitha mundësive të tjera që ka në dorë.

Thënia se “*shejtani bëhet ortak i njeriut në pasurinë dhe fëmijët e tij*”, është një paralajmërim hyjnor. Pra, shejtani mund t’ia vjedhë fëmijën apo pasurinë njeriut, sepse ai e lë hapur derën. Madje, më tepër se vjedhja, Kurani flet për “ortakëri”. Pra, në një farë kuptimi, për bashkëpunimin midis shejtanit dhe njeriut

që ka fëmijë dhe pasuri...

Njeriu, duhet të zotërojë psikologjinë e sprovës në çdo marrëdhënie që ai ka me pasurinë. Kjo është ajo që pret Islami prej tij.

Pikësëpari, çfarë është pasuria? Marrëdhënia me pasurinë, është marrëdhënie prone apo amaneti?

Cila është forma e përfitimit të pasurisë me të cilën është i kënaqur Krijuesi?

A mund të shpenzohet pasuria jashtë kënaqësisë së Zotit?

Çfarë kujdesi kërkon marrëdhënia midis besimit në botën tjetër dhe pasurisë?

Çfarë ndjenje i jep myslimanit zotërimi i pasurisë në kuadrin e përgjegjësisë ndaj shoqërisë në të cilën jeton?

Po, të gjitha këto, kërkojnë një pjekuri shpirtërore.

Në Kuran, gjenden ajete të panumërta të cilat përcaktojnë kornizën e pjekurisë shpirtërore në lidhje me këtë çështje. Një pjesë prej këtyre, po përpikemi t'i japim këtu nën tre kategori: "Psikologjia e dhurimit – Paralogjizmi" se pasuria të bën të përjetshëm – Kalimi i kufijve në pretendimin e të qenit i vetmjaftueshëm, pra të mos kesh nevojë për Allahun.

Nëse e shohim Kuranin në këtë mënyrë, në zemrën tonë do të pasqyrohen të gjitha elementet e personalitetit të një myslimani në çdo fushë të jetës. Pra, eja të shohim se ku është vendi ynë brenda kësaj kornize psikologjike që ka sjellë Kurani:

Psikologjia e dhurimit

SI NJË SHËTITJE NË NJË PALLAT PREJ XHAMI

Një, ndjenja për të fituar kënaqësinë e Allahut, dy, përpjekja për të forcuar bujarinë e shpirtit... Kur dhurohet me këto dy ndjenja, begatohesh si pronari i një toke në majë të malit, e cila vaditet nga shira të bollshëm.

Kurani, e përmend, e analizon dhe e korrigjon gjendjen psikologjike të njeriut në marrëdhënie me pasurinë, në momentin kur ai e dhuron atë, pra, gjendjen e ndjenjave që përjeton kur po ia jep dikujt tjetër pasurinë.

Për shembull, të lexojmë këtë ajet:

"O besimtarë! Mos i çoni dëm lëmoshat tuaja duke ua kujtuar ato (atyre që ua keni dhënë) dhe duke fyer, siç vepron ai që e shpenzon pasurinë e vet për sy e faqe të botës dhe nuk beson në Allahun dhe Ditën e Fundit. Ai shëmbëllen me një gur të lëmuar e të mbuluar me dhé, mbi të cilin bie shi me rrebesh dhe e lë të zhveshur. Ata nuk kanë kurrfarë dobie nga veprat që kanë bërë, sepse Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin mohues." (Bekare, 264)

Këtu, Allahu i Madhëruar vë gishtin mbi ata që e shpenzojnë pasurinë për t'u dukur dhe kur e bëjnë këtë, i fyejnë e i lëndojnë nevojtarët. Madje ata nuk besojnë as në Allahun dhe as në Ditën e Fundit. Për rrjedhojë, mirësia që bën njeriu, i cili nuk i beson këto dy kushte të besimit, shkon dëm dhe ai nuk përfiton asgjë prej saj. Një dhurim i tillë, kthehet në diçka e cila fshihet siç fshin shiu dheun mbi një gurë të lëmuar.

Për këtë arsye, kur të dhurojmë, brenda nesh nuk duhet të gjendet asnjë lloj ndjenje fyese dhe lënduese. Pra, duhet të dhurojmë duke e pastruar zemrën nga këto ndjenja.

Në vazhdim të këtij ajeti, përshkruhet një lloj tjetër individ dhe krejt i kundërt:

"Ata që shpenzojnë pasurinë e vet për të kërkuar kënaqësinë e Allahut dhe që e forcojnë veten me punë të mira, shëmbëllojnë me një kopsht të mbjellë në rrafshnaltë, në të cilin bie shi i bollshëm, andaj jep fruta dyfish. Nëse nuk i bie shi i bollshëm, i bie shi i imët që i mjafton. Allahu i sheh mirë punët që bëni ju." (Bekare, 265)

Një, ndjenja për të fituar kënaqësinë e Allahut, dy, përpjekja për të forcuar bujarinë e shpirtit... Kur dhurohet me këto dy ndjenja, begatohesh si pronari i një toke në majë të malit, e cila vaditet nga shira të bollshëm.

Çfarë gjendje shpirtërore duhet për të kërkuar kënaqësinë e Allahut në dhurim? Para së gjithash, kjo mbështetet në besimin se dhurimi është një urdher i Allahut.

Besimtar, është njeriu në zemrën e të cilit është e gjallë ndjenja e bujarisë; njeriu që nuk ka frikë nga bujaria; ai që nuk kaplohet nga shqetësimi

1. Paralogjizm: Konkluzion apo argument i palogjikshëm

i harxhimit të pasurisë kur e dhuron.

Në ajetin 268 të sures Bekare, thuhet se **“Djalli ju frikëson me skamje e varfëri dhe ju urdhëron të bëni vepra të pamoralshme. Kurse Allahu ju premton faljen dhe mirësinë e Tij...”** Pra, theksohet se koprracia dhe frika ndaj varfërisë, janë ndjenja të cytura nga shejtani. Kurse ndjenja hyjnore, është t'i besosh faljes dhe mirësisë së Zotit.

Një dobësi tjetër që vërehet në psikologjinë e dhurimit, theksohet në ajetin 267 të sures Bekare, ku urdhërohet: **“O besimtarë! Jepni pa u kursyer nga të mirat që keni fituar dhe nga ato që jua kemi nxjerrë Ne nga frytet e tokës. Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj, të cilat ju nuk do t'i pranonit ndryshe veçse symbyllur!”**

Në fillim, Allahu i Madhëruar na e bën të ditur, duke thënë se ato që fitojmë, na janë dhënë si furnizim. Më tej, kërkon që të dhurojmë më të mirën, më cilësoren prej tyre. Dhe në këtë pikë, na jep një kriter shumë të qartë: **“Mos dhuroni nga ato gjëra të pavlefshme të pasurisë suaj, të cilat ju nuk do t'i pranonit ndryshe veçse symbyllur!”** Pra, edhe kur nxirrni para nga xhepi për të dhënë lëmoshë, mos zgjidhni atë më të vjetrën. Mos zgjidhni rrobën më të vjetër, rrobat e fëmijëve që tashmë nuk mund të vishen më, frutat apo perimet që kanë filluar të kalben, pjesën e bukës që nuk mund ta konsumoni, etj... Këto mund t'i radhitim edhe më tepër... Krijuesi ynë, i njeh shumë mirë lëkundjet e ndjenjave tona, prandaj dhe na paralajmëron që në fillim.

Në ajeti 92 të sures Al'Imran, jepet edhe një kornizë tjetër e botës tonë të ndjenjave:

“Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni!”

Për të bërë pjesë në kategorinë e njerëzve që Allahu do t'i cilësojë si “të mirët”, duhet të japësh me dashuri dhe me gjithë shpirt, gjërat që i do më shumë... Dhe të gjitha këto, duhet të bëhen me vetëdijen, se **“...Allahu i pranon bamirësitë...”** (Teube, 104) Pra, të japim jo sikur po ia dhurojmë një njeriu, por sikur po ia ofrojmë Allahut të Madhëruar. Madje, siç shprehet edhe në ajetin 245 të Sures Bekare, ajetin 12 të sures Maide, ajetin 11 të sures Hadit dhe në shumë ajete të tjera, këtë çështje, duhet ta konsiderojmë si një “kard-i hasen”, pra një hua e bukur që i jepet Allahut...

Shikoni këtë ajet:

“Kush do t'i japë Allahut një hua të bukur, që Ai t'ia kthejë shpërblimin shumëfish? Allahu e shtrëngon (riskun) dhe e liron; tek Ai do të ktheheni.” (Bekare, 245)



Ai është që e pakëson, Ai është që e shton. Prej Tij është gjithçka që keni e s'keni.

Madje, në fund të fundit tek Ai do të ktheheni.

Atëherë, jepini Atij një hua të bukur, që Ai t'ua kthejë shumëfish më tepër.

Çfarë ndjenje - edukim mendimi!

Përse bëhen këto? Sepse ekziston një pengesë e brendshme, të cilën njeriu e ka të vështirë ta kapërcejë. Kurani e quan atë një rrugë/pengesë të vështirë...

Në ajetet 11-17 të sures Beled, na tërhiqet vëmendja në reflektimin e rrugës së vështirë në jetën e njeriut:

“Atëherë, le të ndjekë rrugën e vështirë! E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është rruga e vështirë? Ajo është të lirosh një skllav, ose të ushqesh në një ditë zie, jetimin e afërm ose të varfrin e mjerë. Veç kësaj, (njeriu duhet) të jetë nga ata që besojnë, që e këshillojnë njëri-tjetrin për durim dhe e këshillojnë për mëshirë.”

Në fakt, nëse shohim me vëmendje, vërejmë se “rruga e vështirë”, është në zemrat tona dhe, e kuptojmë se ato që në të vërtetë duhet të kapërcejmë, janë mendimet e këqija.

Po, duhet të pajisesh me një psikologji të re, që të bësh një dhurim prej të cilit do të kënaqet Zoti yt!

Të jesh i vetëdijshëm se furnizimin është prej Tij dhe t'i japësh Atij huan e mirë, e cila do të ripaguhet shumëfish.

Të gjitha këto t'i bësh me vetëdijen se këto janë një mbrojtje e veçantë që Krijuesi i Madhëruar ka vendosur për të varfrit, skllavërit, të vuajturit dhe të dëmtuarit. Dhe ndërkohë që i bën të gjitha këto, të largohesh prej ngarkesave psikologjike që do ta dëmtojnë edhe më shumë të dëmtuarin...

Në këtë rast, dhurimi është sikur të shëtisësh në një pallat prej xhami. Kujdes!

PARALOGJIZMI SE PASURIA TË BËN TË PËRJETSHËM

“Mjerë për çdo tallës - shpifës, që grumbullon pasuri dhe e ruan, duke menduar se ajo pasuri do ta bëjë të pavdekshëm!” (Humeze, 1-3)

Një nga sprovat më të mëdha për njeriun, është marrëdhënia e tij me pasurinë.

Allahu i Madhëruar, në ajetin që kemi dhënë më sipër, vë para nesh një tip njeriu që mbledh pasuri dhe e llogarrit atë vazhdimisht. Pra, një njeri i cili ka pothuajse një marrëdhënie pasionale me pasurinë. Kur e lexojmë ajetin, na duket sikur atë njeri e kemi brenda jetës sonë, para syve tanë.

Padyshim, se ky është një tip negativ. Fjala hyjnore, thekson edhe cilësi të tjera negative të këtij tipi negativ: Ai, në të njëjtën kohë, është edhe një tip që shpif dhe tall njerëzit.

Paralogjizmi i madh i këtij tipi:

-Pandehja se pasuria do ta bëjë atë të përjetshëm.

Por në fakt, një përjetësi e tillë nuk ekziston fare. Edhe sikur të mblidhni të gjithë pasurinë, nuk është e mundur ta zgjasësh jetën, qoftë edhe një sekondë.

Pasuria nuk e ka atë fuqi.

Allahu i Madhëruar, na e bën të ditur, se të jetosh me paralogjizmin se pasuria ka një fuqi të tillë, duke

e harruar “kthimin tek Allahu” dhe dhënien e llogarisë së jetës, është një vetëmashtrim shumë i madh.

Për këtë është edhe paralajmërimi: “Mjerë ai!”

Për këtë janë edhe këto ajete:

“Jo, aspak! Në të vërtetë, ai do të hidhet në torturën shkatërruese. E kush mund të ta shpjegojë ty se çfarë është tortura shkatërruese? Ajo është zjarri i Allahut i ndezur fort, i cili depërton deri në zemrën e njeriut. Ai do t’i rrethojë ata nga çdo anë, në shtylla të gjata flakërruese.” (Humeze, 4-9)

**Mendojmë se pasuria
e jeta nuk janë vepra të aftësive
njerëzore, por si gjithë të tjerat janë
në varësi të mirësisë hyjnore,
do të shohim qartë se sa shkujdesje
e madhe është që njeriu të pretendojë
përjetësi nga pasuria.**

Mbase ky person që vihet në shënjestër të këtyre paralajmërimeve, ka qenë një person real në kohën kur Kurani sapo kishte filluar të zbritej. Por gjuha e Kuranit, këtë tipologji na e transmeton sikur ky është një paralajmërim për njerëzit e të gjitha kohërave.

Kur e lexojmë këtë ajet dhe mendojmë se pasuria e jeta nuk janë vepra të aftësive njerëzore, por si gjithë të tjerat janë në varësi të mirësisë hyjnore, do të shohim qartë se sa shkujdesje e madhe është që njeriu të pretendojë përjetësi nga pasuria.

Allahu i Madhëruar, edhe këtë dobësi mendo-re të njeriut, e korrigjon me gjuhën e Kuranit.

Lum ai që kupton dhe merr mësim!



KALIMI I KUFIJVE

“Por vërtet që njeriu shkel çdo cak, kur mendon se është i vetëmjaftueshëm.” (Alak, 6-7)

Ky ajet, thekson një ndjenjë që njeriu e përjeton shumë shpesh, një devijim mendimi. Kjo, është gjendja psikologjike e njeriut, kur ndihet i çliruar nga kjo apo ajo nevojë dhe e ndjen veten të fuqishëm.

Njeriu, mund ta ndjejë veten të fuqishëm në aspektin ekonomik, fizik e politik. Po ashtu, mund të ndihet i fuqishëm edhe në aspektin familjar dhe farefisnor në sajë të numrit të shumtë të fëmijëve dhe fisit të madh. Gjendje të tilla, e orientojnë njeriun të vendosë kritere në bazë të interesave të tij, pra të kalojë caqet e drejtësisë.

Ndjenja e të qenit i fuqishëm, në një farë mënyre ndikon edhe në marrëdhënien e njeriut me Krijuesin e tij. Njeriu fillon t’ia atribuojë fuqinë vetes së tij. Pastaj, fillon të mendojë se fuqia e tij e bën atë të panevojshëm ndaj Allahut. Më vonë, fillon të pandehë se kjo fuqi i jep të drejtën të dalë jashtë kufijve të caktuara nga Zoti i tij. Dhe më në fund, fillon të mendojë se tek ai gjenden cilësi të “Zotit”.

Këtë, Allahu i Madhëruar e cilëson si “tërbim”.

Në Kuran, gjenden shumë shembuj të këtij lloji njeriu.

Shembulli i njeriut të tërbuar në aspektin ekonomik, është Karuni.

Shembulli i njeriut të tërbuar në aspektin politik, është Faraoni.

Ndërsa shembulli i njeriut të tërbuar në aspektin burokratik, është Hamani.

Karuni, tregohet kështu me gjuhën e Kuranit:

“Me të vërtetë, Karuni ka qenë nga populli i Mu-

sait, por i shtypte ata. Ne i patëm dhënë atij aq thesare, saqë çelësat e tyre vështirë se do të mund t’i mbante një grup njerëzish të fuqishëm. Njerëzit e popullit të tij i thanë: “Mos u ngazëlle me pasurinë që ke, sepse Allahu nuk i do ata që ngazëllehen!”

Por përpiqu me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e botës së ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë. Bëju mirë të tjerëve, ashtu si Allahu të ka bërë mirë ty. Mos kërko ngatërresa në Tokë, sepse Allahu nuk i do ngatërrestarët.”

(Kasas, 76-77)

“Ne bëmë që Karunin dhe shtëpinë e tij t’i gëlltiste toka dhe askush nuk arriti që ta mbronte nga dënimi i Allahut, madje as ai vetë nuk mund ta mbronte veten.” (Kasas, 81)

Bazuar në Kuran, Faraoni ishte një person që thoshte: ***“Unë jam zoti juaj më i lartë!”*** (Naziat, 24) Si përgjigje e kësaj, Allahu e urdhëroi Musain (a.s.), duke i thënë: ***“Shko te Faraoni, se ai, me të vërtetë, ka kaluar***

çdo kufi!” (Naziat, 17) Mirëpo ai nuk hoqi dorë nga tërbimi i tij. Si përfundim i këtij tërbimi, Allahu i Madhëruar na ka bërë të ditur se:

“Kështu ndodhi edhe me Karunin, Faraonin dhe Hamanin! Atyre u vajti Musai me prova të qarta, por ata treguan mendjemadhësi në Tokë dhe nuk i shpëtuan dënimet.” (Ankebut, 39)

Ne kurrë nuk mund ta shohim veten si të panevojshëm ndaj Allahut, sepse edhe frymëmarrja jonë është një mirësi e Allahut. E si mund të mburret njeriu, i cili është krijuar nga një pikë ujë?

Gjendja më e keqe e njeriut, është atëherë kur ai cilësohet si “i tërbuar” nga ana e Allahut të Madhëruar, i cili na ka falur mirësinë e ekzistencës.

SPROVA

e myslimanit me pasuri

Prof. Dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Marrëdhënia e njeriut me pasurinë dhe këtë botë, është një nga problemet e tij më të mëdha që prej krijimit. Prandaj, një nga synimet kryesore të fesë dhe besimit ka qenë rregullimi i sjelljes së njeriut ndaj kësaj bote. Për shkak të natyrës së tij, biri i njeriut është shumë i dhënë pas kësaj bote dhe të mirave të saj. Nëse njeriu nuk e frenon këtë pasion, ai nuk mund të shpëtojë lehtë prej ambicies dhe dëshirave të pashtershme, që e bëjnë atë sikur do ta gllabërojë gjithë botën. Në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar na këshillon të mos mashtrohemi nga kjo botë dhe urdhëron: **“Mos e hidh shikimin në të mirat kalimtare, që Ne ua kemi dhënë disave prej tyre si stoli të jetës së kësaj bote, për t'i vënë ata në provë! Shpërblimi i Zotit tënd është më i mirë dhe më e qëndrueshëm.”** (Ta-Ha, 131) Ndërsa në disa ajete të tjera, duke këshilluar mbajtjen e ekuilibrit, shprehet se rrugëdalja e vetme është puna.¹ Pra, mund të themi se, sukcesi i myslimanit në sprovën me pasuri, është kufizimi i nevojave, duke jetuar në mënyrë të ekuilibruar.

Nëse e trajtojmë sprovën e myslimanit me pasuri nga aspekti i drejtësisë sociale, që është edhe një nga çështjet të cilën mundohen ta realizojnë të gjitha fetë, sistemet politike dhe ekonomike, do të vëmë re se kjo është një çështje e cila më tepër se me ligje e kanune, mbrohet nga individët që kanë arritur pjekurinë njerëzore dhe ngopjen shpirtërore. Jo duke braktisur punën e duke ndërprerë prodhimin, por duke punuar e duke pakësuar konsumin personal, në mënyrë që t'i lërë një pjesë edhe vëllait të tij nevojtar. Pra, duke u treguar altruist e duke preferuar tjetrin para vetes. Në një shoqëri ku ekziston altruizmi, drejtësia sociale realizohet në një atmosferë të plotë dashurie.

Ekonomia përkufizohet si shkenca e plotësimit të

nevojave të pakufizuara nga burime të kufizuara. Në bazë të botëkuptimit të sotëm të ekonomisë moderne, nevojat janë të pakufizuara, ndërsa burimet janë të kufizuara. Pra, shihet qartë se sa e vështirë është të plotësosh nevojat e pakufizuara prej burimeve të kufizuara. Dëshirat dhe kërkesat njerëzore nuk kanë të mbaruar dhe, as jeta nuk mjafton për plotësimin e të gjitha këtyre. Prandaj, njeriu e shpenzon jetën e vet duke u munduar të sigurojë nevojat materiale dhe nuk ndan fare kohë për nevojat e tij shpirtërore, si adhurimi apo arti. Për këtë arsye, në traditën e kulturës islame, këshillohet që nevojat të pakësohen në nivelin e domosdoshmërisë, nën botëkuptimin *“një kafshatë, një rrobë”*, me qëllim që të mos bëhemi robër të pasurisë. Kjo, sepse gjëja më kryesore në këtë traditë, është të dish se çdo gjë i takon Allahut, duke e lidhur çdo gjë me Të.

Botëkuptimi *“një kafshatë, një rrobë”*, ka për qëllim kufizimin e nevojave të njeriut dhe ndalimin e tij nga vrapimi pas dëshirave e kërkesave të pafundme. Pejgamberi ynë (a.s.), nevojat e domosdoshme të njeriut, i ka kufizuar në këto tri gjëra:

1. Disa kafshata që të drejtosh belin,
2. Veshje që ta mbron trupin nga të ftohtit e të nxehtit,
3. Një shtëpi për të futur kokën. (shih. Ahmed b. Hanbel, Musned, V, 81.)

Në fakt, botëkuptimi *“një kafshatë, një rrobë”*, i traditës kulturore islame, është si një përmbledhje e këtij e hadithi. Mirëpo, kjo nuk i shtyn njerëzit në dembelizëm dhe braktisje të prodhimit, ashtu siç pandehet e pretendohet. Përkundrazi, kjo i orienton ata të shkojnë pas dijes, kulturës dhe adhurimit. Nuk është e vështirë të përfytyrohet se si ia nxin jetën shpirtërore njeriut pasuria e kësaj bote për të cilën digjet nga dashuria, megjithëse ai nuk e zotëron atë.

1. -shih. Nexhm, 53/39.

Fusha ku kufizimi i nevojave njerëzore është më me ndikim, është ajo e konsumit. Veçanërisht në ditët tona, kur në sajë të reklamave të ndryshme “ekonomia e konsumit dhe e shpërdorimit” po e ndez gjithmonë e më shumë këtë fushë, çdo gjë është mbështetur në parimin e konsumit dhe shpërdorimi po përhapet me shpejtësi. Kurse marrja nën kontroll e nevojave dhe pakësimi i reklamave dhe elementeve nxitëse, do të bëhet shkak që vendin e ekonomisë shpërdoruese, ta zërë ekonomia e nevojës dhe prodhimit. Njerëzit do të shpëtojnë nga shpenzimi i pavetëdijshëm i mundësive që prodhon teknologjia dhe i pasuri nuk do ta shtypë të varfrin. Po ashtu, i varfri do të shpëtojë nga bartja e dhimbjes ndrydhëse të varfërisë dhe nga kriza e shikimit të të pasurit me syrin e smirës.

Njeriu i ditëve tona, për shkak se ka humbur vlerat e larta shpirtërore, rend gjithmonë pas dëshirave dhe konsumit, duke qëndruar larg ndjenjave që i kanë hije njeriut, si arti, letërsia, adhurimi dhe shërbimi. Për shkak se nuk mund t'i kufizojë nevojat e veta, ai përjeton dilemën e atij “që nuk e di se çfarë kërkon dhe nuk e kupton kur e gjen atë”.

Kriteri i kufizimit të nevojave në sprova të myslimanit me pasurinë, është të jesh i kënaqur me atë që zotëron. Për aq kohë sa kjo lloj kënaqësie ruhet larg ekstremeve, disa nga ndjenjat dhe vlerat njerëzore ngelen të paprekura. Nëse shohim me kujdes, të mëdhenjtë e Islamit nuk kanë përçmuar këtë botë dhe pasurinë e saj, por “dashurinë ndaj kësaj bote”, e cila mbush zemrën dhe nuk lë vend për dashuri të tjera. Këto fjalë të Mevlanës e përcaktojnë shumë bukur kriterin në lidhje me këtë çështje:

“Çfarë është kjo botë? Kjo botë do të thotë të jesh i shkujdesur ndaj Allahut. Kjo botë nuk është as rrobë, as flori, as fëmijë e as grua.” (Mesnevi, I, b. 984.)

Në botëkuptimin islam, ku prej besimit ngrihesh drejt devotshmërisë dhe mirësisë, këshillohet të hapësh krahët prej një jete të kufizuar nga kjo botë, drejt botës së përjetshme dhe të udhëtosh drejt botës tjetër me mendimin për të shpëtuar shpirtin, i cili është burgosur nga prirjet e dëshirat. Edhe pse jeta e kësaj bote është e gjerë dhe tërheqëse, për shpirtin e njeriut ajo është shumë e mërzitshme.

Siç shprehet edhe Mevlana; kjo botë është ngrohur shumë dhe i ngjan një hamami² të nxehtë. Pra, kjo botë është si një hamam, ku njeriu nuk merr dot frymë dhe i ngushtohet shpirti. Në fakt, hamami është një vend i gjerë dhe i lartë. Mirëpo, për shkak të nxehtësisë, ai ia merr e ia ngushton frymën njeriut, i cili nuk çlirohet

dot pa dalë jashtë hamamit. Këtë veçori mbytëse e plasëse të botës, njeriu mund ta përballojë vetëm duke dhënë, duke ndarë dhe duke e çliuar shpirtin e tij nga ajo (bota). (Mesnevi, III, b. 3544.)



Sprova e njeriut me pasuri, është një çështje që lidhet me mbështetjen në Allahun (tevekulin), e cila formohet në zemër; është siguria në Allahun dhe kënaqësia ndaj asaj që vjen prej Tij. Kufizimi i nevojave është qëndrimi që mban njeriu ndaj egos së vet dhe edukimi i saj. Kushti themelor i edukimit të egos, është të japësh. Ky botëkuptim të mëson të mbështetesh jo tek pasuria, por tek Krijuesi i saj, pra të bësh durim pa u ankuar për shkak të varfërisë. Kjo, sepse në krye të shqetësimeve të kësaj bote që e prishin ekuilibrin shpirtëror të njeriut, vjen stresi. Ndërsa në krye të shkaqeve që i hapin rrugën stresit, qëndron lakmia dhe dëshirat e pashtershme. Midis dëshirës dhe dhimbjes, ekziston një lidhje, sepse dëshirat dhe kërkesat e pafundme bëhen burim i dhembjeve të pafundme. T'i pranosh njerëzit dhe ngjarjet ashtu siç janë dhe jo ashtu siç duhet të jenë, është një nga motivet kryesore të kënaqësisë shpirtërore. Kënaqësia dhe qetësia është një nga treguesit kryesorë të shëndetit shpirtëror. Ndërsa besimi dhe dorëzimi tek Allahu, janë kushtet bazë të kësaj.

Sprova e myslimanit me pasuri përbëhet nga pasioni dhe prova. Allahu i Madhëruar urdhëron: **“Sigurisht që Ne do t’ju provojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave.”** (Bekare, 155) Nga kjo, kuptohet se pasuria dhe skamja, janë një provë prej Allahut dhe në sajë të durimit, njeriu mund të kalojë provën e skamjes, ndërsa në sajë të falënderimit mund të kalojë provën e pasurisë. Duke u mjaftuar me ato që ka kur është i varfër dhe duke ndarë me të tjerët mundësitë që ka kur është i pasur, njeriu realizon falënderimin ndaj asaj që zotëron. Edhe pse durimi dhe falënderimi janë veprime që reflektohen jashtë, ato marrin formë në zemër. Vendimi merret në zemër para se të bëhet durim ndaj varfërisë e të falënderohet për pasurinë. Mirëpo, durimi ndaj pasurisë, është më i vështirë se durimi ndaj varfërisë.

E vetmja rrugë e durimit ndaj pasurisë dhe varfërisë, është që kjo botë “plot dhimbje dhe pabesi”, të konsiderohet si kalimtare dhe të vazhdohen përgatitjet për në vendin e botës tjetër, i cili është edhe vendi ku do të jetohet përjetësisht. Pra, me qëllim që myslimani të dalë me sukses nga sprova me pasurinë, ai duhet të largohet nga pasuria e kësaj bote e të zgjedhë botën tjetër. Nëse nuk vepron kështu, ashtu siç po ndodh edhe sot, ai do të bjerë në prehrin e materializmit, i cili ndryshe quhet edhe “shekullarizëm”.



2. -Hamam: Vend publik ku lahen njerëzit sipas traditës osmane.



SPROVIMI ME MIRËSI

Dr. Adem Ergyl

Jeta e kësaj bote është quajtur "daru'l-imtihan / vendi i sprovës", sepse në të gjitha aspektet e jetës bëhet fjalë për sprovat e ndryshme hyjnore. Këto, në një aspekt, janë sprova që nxjerrin në pah cilësinë e nënshtimit ndaj Allahut të Madhëruar. Suksemi apo dështimi do të jetë shkak për lumturinë ose ndëshkimin e njeriut në jetën e përhershme. Çështja është shumë serioze dhe për askënd nuk bëhet fjalë që të mos sprovohet. Pyetjet e këtij provimi janë të veçanta për secilin. Fusha e kësaj sprove është në varësi të mundësive apo pamundësive që i janë dhënë njeriut. Sprovimi me para, apo me një shprehje tjetër, sprovimi me pasuri, është njëri prej sprovimeve më të vështira. Në Kuranin Fisnik ka shumë ajete që flasin në lidhje me këtë çështje. Por në këtë shkrim, ne do të shtjellojmë dhe do të marrim mesazhet bazë të disa historive që Allahu Teala na i ka shfaqur në formën e tablove. Në suren Kehf tregohet biseda e një besimtari të vetëdijshëm me një besimtar të shkujdesur dhe të pasur:

"Jepu atyre si shembull ndodhinë e dy njerëzve. Njërit prej tyre Ne i kishim dhënë dy kopshte vreshtash, që i kishim rrethuar me hurma e midis tyre kishim bërë fusha drithi. Të dy kopshtet jepnin frytet e veta, pa u munguar asgjë dhe bëmë që midis tyre të rridhte një lumë. Ai pati prodhim të bollshëm dhe i tha shokut

të vet, duke biseduar me të: 'Unë kam më shumë pasuri se ti dhe kam rreth më të fortë!' Pastaj hyri në kopshtin e vet dhe, duke qenë i padrejtë me vetveten, tha: 'Unë nuk mendoj se kjo do të shkatërrohet ndonjëherë dhe nuk mendoj se do të arrijë ndonjëherë Ora (e Kiametit). Por, edhe nëse do të më kthejnë te Zoti im, sigurisht që do të gjej një vend më të mirë se ky (kopsht)! Shoku i tij i tha: 'A e mohan ti Atë, i Cili të ka krijuar nga dheu, pastaj nga pika e farës dhe të bëri më në fund njeri të plotë? Sa për mua, unë besoj se Allahu është Zoti im dhe Zotit tim unë nuk i shoqëroj askënd (në adhurim). Do të ishte më mirë për ty sikur të kishe thënë, kur hyre në kopshtin tënd: 'Kështu ka dashur Allahu! Nuk ka fuqi përveçse nëpërmjet Allahut.' Nëse ti sheh se unë kam më pak pasuri dhe pasardhës, dije, Zoti im mund të më japë diçka më të mirë se kopshti yt, ndërsa në kopshtin tënd mund të dërgojë një shkatërrim nga qielli e të gdhijë rrafsh pa asgjë ose të bëjë që uji i tij (kopshtit), të humbasë në thellësi e të mos mund ta gjesh kurrë më'. Dhe pasuria e tij (e mohuesit) u shkatërrua, kurse ai i rrihte duart për gjithçka që kishte shpenzuar në të (pronën e vet), që tashmë ishte shkretuar nga rrënjët dhe thërriste: 'Ah! Sikur të mos i kisha shoqëruar Zotit tim askënd!' Kështu, ai nuk pati kurrfarë rrethi që ta ndihmonte

kundër Allahut dhe as që ishte në gjendje të mbronte vetveten. Në një rast të tillë, mbrojtja vjen vetëm nga Allahu, i Vërteti. Ai është më i miri për të shpërblyer dhe jep përfundimin më të mirë.” (Kehf, 32-44)

Mesazhi bazë që jepet në këtë tablo, është e vërteta se kur njeriu nuk pranon që mirësinë e ka nga Allahu, privohet nga mirësia si rezultat i humbjes së sprovës dhe shfaqjes së mosmirënjohjes ndaj Zotit (xh.sh.). Nëse e shohim me vëmendje, kjo gjendje shprehet si rënie në shirk, që është mëkati më i madh. Në të njëjtën mënyrë u dënua edhe Karuni, i cili pandehte së pasurinë e kishte nga dija e tij dhe u zhyt në fund të dheut.¹ Edhe një tablo tjetër që tregohet në Kuranin Fisnik është në lidhje me disa njerëz, që e fshihnin pasurinë për veten e tyre, që nuk e ndanin me të varfrit, koprracë dhe që e pandehnin veten të mençur e dinakë. Allahu i Madhëruar thotë:

“Ne i kemi vënë në provë ata (banorët e Mekës), ashtu siç i sprovuam të zotët e kopshtit, të cilët ishin betuar se në mëngjes do t’i vilnin frutat dhe nuk patën thënë: ‘Në dashtë Zoti!’ Kështu, kopshtin e goditi një fatkeqësi nga Zoti yt, ndërkohë që ata po flinin dhe gdhui si i kositur. Në agim, ata thirrën njëri-tjetrin: ‘Nxitoni herët në kopshtin tuaj, nëse doni t’i vilni frutat!’ Dhe u nisën duke pëshpëritur: ‘Të mos lejojmë asnjë të vobektë të hyjë në kopshtin tonë!’ Ata u nisën herët, të vendosur në atë që thanë. Por, kur e panë kopshtin, thanë: ‘Ne qenkemi vërtet të humbur, madje, qenkemi të privuar (nga frutat e kopshtit).’ Më i arsyeshmi ndër ta tha: ‘A nuk ju tha-shë unë se duhet ta lartësoni Allahun?’ ‘Lavdëruar qoftë Zoti ynë! - thanë - Ne paskemi qenë vërtet të padrejtë!’ Atëherë filluan të qortojnë njëri-tjetrin. ‘Ah, të mjerët ne! - thanë ata - Paskemi qenë vërtet arrogantë! Zoti ynë mund të na japë një kopsht më të mirë, po të kthehemi të penduar tek Ai!’ I tillë ka qenë dënimi i tyre. Ndërsa dënimi në jetën tjetër, është më i madh, veç sikur ta dinin!” (Kalem, 17-33)

Mesazhi në këtë ajet është shumë i qartë: Paratë dhe pasuria nuk i përkasin vetëm atij që i janë dhënë. Aty kanë pjesë edhe nevojtarët. Largimi nga infaku nuk i jep begati pasurisë, përkundrazi, bëhet shkak që ajo të humbasë. Ndarja e pasurisë me të tjerët është një lloj i përkujtimit dhe madhërimit të Allahut Teala nga ana e zotëruesit të pasurisë. Kur njeriu të mos veprojë në këtë mënyrë, siç shprehet edhe Kurani, bën padrejtësi. Ne duhet ta dimë se Allahu Teala është kundër padrejtësisë dhe të padrejtë. Të padrejtët ndëshkohen që në këtë botë. Ndërsa ndëshkimi në Ahiret, pa dyshim se do të jetë më i ashpër.

Paratë, pasuria dhe mirësitë, sigurisht se janë të ëmbla. Dora e lavdëruar nuk është ajo që merr, por ajo që jep. I Dërguari i Allahut, (a.s.), çdo gjë e ka shpjeguar

1. Shik. Kasas, 76-83.

me këtë hadith të Tij: “Sa mirësi e madhe është pasuria për një njeri të devotshëm!” (Ahmed b. Hanbel, Musned, IV, 197, 202.) Domethënë, e rëndësishme është që njeriu të jetë i devotshëm. Sa bukur e shpjegojnë këtë të vërtetë edhe këto ajete që bëjnë fjalë për Sulejmanin, alejhi’s-selam, në Kuranin Fisnik:

“Ne i falëm Daudit Sulejmanin. Sa rob i mrekullueshëm ishte ai! Sigurisht se ai i drejtohej gjithnjë me pendesë Zotit! Kur një pasdite iu paraqitën kuajt këmbëshpejtë, ai tha: ‘Unë me të vërtetë e dua pasurinë, ngaqë më bën të përkujtoj Zotin. Kur i humbën nga sytë dhe ikën, tha: ‘M’i ktheni ata (kuajt)!’” (Kur erdhën kuajt), filloi t’u ledhatonte këmbët dhe qafën.” (Sad, 30-33) Edhe në këtë mesazh që jep kjo tablo, tregohet mënyra e të qenit “rob i mrekullueshëm te Allahu”, kur të jepen mirësitë. Kjo do të thotë që mirësitë duhet t’ia kujtojnë njeriut Zotin dhe njeriu, gjithmonë duhet ta gjejë mundësinë e shansin për t’iu drejtuar Zotit (xh.sh.), me ato mirësi që i janë dhënë. Fitimi i madh është diçka e pëlqyeshme, përderisa nuk kalohen kufijtë që ka vendosur Allahu Teala. Ndërsa lakmia për të fituar sa më shumë pa pasur kujdes ndaj hallallit dhe haramit, i sjell njeriut shkatërrimin e tij. Në Kuranin Fisnik shfaqet një tablo shumë spikatëse në lidhje me këtë. Allahu i Madhëruar thotë:

“(O Pejgamber!) pyeti ata për qytetin që gjendej në bregdet dhe për çfarë i gjeti banorët e tij kur thyen urdhëresën e Sabatit (të shtunës)!² Atë ditë u vinin peshqit me shumicë, ndërsa ditëve të tjera që nuk i kremtonin, nuk u vinin. Kështu, Ne i vumë në provë, sepse bënë punë të mbrapshta. Kur disa prej tyre thanë: ‘Përse këshilloni, kur e dini se Allahu do t’i zhdukë ose do t’i ndëshkojë ashpër?’ Këshilltarët u përgjigjën: ‘Për t’u arsyetuar para Zotit tuaj dhe që ju të mund të ruheni nga gjynahet’. Por, kur e harruan atë për të cilën ishin paralajmëruar, Ne i shpëtuam ata që këshillonin, kurse i ndëshkuam ashpër keqbërësit, për shkak të mosbindjes së tyre. Kur ata ngulmuan me mendjemadhësi të bënë atë që u ishte ndaluar, Ne u thamë: ‘Bëhuni majmunë të përbuzur!’” (Araf, 163-166)

Njëri prej mësimëve më të rëndësishme që mund të merret nga ky ajet fisnik, është: Hapja e mundësive të fitimit të madh me rrugë haram, asnjëherë nuk duhet të pranohet si diçka e duhur. Kjo është humbja më e madhe që duket si fitim. Lloji i pasurisë, që e nxjerr njeriun nga të qenit njeri, në përgjithësi është nga ky lloj.

2. Njëra prej dispozitave hyjnore që iu zbrit Musait, alejhi’s-selam, ishte respekti i ditës së shtunë duke mos u angazhuar me punët e kësaj bote dhe duke u preokupuar me punët e ahiret. Por disa çifutë që pandehnin se ishin dinakë, menduan se gjetën zgjidhjen e duhur për t’i kapur peshqit që vinin me shumicë. Në këtë mënyrë, përpiqeshin të shkelnin ndalesën e vënë nga Zoti (xh.sh.). Ajeti bën fjalë për gabimin që bënë këta njerëz.

Prof. dr. Sulejman Derin

SHEJTANI DHE NEFSI

Kurthet dhe dredhitë e shejtanit, ndryshojnë sipas vendit dhe kohës. Ai nuk ka nevojë të mashtrojë jobesimtarët, sepse ata e mohojnë Zotin (xh.sh.), ekzistenca e të cilit është më e qartë se çdo gjë dhe e kanë lënë veten jashtë mëshirës hyjnore. Ndërsa për besimtarët, patjetër se në çantën e shejtanit ka një kurth që i përshtatet secilit prej tyre.

Allahu Teala e ka dërguar njeriun në këtë botë, e cila është vendi i sprovës, me dy armiq që duhet t'i mposhtë. Njëri prej këtyre është armiku i brendshëm, nefsi, ndërsa tjetri është armiku i jashtëm, shejtani. Ata që jetojnë pa i njohur këta dy armiq, bien në kurthet e tyre dhe privohen nga lumturia e përhershme. Ngaqë fusha me të cilën interesohet Tasavvufi është lufta kundër këtyre armiqve të padukshëm, sufitë (mistikët) përpiqen t'i mbrojnë besimtarët nga rreziqet në këtë çështje. Edhe Imam Rabbani (k.s.), në letrat e tij na tregon për rreziqet e tyre, duke u nisur nga Kurani dhe Suneti. Paralajmërimi i parë i Imami në lidhje me këtë temë, është se të gjithë janë të përfshirë në fushën e ndikimit të shejtanit dhe askush nuk mund të qëndrojë larg këtij të mallkuari. Në hadithin fisnik, thuhet:

"Të gjithë njerëzit kanë nga një shejtan që i shoqëron dhe që nuk u ndahet kurrë." Kur e pyetën: "Edhe ju keni, o i Dërguari i Allahut?" Ai u përgjigj: "Po kam, por Allahu më ka ndihmuar dhe unë mbrohem nga e keqja e tij." (II, 33.) Nisur nga kjo, të gjithë, pa përjashtuar edhe pejgamberët, duhet ta neutralizojnë shejtanin e tyre. Për ta shpjeguar këtë përpjekje, të urtët e Indisë kanë thënë: "Nuk mund të bëhesh mysliman, pa ia prerë kokën atij që të shoqëron." Sipas Imami, qëllimi i kësaj fjale është neutralizimi i shejtanit, i cili pothuajse nuk

e lë kurrë vetëm njeriun dhe e fton atë në sherre e të këqija. T'i presësh kokën shejtanit, do të thotë të mos lidhesh pas tij dhe ta poshtërosh atë. Por, për fat të keq, shumë njerëz nuk e kanë të lehtë ta neutralizojnë shejtanin. Allahu Teala i ka dhënë njeriut mendje për ta



ndarë të vërtetën nga e gabuara. Po ashtu, i ka dërguar edhe profetë dhe libra hyjnorë. Si është e mundur që njerëzit të mashtrohen nga shejtani, edhe pse janë bërë kaq shumë paralajmërime? Imami i përgjigjet kështu kësaj pyetjeje: “Shejtani është përçarje, sprovë dhe fatkeqësi... Allahu Teala ua ka vënë shejtanin robërve të Tij si shoqërues dhe ua ka fshehur nga sytë për t’i sprovuar ata. Edhe pse njerëzit nuk i ka informuar për gjendjet e shejtanit, djallit ia ka treguar gjendjet e njerëzve... Atij i ka dhënë leje të lëvizë nëpër damarët e njerëzve. Njeriu që arrin lumturinë me ndihmën e Allahut Teala, është ai që mbrohet të mos bjerë në dredhinë dhe kurthin e një fatkeqësie të tillë” (II, 33.) Nisur nga ajo që kuptojmë prej këtyre rreshtave, myslimani duhet të veprojë me dijen që ka dhe t’i lutet Allahut të Lartësuar ta ndihmojë për ta bërë të suksesshëm në këtë luftë. Faktikisht, në ajet thuhet se ky kurth është i dobët, por është i dobët për ata që e edukojnë nefsin. Ndërsa për ata që nuk e edukojnë nefsin, shejtani është i fortë si luan.

Allahu Teala në Kuranin Fisnik e ka quajtur të dobët kurthin e shejtanit. (Shik. Nisa, 76.) Në këtë mënyrë, i ka inkurajuar besimtarët e devotshëm. Sigurisht se, nëse Allahu Teala e ndihmon robin e Tij, dredhia e shejtanit ngelet si dredhia e dhelprës, por nëse nuk e ndihmon, shejtani bëhet si luan agresiv. (II, 33.)

Sipas Imamit, shkaku më i rëndësishëm i ndikimit të kurthit të shejtanit te njerëzit, edhe pse është i dobët, është bashkëpunimi i shejtanit me nefsin. Shejtani mund t’i afrohet njeriut duke përdorur edhe dëshirat e nefsit dhe mund ta thërrasë në gjërat e dyshimta... Ai merr mbështetjen e nefsit emmare, që është armik i brendshëm dhe e bën njeriun t’i nënshtrohet. Kurthi i shejtanit është i dobët, por mund ta bëjë atë lehtë në

sajë të armikut që i përgatit terrenin. Faktikisht, fatkeqësia dhe armiku ynë më i madh në këtë punë është nefsi emmare. Njeriun nuk mund ta luftojë askush përveç kësaj krijese të poshtër... Ndërsa armiku i jashtëm, çdo gjë e bën vetëm me ndihmën e nefsit emmare. Nefsi duhet të ulet dhe të nënçmohet. Ja pra, koka e nefsit emmare pritet, nënçmohet dhe poshtërohet në këtë luftë. Pengesa dhe perdja e udhëtarit mistik në rrugën e përshpirtshmërisë është vetë nefsi i tij... (II, 33.)

Kurthet dhe dredhitë e shejtanit ndryshojnë sipas vendit dhe kohës. Ai nuk ka nevojë të mashtrojë jobesimtarët, sepse ata e mohojnë Zotin (xh.sh.), ekzistenca e të cilit është më e qartë se çdo gjë dhe e kanë lënë veten jashtë mëshirës hyjnore. Ndërsa për besimtarët, patjetër se në çantën e shejtanit ka një kurth që i përshatet secilit prej tyre. Për shembull, një besimtari mëkatar i flet për mëshirën e Allahut të Madhëruar. Në këtë mënyrë, e zvarrit atë në dembelizëm, madje edhe në mëkat. Në kohën e sotshme, shejtani i mallkuar i afrohet njeriut duke i folur për mirësinë e Allahut Teala dhe me intriga si mashtrimi dhe inkurajimi për të nënvlerësuar dhe vonuar. Ai e nxit njeriun të bëjë mëkate, duke i folur për mëshirën e gjerë të Zotit (xh.sh.). Por në Ditën e Kiametit, që është koha e shpërblimit dhe ndëshkimit, mëkatarët do ta marrin ndëshkimin siç thuhet edhe në ajet: **“O ju keqbërës! Veçohuni sot!”** (Ja Sin, 59) (Letra e 96-të) Për sa i përket myslimanit të shkujdesshëm, e preokupon me çështje të padobishme dhe e pengon nga përkujtimi i Allahut Teala. Në Kuran thuhet: **“Ata i ka vënë poshtë djalli dhe i ka bërë që të harrojnë përmendjen e Allahut. Ata janë pala e djallit. Në të vërtetë, pala e djallit janë të humburit.”** (Muxhadile, 19) Ose këtyre myslimanëve ua shfaq të parëndësishme punën e rëndësishme apo punën më pak të rëndësishme ua shfaq si më të rëndësishme. Për këtë arsye, si fillim, Imami na këshillon ta neutralizojmë nefsi emmaren, sepse nefsi bashkëpunon me shejtanin dhe ia hap dyert e kalasë nga brenda. Nëse nefsi merret nën kontroll, shkatërrohen të gjitha kurthet e shejtanit, sepse nefsi tashmë nuk ua vë veshin pëshpëritjeve të tij. Imami thotë kështu në lidhje me këtë çështje:

“Pas shpëtimit nga kthetrat e nefsit, me ndihmën e Allahut Teala është shumë e lehtë ta përzësh armikun e jashtëm. Ajeti fisnik: **“Në të vërtetë, ti nuk do të kesh pushtet mbi robërit e Mi...”** – është një sihariq për robërit e sinqertë që shpëtojnë nga robëria e nefsit dhe adhurojnë vetëm të Adhuruarin e Vërtetë. Allahu Teala është ai që jep sukses.” (II, 33.)

Allahu Teala na bëftë prej atyre që e mposhtin nefsin dhe shpëtojnë nga kurthet e shejtanit! Sidomos në kohën e sotme, në të cilën janë përhapur pa masë gjërat që i pëlqejnë nefsit, na bëftë prej atyre që shpëtojnë nga dredhitë e djallit dhe që e bëjnë mysliman atë! Amin!





Për birin e njeriut është e vështirë ta mendojë nderin e "ekzistencës së vet", të ndarë nga përpjekja për ta "vazhduar këtë ekzistencë". Jeta është një provim, i cili para çdo robi del me pyetje të ndryshme dhe, edhe pse me çdo lloj vështirësie, njeriu ka nevojë për pasurinë, që të qëndrojë në këmbë. Ai e di se varfëria, privimi dhe skamja janë si thika të mprehta që e brejnë lidhjen në të cilën mbahet jeta. Për këtë arsye, ai i jep vlerë pasurisë, shpenzon mundin e tij për pasurinë, ndonjëherë mburret me pasurinë e ndonjëherë bën sikur është i pasur. Ja pra, në këtë pikë, fiton rëndësi ajo të cilën njeriu e quan "pasuri".

Çfarë është pasuria? A mjaftojnë si shembuj trashëgimitë, pronat e patundshme, fitimet e mëdha, shpenzimet e nivelit të lartë dhe postet madhështore? Po skamja çfarë është? A mjafton si përshkrim i skamjes, tabloja e një njeriu këmbëzbathur e barktharë, që jepet si shembull i varfërisë? Apo mos vallë kamja dhe skamja kanë një kuptim më të gjerë përtej materiale?

Jetojmë në një botë, ku të gjithë e përjetojnë rezultatin e hidhur të trajtimit të marrëdhënies së njeriut me pasurinë, vetëm nga aspekti material. Thjeshtëzimi i pasurisë vetëm me anën materiale, i hap rrugën de-

formimit të botëkuptimit tonë dhe shkakton dëme të mëdha në botën e zemrës sonë. Këndvështrimi që e identifikon të qenit i pasur, me zotërimin e parave, nga një anë i fryn zjarrit të ambicies materiale, ndërsa nga ana tjetër, çon në mosmirënjohje, duke i anashkaluar të gjitha mirësitë e tjera që ka dhuruar Allahu. Të mos e kuptosh se besimi është pasuria jonë më e çmuar, ose të mos e kuptosh se sa pasuri e madhe është mendja dhe dija, nuk është gjë tjetër veçse skamje në mes të kamjes. Cila pasuri mund ta blejë mirësinë e shëndetit dhe shpirtit? Me cilën valutë mund të matet vlera e prindit apo e fëmijës? Siç shprehet edhe Pejgamberi ynë (a.s.): "Pasuri, nuk është malli i shumtë, por shpirti i ngopur (i kënaqur)." (Buhari, Rikak, 15.)

Në bazë të ligjit të jetës, njeriu ka nevojë për të mirat materiale në çdo fushë, që nga ushqimi deri tek kurimi, që nga edukimi deri tek ndërtimi e me radhë. Në fakt, që prej njeriut të parë, në peshoren e ekuilibrit të jetës së kësaj bote, në njërën anë qëndron fitimi dhe në anën tjetër shpenzimi. Çdo njeri e di se pasuria është pjesë e jetës. Siç theksohet edhe në ajetin: **Thuaj: "Kush i ka penguar stolitë dhe ushqimet e këndshme, të cilat Ai i ka krijuar për robërit e Vet?" Thuaj: "Ato janë**



për besimtarë (dhe të tjerët) në këtë botë, ndërsa në botën tjetër do të jenë vetëm për besimtarët...¹, kërkimi i rriskut hallall, është pjesë e jetës njerëzore.

Ne e kujtojmë shpesh dhe, ia kujtojmë edhe njëritjetrit, parimin kuranor: ***"Përpiku me atë që të ka dhënë Allahu, që të fitosh jetën e botës së ardhshme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë..."²***. Po ashtu, duke u frymëzuar edhe prej fushës së hadithit, themi se besimtari nuk duhet të jetë i dobët dhe, nëse e kryen detyrën e tij të falënderimit, nuk duhet të ketë frikë prej pasurisë. Allahut të Madhëruar, i pëlqen ta shohë tek robi i tij mirësinë që i ka dhënë. A nuk ka thënë edhe Pejgamberi ynë (a.s.), se: *"Sa pasuri e mirë është ajo në dorën e njeriut të mirë!"* (Buhari, Edebu'l-Mufred, 112.)

Padyshim se të gjitha këto janë të vërteta. Por, nëse nuk bëhet kujdes ndaj kufijve, si nevoja dhe domosdoshmëria, nuk duhet harruar se pasuria mund ta tërbojë njeriun dhe mund ta tërheqë në ndjenja dhe veprime të pakontrolluara.

Kurani Fisnik thekson se pasuria ka një aspekt që

1. -Araf, 7/32.

2. -Kasas, 28/77.

e tërheq njeriun. Prandaj, njeriu që është i detyruar të fitojë para për të plotësuar nevojat e veta, nga një anë bart në vetvete edhe farat e dashurisë ndaj fitimit, mallit e pasurisë. Këto fara, që janë të fshehura në natyrën njerëzore, janë si burim energjie që e shpejtojnë prodhimin dhe e rritin dëshirën e njeriut për të fituar dhe jetuar në kushte më të mira.

Kur njeriu rritet fiton, kur fiton gëzohet, kur gëzohet dëshiron të fitojë edhe më shumë. Në lidhje me këtë çështje, Pejgamberi ynë (a.s.), shprehet: *"Kur biri Adem rritet, së bashku me të rriten edhe këto dy gjëra: dashuria për pasuri dhe dëshira për jetë të gjatë"*. (Buhari, Rikak, 5.) Ndërsa në një hadith tjetër shprehet: *"Nëse biri Adem do të kishte një luginë plotë me pasuri, do të dëshirojë të ketë edhe një luginë tjetër plotë me pasuri"*. (Buhari, Rikak, 10.)

Ndërkohë që dashuria për pasuri forcohet sa më shumë që pasurohesh dhe kthehet në "lakmi për pasuri", njeriu mund të mos e vërë re se energjia në natyrën e tij ka arritur një nivel djegës e shkatërrues. Kur ai fillon ta masë pasurinë vetëm me mirësitë materiale, verbohët ndaj anës shpirtërore dhe bëhet materialist. Ndërsa në momentin kur e humbet pasurinë, rrënohet

sikur të kishte humbur gjithçka, duke humbur sprovën e pasurisë. Mirëpo, ai duhet ta mendojë pasurinë si një gjë të vetme dhe duhet t'ia dijë vlerën çdo lloj pasurie materiale e shpirtërore që zotëron. Po ashtu, në çdo hap të jetës ai duhet të bëjë kujdes edhe për ekuilibrin midis fitimit dhe shpenzimit. Kur Zoti i tij e sprovon dhe i jep mirësi, njeriu duhet të thotë: **"Zoti im më ka nderuar!"** Ndërsa, kur Zoti ia pakëson rriskun, nuk duhet t'ia kthejë shpinën e të thotë: **"Zoti im më poshtëroi!"**³

Në dimë se Pejgamberi ynë (a.s.), në lidhje me këtë botë dhe përfitimet materiale në të, ka këshilluar gjithmonë rrugën e mesme. Ndërkohë që punohet për këtë botë, nuk duhet harruar bota tjetër dhe ndërkohë që investohet për botën tjetër, nuk duhen anashkaluar përgjegjësitë në këtë botë. Ky është suneti i tij.

Nga një anë, Pejgamberi (a.s.), e këshillon Hakim bin Hizamin të mos mashtrohet nga aspekti material i pasurisë, duke i thënë: **"O Hakim! Pasuria e kësaj bote është magjepsëse dhe e ëmbël. Kush e zotëron këtë pasuri me zemër të gjerë dhe pa e lakmuar, ajo i bëhet begati. Por kush e dëshiron këtë pasuri me një zemër të mbushur me lakmi e pangopësi, njësoj si grykësi që nuk di të ngopet, begatia e saj largohet."**⁴ Nga ana tjetër, Ka'b bin Malikut, i cili mendon të heqë dorë plotësisht nga pasuria e tij, i thotë: **"Mbaje një pjesë të pasurisë! Kjo është më e mirë për ty."**⁵ Nga kjo, kuptojmë se ekuilibri në pasuri është e fshehta e ekuilibrit midis dy botëve.

Në njërën anë të këtyre ekstremeve, që e tronditin këtë ekuilibër, qëndron jeta e përkushtuar ndaj kësaj bote dhe të mirave materiale, ndërsa në anën tjetër qëndron një jetë askete e shkëputur plotësisht prej kësaj bote. Mirëpo, feja jonë nuk pranon asnjërin prej tyre. Në lidhje me dëshirën për ekuilibrin material e shpirtëror të pasurisë sonë, Pejgamberi ynë (a.s.), shpesh është lutur me këto fjalë: **"O Allah! Na jep të mira në këtë botë e në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimi i xhehenemit!"** (Muslim, Dhikir, 26)

Pasuria dhe prona janë prej sprovave më serioze të jetës së kësaj bote. Mirëpo, ne jemi umeti i Muhamedit (a.s.), i cili ka thënë se kjo provë do të jetë më e vështirë për ne: **"Çdo umet ka fitnen (sprovën) e vet. Dhe fitneja e umetit tim është pasuria."**⁶

3. - shih. Fexhr, 89/15-16.

4. - Buhari, Zekat, 50.

5. - Buhari, Ejman, 24.

6. - Tirmidhi, Zuhd, 26.

Nëse e krahasojmë kohën tonë me jo më shumë se 50-60 vite më parë, do të vëmë re se mundësitë tona materiale kanë ndryshuar dhe janë shtuar shumë. Standardet e jetës janë përmirësuar, duke vënë para përgjegjësisë myslimanët e pasur, shumë prej të cilëve e kanë harruar faktin se, **"...Vetëm Allahu i takon sundimi i qiejve, i tokës dhe i çdo gjëje që gjendet midis tyre..."**⁷ dhe se pasuria që zotërojnë, është vetëm një amanet që u është besuar atyre.

Tashmë, një sërë sëmundjesh ngjitëse që sjell pasuria, si luksi i tepërt, shpërdorimi, mburrja, ambicia, mendjemadhësia etj., e kanë infektuar shpirtin tonë. Çdo ditë e më tepër po shtohen shembuj të njerëzve që, megjithëse përparojnë në kuptimin material, ngelen mbrapa në kuptimin moral e shpirtëror. Mentaliteti, i cili si kriter të vetëm të pasurisë ka paranë, e ka rrethuar nga të gjitha anët botën myslimane.

Vallë, a nuk duhet të mendohet hapi tjetër?

A nuk varet vetëm nga një fije shkrepëseje shkatërrimi brenda një nate i një depoje të mbushur me mall? A nuk ka ndonjë çmim lënia pas dore e zekatit, sadakasë, modestisë e thjeshtërisë, duke nënvleftësuar pasurinë shpirtërore për hir të një pasurie materiale që na është lënë amanet dhe mund të humbasë në çdo çast? Po gjendja jonë që i ngjan pronarëve të kopshtit që tregohen në Kuran? Kur dolën herët në mëngjes për të mbledhur prodhimet e tyre, ata i pëshpëritnin njëri-tjetrit duke thënë: **"Të mos lejojmë asnjë të varfër që të hyjë në kopshtin tonë!"**

A nuk varet vetëm nga një fije shkrepëseje shkatërrimi brenda një nate i një depoje të mbushur me mall? A nuk ka ndonjë çmim lënia pas dore e zekatit, sadakasë, modestisë e thjeshtërisë, duke nënvleftësuar pasurinë shpirtërore për hir të një pasurie materiale që na është lënë amanet dhe mund të humbasë në çdo çast? Po gjendja jonë që i ngjan pronarëve të kopshtit që tregohen në Kuran? Kur dolën herët në mëngjes për të mbledhur prodhimet e tyre, ata i pëshpëritnin njëri-tjetrit duke thënë: **"Të mos lejojmë asnjë të varfër që të hyjë në kopshtin tonë!"** Mirëpo, çmimi i kësaj lakmie ishte shkatërrimi i të mbjellave të tyre, të cilat një ditë më parë i shihnin të mrekulluar. (shih. Kalem, 17-32)

Si besimtarë të kohës së sotme, duhet ta kuptojmë pa u bërë ende vonë se pasuria që zotërojmë, është një amanet që duhet ndarë me vëllezërit tanë, jetimët, gratë e veja, të varfrit e nevojtarët. Të mos e matim pasurinë tonë me të mirat materiale, duke e kufizuar me këtë botë. Të kujtojmë se sekret i sprovës fshihet tek ekuilibri. T'u dalim zot pasurive tona shpirtërore, vlerave dhe virtyteve tona, me qëllim që të bëhemi prej atyre që Zoti ynë i cilëson si njerëz të devotshëm: **"Ata janë njerëz, të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahun, të cilët falin namazin dhe japin zekatin, të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara."** (Nur, 37)

7. - Maide, 17.



MENDJA E MUNGUAR

Muhamed Gazali

Islami ngrihet mbi disa shtylla dhe baza, të cilat u ngjajnë ajeteve të qarta, që janë baza e fesë dhe esenca e saj! Këto shtylla dhe baza nuk janë çështje ndryshimi, edhe pse mund të ketë qëndrime të ndryshme, ato janë qëndrime sipërfaqësore dhe me peshë të lehtë.

Le të sjellim një shembull që e qartëson këtë qëllim. Allahu (xh.sh.), thotë në Kuran: **“... Ose, nëse i prekni gratë dhe nuk gjeni ujë, atëherë merrni tejemum me dhe të pastër.”** (Nisa, 43) Prekja, a ka kuptimin e përgjithshëm dhe çdo prekje e prish abdesin apo ka kuptim figurativ dhe nënkupton prekje të veçantë?

Fukahatë (juristët) nuk janë të njëjtë në qasje dhe fusha e fikhut (jurisprudencës) është e gjerë për këndvështrime të ndryshme. Dijetarët kanë rënë në konsensus se ky ndryshim nuk sjell problem, nuk ka dëm, nuk i bën keq Islamit dhe nuk ia prish qejfin askujt.

Por, nëse Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Katër cilësi kush i ka, ai është hipokrit i pastër e kush ka njëren prej tyre, ka një pjesë prej pjesëve të hipokritit, derisa ta lërë atë gjë. Kur flet gënjen, kur premtot thyen premtimin, kur i lihet amanet mashtron, kur bën pakt tradhton dhe kur konfliktuon poshtëron.”* Kuptimi është i qartë dhe i prerë, nëse në fikh ka ndryshim, në moral nuk ka vend për ndryshim.

Kam vënë re se disa grupe njerëzish janë shfaqur në këto ditë. Lidhja e tyre me akiden është e zyrtë, moralin e kanë të dobët dhe nuk kanë interes për ymetin. Lënë bazat e fesë dhe virtytet e saj dhe marrin përsipër disa këndvështrime të veçanta juridike (fikhu) dhe kapen me shumë fanatizëm për to. Me të tilla gjëra i ndajnë njerëzit, kush nuk merr pjesë në mendimin e tyre, atëherë ai nuk konsiderohet mysliman.

P.sh., çështja e pantallonave dhe rrobave, nikabi (mbulesa e fytyrës), fotografimi, muzika, numri i shkallëve të minberit etj.

Moti i rizgimit islam është megjulluar prej stërzgjatjes së zhurmës në këto çështje. Debati në to e ka mundur vështirimin në të ardhmen e popujve të kërcënuar islamë dhe qëllimet kryesore fetare! Bile, kundërshtarët e Islamit, të jashtëm dhe të brendshëm e kanë goditur rëndë Islamin për shkak të kësaj situate fatkeqe dhe përçarje artificiale.

Në këto ambiente gjenden ekstremistët, të cilët bëjnë më shumë keq se sa mirë dhe me metodën e tyre vënë pengesa përpara njerëzve të mençur.

Kundërshtarët e Islamit në këto ditë zotërojnë fuqi copëtuese dhe kanë gjetur mbështetje prej kushteve të favorshme! Ne vuajmë prej të metave të trashëguar dhe bashkëkohore, nëse e zëmë veten me to, armiqtë do të na eliminojnë!

Le të jemi të qartë në mësimin e djemve fanatikë të disa mendimeve në fikh, se gjendja botërore e myslimanëve nuk e përballon këtë ngurtësi! Dhe, se është prej hajrit ta përvetësojmë këtë rregull: *“Të bashkëpunojmë për çfarë jemi dakord dhe ta justifikojmë njëri-tjetrin për ato gjëra që ndryshojmë.”*

Me të vërtetë i shkruaj këto rreshta dhe kundërshtarët e Islamit kanë filluar ta fshijnë atë nga Evropa, ku janë shuar minare e minberë, të cilët kanë qenë të mbushur me dhikrin (përmendjen) e Allahut!! Ndërkohë, disa burra e djelmosha tanë merren me debate të dhura se, a duhet të jepet sadakaja e vitrit në vlerë apo në kokrra (drithë). Ky është debat që shkëput lidhjet e të afërmve, ndërkohë që shtëpia islame po lëkundet! Prandaj, a po kthehet mendja e munguar?

Përktheu nga arabishtja:
Lavdrim Hamja



KËMISHA PREJ ZJARRI

Idris Arpat

Përgjegjësia që njeriu ka marrë mbi supe, domethënë "amaneti" hyjnor, si mëkëmbës i Allahut në tokë, është shumë e rëndë. Kjo përgjegjësi që përfshin të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e bën njeriun të jetë shumë i ndjeshëm. Kryerja e detyrave në mënyrën e duhur kundrejt vetes, Zotit dhe të gjithë të tjerëve është e lidhur me këtë ndjesi. Njeriu, të cilit i është dhënë amanet çdo gjë që gjendet në qiej dhe në tokë, ka përgjegjësi aq sa ka fuqi dhe mundësi. Kur njeriut i zgjerohet fusha e veprimit, i zgjerohet edhe fusha e përgjegjësisë. Fusha e kësaj përgjegjësie, që zgjatet nga të qenët kryetar i familjes e deri te kryeministria apo presidenca, e obligon njeriun të edukohet, në mënyrë që të arrijë ta mbartë këtë peshë të rëndë. Çështja e parë dhe më e rëndësishmeja në lidhje me këtë temë është njohja e fushës së përgjegjësisë. Ata që e kanë këtë vetëdije, përpiqen me mish e me thua për t'i arrirë aftësitë e nevojshme që do t'u duhen për t'i kryer detyrat e tyre. Nëse ata njerëz që e kanë të gjerë fushën e përgjegjësisë garojnë për ta zgjeruar edhe më shumë atë, në plan të parë nuk bëjnë një punë të mençur. Gjendja e atyre që e mbartin me vështirësi peshën e tyre apo e atyre që nganjëherë edhe nuk mund ta mbartin, por kërkojnë të mbartin edhe peshën e të tjerëve apo luftojnë për pushtet, është shumë e habitshme. Veçanërisht lufta e pamëshirshme që politikanët bëjnë kundër rivalëve të tyre, ka dalë jashtë rregullave njerëzore dhe etike. Edhe lufta i ka disa rregulla të caktuara. Atëherë, për-

se bëhet kjo luftë e pamëshirshme? Njeriu e kërkon detyrën e rëndësishme apo pushtetin për t'i shërbyer fesë, në mënyrë që të fitojë kënaqësinë e Allahut dhe të robërve të Tij ose për interesat e veta apo të të afërmeve të tij, ose për t'u bërë i famshëm. Nëse nijeti është për të fituar kënaqësinë e Allahut Teala dhe për të marrë lutjet e robërve të Tij, nuk aplikohen rrugë çnjerëzore apo amorale për atë detyrë, sepse një sjellje e tillë është në kundërshtim me nijetin. Atëherë, na ngelet pas alternativa e interesit dhe e famës. Ata që luftojnë për t'u ngritur dhe për pushtet me këtë nijet, nuk mund t'i japin shoqërisë asgjë tjetër përveçse dëmit.

Udhëheqja, veçanërisht udhëheqja e shkallës së lartë është një këmishë prej zjarri. Ajo nuk është një këmishë që mund të vishet për ambicie, pasuri apo famë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë në lidhje me këtë çështje: *"Ju do jeni shumë ambiciozë në çështjen e udhëheqjes, por kjo detyrë do të jetë pendim në Ditën e Kiametit (për ata që nuk ia japin hakun)."* Kur Ebu Dherr Gifari i kërkoi një detyrë në udhëheqje të Dërguarit të Allahut (a.s.), Pejgamberi ia vendosi dorën në sup dhe i tha: *"O Ebu Dherr! Ti je një njeri i dobët, ndërsa ky është një amanet. Në Ditën e Kiametit mund të jetë poshtërim dhe pendim. Kjo nuk përfshin atë që e kryen siç duhet përgjegjësinë e tij."* (Muslim, Ibn Maxhe, 16.)

Ata që arrijnë pozita të caktuara, veçanërisht ata që janë në pozicionin e shefit, kapen nga sëmundja e mburrjes dhe e mendjemadhësisë, pa qenë të

vetëdijshëm për këtë. Sikur Nemrudi dhe Faraoni të ishin njerëz të thjeshtë, nuk do të tentonin të pohonin se ishin hyjni. Tani, le të flasim rreth një ngjarjeje interesante për psikologjinë e lidershipit. I Dërguari i Allahut, (a.s.), e caktoi Mikdad bin Amrin komandant të një njësie të vogël ushtarake për të realizuar një operacion. Kur u kthye, e pyeti: *“O Ebu Ma’bed! Çfarë mendon për udhëheqjen?”* Ai i tha: *“Kur u nisëm për në operacion, nuk mendoja se isha më i lartë se ushtarët që kisha nën urdhra, por në kthim, fillova t’i shikoja ata si robërit e mi.”* Pastaj, i Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: *“O Ebu Ma’bed! Ja, kështu është udhëheqja. Përveç për ata që Allahu i mbron nga e keqja e pozitës.”* Udhëheqja, me të vërtetë është një këmishë prej zjarri, sepse udhëheqja është mbartje e peshës së të gjithë atyre që janë nën urdhra. Kur Umeri i shkroi një letër valiut të Basrës, Ebu Musa Esh’ariut, i dha këto këshilla: *“Vizitoji të sëmurët! Merr pjesë në ceremonitë mortore! Mbaje derën hapur ndaj popullit! Interesohu vetë për nevojat e tyre! Ti thjesht je një prej tyre, vetëm se Allahu Teala të ka dhënë peshën më të rëndë ndër ta. Jam njoftuar se ushqimi e veshmbathja jote dhe e familjes tënde janë të ndryshme nga ajo e popullit dhe se je zhytur në shtirje. Të tërheq vërejtjen që të mos biesh në shkallën e kafshëve! Kur kafshët zhyten në një luginë me bar, nuk mendojnë asgjë përveçse për t’u ngopur. Nëse devijon udhëheqësi, devijojnë edhe të udhëhequrit. Udhëheqësi më i keq është ai njeri që bëhet shkak për devijimin e njerëzve.”* Umeri, i cili i dha këto këshilla valiut, së pari ishte vetë ai që i respektonte më shumë. Abdurrahman bin Auf (r.a.), tregon: *“Një natë më thirri Umeri dhe më tha: Një karvan po bun në hyrje të Medines dhe kam frikë mos u vidhen mallrat kur t’i zërë gjumi.”* Shkova bashkë me të. Kur arritëm, më tha që të flija, ndërsa vetë i bëri rojë karvanit përgjatë gjithë natës. Përsëri, Umeri e vendosi dorën në plagën e gungës së një deveje dhe tha: *“Kam frikë se do të merrem në llogari edhe për atë që të ka ndodhur ty.”* Edhe kjo fjalë e Umerit (r.a.), është shumë e njohur: *“Nëse një ujk ha një dele në buzë të (lumit) Tigër, përgjegjës është Umeri.”*

Udhëheqësi duhet të sillet me drejtësi kundrejt atyre që i udhëheq, nuk duhet t’u premtojë gjëra që s’mund t’i realizojë dhe nuk duhet t’i gënjejë. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë në lidhje me këtë çështje: *“Nëse dikush, të cilin Allahu Teala e ka bërë udhëheqës, vdes duke i mashtruar ata që i udhëheq, Allahu nuk e fut në xhenet.”* (Buhari, Ahkam. 8.)

Njerëzit me autoritet dhe pushtetarët nuk duhet t’ua dhurojnë të afërme apo miqve të tyre detyrat e shtetit, por në krye të tyre duhet të sjellin njerëz të specializuar dhe të besueshëm, përndryshe, shkatërrojnë veten, ata që kanë sjellë në detyrë dhe vetë detyrën. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Kush sjell në krye të një detyre një të afërm ngaqë e do, edhe pse mund*

të gjejë dikë më të aftë se ai, nuk do ta ndjejë erën e xhenetit.” (Kenzu’l-Ummal, 6/39.) Udhëheqësi është i obliguar të sillet si një baba i mëshirshëm kundrejt atyre që ka nën udhëheqje. Ata duhet t’i trajtojë si fëmijët e tij. I Dërguari i Allahut, (a.s.), është sjellë si një baba i drejtë dhe i mëshirshëm kundrejt umetit. Në shtëpinë e nënës sonë, Aishes ka thënë: *“O Zot! Jepi vështirësi atij që merr përsipër një punë të umetit dhe i vë në vështirësi ata dhe trajtoje me mëshirë atë që merr përsipër një punë të umetit dhe i trajton me mëshirë ata!”* (Muslim, Imare 19.) *“Ai që merr përsipër udhëheqjen e myslimanëve dhe nuk i mbron ata siç mbron veten dhe familjen e tij, nuk do ta ndjejë erën e xhenetit.”* (Mexhmau’z-Zevaid 5/211.)

Udhëheqësi duhet të ketë më shumë kujdes ndaj pasurisë së shtetit se sa ndaj pasurisë së vet. Siç nuk duhet të bëjë vetë korrupsion, nuk duhet t’u japë mundësi edhe të tjerëve për këtë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë në lidhje me këtë çështje: *“Nëse dikush që i kemi dhënë një detyrë, fsheh nga ne një gjilpërë apo diçka më të vogël se ajo, ka tradhtuar dhe do ta sjellë atë Ditën e Kiametit.”* (Muslim, Imare, 30.)

Si do të shpëtojnë nga mëkatet që kanë bërë, ata të cilët garojnë për kolltuk pa përgjegjshmëri dhe i kanë bërë popullit padrejtësi të paimagjinueshme për të mos e lënë pushtetin, ndërkohë që udhëheqja është një detyrë kaq e rëndë dhe kërkon kaq shumë përpikëri? Si dhe me ç’fytirë do ta japin llogarinë e popullit ata që ua kanë shkelur të drejtat, i kanë shtypur dhe i kanë skllavëruar njerëzit, ndërkohë që janë të paaftë të japin edhe llogarinë e tyre? Ata që nuk mendojnë për gjykimin e madh dhe luftojnë për kolltuk, në mënyrë që të arrijnë interesat e kësaj bote provizore, po vrapojnë drejt xhehenemit, ngaqë i kanë verbëruar ambiciet e tyre. Edhe fundi i tyre në këtë botë është shumë mësimdhënës. Përfundimi tragjik i atyre që e humbin pushtetin për shkak të zemërimit të Allahu Teala dhe pastaj, me kryengritjen e popullit që e kanë shtypur, është shumë tmerrues. Historia jonë e afërt është e mbushur me shembuj të tillë. Fundi i atyre që në fillim e shikonin veten si një nga populli, por kur u ulën në kolltuk e shikonin popullin si robër, është më i keq se i robërve. A është mençuri që të poshtërohesh në këtë botë dhe në botën tjetër, ndërkohë që pozitën e kësaj bote mund t’i përdorësh për të fituar Ahiretin e përhershëm, ndërkohë që mund të punosh dhe të ndahesh nga pozita në mënyrë të ndershme duke fituar kënaqësinë e Allahut Teala, duke marrë lutjet e njerëzve dhe duke ua dorëzuar pozitën vullnetarisht atyre që janë të aftë për të? Allahu i Madhëruar na bëftë prej atyre që e llogarisin fitimin dhe dëmin e vërtetë dhe nuk e shkatërrojnë dynjanë e ahiretin e tyre me tiraninë që jep lakmia!



Të sprovuarit, me pasurin

Alshe Shener

*"Kështu ndodhi edhe me Karunin,
Faraonin dhe Hamanin!
Atyre u erdhi Musai me prova të qarta,
por ata treguan mendjemadhësi në Tokë
dhe nuk i shpëtuan dënimit."*

(Ankebut, 39)

Karuni përfaqëson njeriun e kamur me pasuri materiale, Faraoni njeriun me fuqi e pushtet, ndërsa Hamani njeriun me forcën e dijes. Në të njëjtën kohë, ata përfaqësojnë edhe njerëzit që, megjithëse janë të kamur, përsëri janë të falimentuar e të humbur.

Këta tre emra të famshëm, që e lëshuan veten në humnerë prej majës më të lartë të pasurive të tyre, duke u bërë copë e thërrime në pikëpamjen morale, edhe pse me emra të ndryshëm, janë përsëritur vazhdimisht gjatë gjithë historisë në jetën e shumë njerëzve. Përveç kësaj, për ta dëshmuar këtë përsëritje të pahijshme nuk është e thënë të shohim vetëm këta tre emra në histori apo ata që kanë arritur majën dhe fundin e tyre, por mund të shohim edhe në shumë individë të tjerë. Në fillim të shohim tek vetja jonë... tek personi që na del përpara kur shihemi në pasqyrë...

Le të hyjmë brenda një shembulli. Le të marrim Karunin, fuqia e pasurisë së të cilit e la atë të pa-fuqishëm...

Të gjithë e njohin Karunin. Edhe ata që luajnë rolin e tij, edhe ata që nuk e luajnë. Heroi kryesor që u mposht nga kjo botë... Një njeri që ia atribuoi vetes pasurinë dhe pronat, që i pandehi të pavdekshme dhe që zuri fundin e tokës me një përfundim të papritur, duke hyrë në varr ende pa vdekur. Me sa duket, as vetë ai dhe as të tjetër nuk e pritnin që fundi i tij të ishte i tillë.

Ndërkohë që po shkruaj këto rreshta, po mendoj për sjelljet e mia që u ngjajnë atyre të Karunit. Mendoni edhe ju se si jemi llastuar prej mirësive që zotërojmë dhe se si jemi larguar prej parimeve tona! Njeriu mund të shfaqë sjellje të Karunit në çdo nivel. Gjendja e tij mund të mos jetë gjithmonë e njëjta. Pra, gjendja e sprovës...

Në fakt, ky është një model negativ që duhet ta lexojnë mirë të gjithë ata, të cilët kanë mundësi të jetojnë një jetë të ngjashme. Përveç kësaj, nuk është e thënë që njeriu të jetë medoemos i pasur sa Karuni, që të bëjë kujdes të mos bëhet si ai. Në fakt, çdo njeri mjafton ta bëjë këtë zgjedhje e përjeton këtë rol me hapin dhe forcën e vet. Njeriu ka një ego, e cila mund të llastohet edhe me gjëra shumë të thjeshta. Bie fjala, ai kujton se është dikushi edhe kur vesh një palë këpucë të një marke të famshme. Shembull i kësaj është se ai priret të ndryshojë edhe ecjen e tij kur kalon në një rrugë me baltë.

Mirëpo, a nuk janë këto pyetjet më kryesore që duhet t'i bëjmë vetes:

Kush je ti? Kujt i takon? Ti e krijove veten? Ku dhe prej kujt e more jetën? A mos e bleve vallë? Sa e more dhe për sa ditë? E bleve me borxh apo me para në dorë? Ti je pronari i vërtetë dhe absolut i saj? Ti je zotëruesi i trupit tënd, që është toka e ekzistencës tënde dhe i shpirtit tënd, që është si universi i pafund? A nuk mund ta marrë kush atë pa dashur ti? A je kalimthi apo i përjetshëm këtu? Kur të të kërkohet të braktisësh veten, a do të mundesh t'i mbyllësh dyert e shpirtit dhe të kundërshtosh? A do të mund t'ia dalësh mbanë të mos mposhtesh nga vdekja? A s'është fatkeqësi që dikush, i cili nuk ka asnjë ndikimin në përgjigjen ndaj këtyre pyetjeve, të mburret e të lavdërohet? Nëse ke prej këtyre cilësive që përmendëm, atëherë çohu dhe krenohu; lavdërohu. Deklarojua të gjithëve se sa i meriton lëvdatat. Kjo është e drejta jote.

Jo? A nuk je aq i madh sa të gëlltitësh në thellësinë tënde të panjohur fillimin dhe mbarimin e burimit të ekzistencës, apo nuk je aq i lirë në atë nivel sa të mbështillesh në të panjohurën duke tërhequr në ekzistencën tënde të gjitha ekzistencat? Vallë, mos je i lidhur me ndonjë burim tjetër; madje i varur prej tij?..

A nuk je ti vetë amanet i vetes tënde? Ti je përgjegjës të bartësh një shpirt brenda këtij trupi arkivol. Madje ta bartësh me krenari... një shpirt që i takon një force superiore, që do të kthehet tek Ai. Që është drejtuar për nga Ai, është përgjegjës ndaj Tij dhe që një ditë do të merret në llogari!

Atëherë, është e pakuptimtë të vazhdosh të mburresh... Lëre dhe mos e gënje veten dhe të tjerët me gjëra të ulëta. Në fakt, të gjithë janë si ti... Askush nuk është më i mirë dhe më i keq se ti. Nga kjo pikëpamje, qoftë më i thjeshtë apo më kompleks, në thelb jeni të njëjtë me njerëzit që nuk kanë gjë tjetër përveç vetes dhe me ata që kanë shumë gjëra. Të gjithë janë përgjegjës për aq pasuri sa kanë dhe jo përgjegjës për aq varfëri sa kanë...

Mirëpo, ka vetëm një rrugë për ta bartur këtë pasuri drejt pafundësisë. Përdorimi në mënyrë të drejtë, është i dobishëm për ty në këtë botë. Ndërsa ndarja e drejtë, të jep mundësinë të kesh pasuri në botën tjetër, që në këtë botë. Ato që ndajmë, janë investimet tona për botën tjetër. Pasuria në botën tjetër varet nga ajo që ndan në këtë botë. Pasurinë që do ta përdorësh në të ardhmen, e ndan tani me të tjerët, të varfrit dhe nevojtarët. Më vonë, prodhimi i kësaj pasurie që ndan dhe fitimi prej saj, kthehet përsëri tek ti. Në këtë mënyrë,



ti mund të bësh investime për të ardhmen.

Urtësia; të shohësh të ardhmen me dy sy. E ardhmja kalimtare është ajo që mbaron me vdekjen. Kjo është e domosdoshme. Ndërsa e ardhmja e përjetshme është ajo që vjen pas vdekjes. Pra, kur vdekja të çlirojë prej lidhjes së përkohshme, do të kesh mundësi të fitosh pasurinë tënde në atë liri, në atë jetë të dytë. Ky është rregulli. Nuk duhet ta harrosh burimin. Nuk duhet t'ia kthesh shpinën qiellit prej nga ke rrjedhur. Do t'i kthesh fytyrën dhe pikë! Rregulli i kësaj loje është se nuk mund të bësh numra.

Pasuria e jetës, për shembull; është një trofe, çmimi i të cilit është njerëzia. Kemi pasuri që ndonjëherë na djeg duart e ndonjëherë na djeg shpirtin... Ka prej asaj pasurie që djeg ëndrrën dhe mendimin, shpërndan dritën e intelektit. Ka pasuri materiale e shpirtërore...

Ndërkohë që nderi është pasuria më e rëndësishme e njeriut, edhe paratë, pozita, cilësitë fizike, shtëpia, makina, këpuca apo edhe një lidhëse këpucësh janë pasuri. Kur Pejgamberi ynë (a.s.), tha se, *"Do të pyeteni edhe për dy të zeza"*, e ka pasur fjalën për hurmën dhe për diçka tjetër më të thjeshtë.

Kur i përkujtohet llogaria, tek njeriu aktivizohet vetëdija e përgjegjësisë dhe e përdorimit të drejtë. Çdo gjë që ke, është pasuria jote. Çfarëdo që nuk ke, është varfëria jote. Pasuri do të thotë të pyetesh për atë që ke, ndërsa varfëri do të thotë të mos pyetesh për atë që s'ë ke. Dihet se të jesh i pasur, shton pyetjet dhe përgjegjësitë, vështirëson punën dhe vë në rrezik suksesin në jetën tjetër.

Mirëpo, kjo nuk do të thotë kurrë që njeriu të bjerë në një nivel të varfërisë që të ketë nevojë për të tjerët, në pozitën e lypsarisë që nuk i ka hije njeriut, në dembelizëm e parazitizëm. Në fakt, këtu bëhet fjalë vetëm për tepricën jashtë nevojave. Të gjithë e dimë se problem nuk janë vetëm pasuria dhe prona, por çdo gjë që është teprice.

Groposja e Karunin në fund të dheut, së bashku me sarajet e tij, është një përmbysje e çuditshme, e cila do të thotë rënie në nivelin më të ulët. Ka pasuri që fitohen direkt pa kryer asnjë punë. Dhurimi i pasurisë dhe fitimi i saj pa u munduar aspak të bën të mendosh se përgjegjësia ndaj saj është më e madhe. Nëse kemi parasysh se edhe zekati që është një urdhër i prerë për ndarjen e pasurisë, i cili është urdhëruar pasi një sasi e caktuar pasurie të jetë bërë e qëndrueshme në jetën e një individi, atëherë mund të themi se një pasuri e fituar

pa punë, si trashëgimia, e cila u ngelet brezave pasardhës, duhet të ketë përgjegjësi më të madhe. Pra, duket e logjikshme se ndarja e pasurisë që fitohet pa punë, ka më shumë përgjegjësi dhe duhet bërë sa më shpejt.

Ndërsa, kur bie fjala për fitimet me punë, fitimi i tyre në rrugë të lejuar, është përgjegjësia e parë ndaj pasurisë, që para se ajo të fitohet. Pas kësaj, vjen drejtësia në përdorimin e saj. E më pas, vjen drejtësia në ndarjen e saj. Në fakt, në këtë ndarje bëhet fjalë për pjesën që i jepet të zotit të vërtetë të saj. Pra, pasuria ndahet midis teje dhe Allahut. Kjo i ngjan marrëveshjes midis investuesit që jep kapitalin dhe atij që e vë në punë dhe prodhon. Ti je i detyruar të veprësh në bazë të marrëveshjes që ke bërë me pronarin e vërtetë. Këto janë edhe rregullat bazë që ka vendosur Islami në lidhje me fitimin, menaxhimin dhe ndarjen. Mirëpo, nëse ti e prish marrëveshjen, fiton pasuri në mënyrë të padrejtë, prodhon në mënyrë të paekuilibruar e jashtë nevojave, e menaxhon duke e konsumuar pa kritere dhe nuk e ndan, por e mban për vete, ashtu si edhe Karuni, para së gjithash humb nderin, e më pas groposesh në fund të dheut.

Nisur nga ky fakt, edhe pse mund të fundosesh në fund të dheut, jeta e shkurtër që ty të duket e gjatë, në të vërtetë është shumë e shkurtër. Mbase edhe për një kohë të shkurtër mund të qëndrosh në pallate madhështore, në rezidenca, poste të larta, në menaxhimin e pasurive të mëdha ose në nivele të larta të disiplinave shkencore "të padiskutueshme" me bagazhin tënd të paarritshëm intelektual. Mirëpo, pa kaluar shumë, e vërteta e vdekjes do të të çojë edhe ty në varr, në fund të dheut.

Këto këshilla të përsëritura, që në përgjithësi konsiderohen të mërzitshme, nuk duhet të mërzitin askënd, sepse këto situata përjetojnë shpesh gjatë jetës. Prandaj, është e kotë t'i ikësh dëgjimit të një teme prej së cilës nuk mund të shpëtosh gjatë jetës.

Le të qetësohemi pak dhe t'i thjeshtëzojmë këshillat tona. Malli nuk është e vetmja pasuri. Madje, është një nga pasuritë më të ulëta. Duke filluar që prej pasurive konkrete e materiale, niveli i pasurisë ngrihet deri tek frymëzimi, kuptimi dhe urtësia. Urtësia është pasuria më e bukur që i jepet një njeriu, i cili e meriton. Po ashtu edhe nderi... Që pasuria të mos bëhet një nga vdekjet tona dhe të njerëzisë sonë, por të jetë gjallëri për ne, atëherë të gjithë duhet të vetëdijësohemi ndaj kuptimit të vërtetë të saj.

Nëse ti e prish marrëveshjen, fiton pasuri në mënyrë të padrejtë, prodhon në mënyrë të paekuilibruar e jashtë nevojave, e menaxhon duke e konsumuar pa kritere dhe nuk e ndan, por e mban për vete, ashtu si edhe Karuni, para së gjithash humb nderin, e më pas groposesh në fund të dheut.



NJERIU DHE BOTA TJETËR

Duran Eklzer

Kurani Fisnik është shpallja e fundit, e dërguar për udhëzimin e njerëzimit. Ai na lajmëron se Muhamedi (a.s.), është peygamberi i fundit dhe se Islami është feja e fundit e plotësuar me dërgimin e tij. Për rrjedhojë, çdo gjë në këtë botë që ka lidhje me njeriun, ai mund ta gjejë në Kuran dhe në Sunetin e Pejgamberit (a.s.), që është edhe reflektimi i tij (Kurani).

Kurani Fisnik i drejtohet direkt njeriut dhe kërkon që edhe njeriu të krijojë lidhje me të. Argumenti më i fortë i këtij fakti është se në shumë ajete të Kurani Fisnik theksohet aftësia që ka njeriu për të menduar. Nëse do të na duhej të jepnim një shembull, mund të përmendim ajetin 21, të sures Hashr, në të cilin urdhërohet: **“Sikur këtë Kuran t’ia shpallnim ndonjë mali, ti do ta shihje atë (mal) të përulur dhe të copëtuar nga frika e Allahut. Shembuj të tillë Ne ua japim njerëzve, me qëllim që ata të meditojnë.”**

Nëse e shohim Kurani Fisnik në mënyrë të përgjithshme, do të vëmë re se në shumë ajete të tij theksohet mjaft edhe bota tjetër. Këtë e vëmë re në mënyrë të veçantë në suret e fundit të Kurani, ku kjo çështje na del përballë në mënyrë të shpeshtë së bashku me ndodhinë e Kiametit. Shkaku i kësaj, është që njeriu, të cilit i drejtohet Kurani, të përgatitet për jetën e përjetshme, e cila vjen pas kësaj jete dhe ku do të japë llogari për çdo gjë që ka bërë. Përfshi edhe peygamberët, të gjithë do të japin llogari në Ditën e Kiametit për veprat e tyre në këtë botë. Në një ajet fisnik, urdhërohet: **“Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!”** (Tekathur, 8)

Kurani Fisnik shprehet se njeriu ka dy jetë. Këto janë jeta e kësaj bote dhe e botës tjetër. Jeta e kësaj bote është jeta e tanishme, në të cilën gjendemi dhe ku po jetojmë realitetin e saj. Mirëpo, jetës së kësaj bote, e cila siç shprehet edhe Kurani, është e shkurtër aq **“sa hap e mbyll sytë”**, një ditë do t’i vijë fundi. Dhe në këtë botë të fundme duhet të fitojmë botën e pafundme. Nga kjo e vërtetë është e pamundur të iket. Prandaj, nuk duhet të mashtrohemi nga bukuria e jetës së kësaj bote të përkohshme dhe të hedhim pas shpine jetën e përjetshme.

Njeriu, për shkak të natyrës së tij, zgjedh më të lehtë dhe më të shpejtë. Ky fakt, në Kurani Fisnik shprehet me këto fjalë: **“Jo, por ju doni të shpejtën (jetën kalimtare) dhe e hidhni pas shpine jetën e botës tjetër!”** (Kijame, 20-21) Po ashtu, Kurani Fisnik shprehet se jeta e botës tjetër është më e mirë se jeta e kësaj bote, por njerëzit preferojnë jetën e kësaj bote. Ndërsa në ajetet 16-17 të sures Ala, urdhërohet: **“Por ju, përkundrazi, më shumë po e parapëlqeni jetën e kësaj bote, ndonëse jeta tjetër është më e mirë dhe e amëshuar.”**

Si përfundim, nuk duhet të harrojmë se ka vdekje, ringjallje, llogaridhënie, peshore, xhenet dhe xhehenem. Shkurtimisht, ekziston një jetë tjetër që na pret dhe që është e përjetshme. Allahu na bëftë prej besimtarëve të mirë, që e mbajnë gjithmonë gjallë vetëdijen e besimit. Amin!



All Riza Temel

E gjithë çështja është që ta njohim të vërtetën për të vërtetë, të gabuarën për të gabuar dhe të mos i ngatërrojmë këto të dyja me njëra-tjetrën. Edhe Allahu i Madhëruar kështu na urdhëron: **“Mos e përzieni të vërtetën me të pavërtetën, dhe të vërtetën mos e fshihni me vetëdije.”** (Bakara, 42) **“...Përse e pësh-tjelloni të vërtetën me të pavërtetën dhe përse e fshihni të vërtetën me qëllim?”** (Al 'Imran, 71) **“... Tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembëra...”** (Bakara, 256)

Toleranca është sugjeruar në Kuranin Fisnik dhe ve-çanërisht është nxjerrë në plan të parë si një metodë udhëzimi dhe predikimi: **“Duroji llomotitjet e atyre dhe largohu nga ata në mënyrë të hijshme!”** (Muz-zemmil, 10) **“...Nëse nuk i vini re fyerjet e tyre, tregoni tolerancë dhe ua falni, ta dini se Allahu është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë.”** (Tegabun, 14) **“Largohu prej tyre (o Muhamed) dhe thuaju: “Paqe!” Ata së shpejti do ta marrin vesh.”** (Zuhruf, 89)

Në këtë botë sprove që po jetojmë, secili prej nesh do ta shohë rezultatin e çdo gjëje që ka bërë, e mirë apo e keqe qoftë ajo. Në një vend që nuk ka liri, nuk ka as spro-vë. Krijuesi i Lartësuar i ka lënë të lirë njerëzit edhe në çështjen e besimit dhe mohimit. **“Sikur të donte Zoti yt, do të besonin të gjithë ata që gjenden në tokë. Vallë, ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?”** (Junus, 99) **Dhe thuaj: “E vërteta ka ardhur nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë”** (Kehf, 29) **“Natyrisht që Ne i treguam atij rrugën e drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose**

mosmirënjohës.” (Insan, 3) **“S'ka detyrim në fe, sepse tashmë është dalluar e drejta nga e shtrembra!”** (Bakara, 256)

Nëse shikojmë praktikën e Muhamedit (a.s.), i cili ishte peygamberi i fundit që u predikoi njerëzve me-sazhet hyjnore, vëmë re se ai ka shfaqur një shembull tolerance të gjerë. Përgjatë njëzet e tre viteve si pey-gamber, nuk është parë të sillet ashpër apo keq ndaj asnjë njeriu. Sepse të gjithë njerëzit si potencial janë umet i tij. Nëse nuk i besojnë sot atij dhe parimeve që ka sjellë, ka mundësi t'i besojnë nesër. Mbylljen e rrugës së mundësisë për të besuar dhe shdërrimin e saj në diçka të pamundur, nuk mund ta ketë të drejtë askush. Thirrja në besim së pari u bëhet atyre që nuk dinë dhe që nuk besojnë. Kusht është fitimi i zemrave të atyre që akoma nuk janë udhëzuar në Islam.

Në të vërtetë, detyra e Peygamberit është predikimi. Ndërsa udhëzimi shfaqet si rezultat i takimit të vull-netit të robit me vullnetin hyjnor. Allahu Teala thotë në Kuran: **“Prandaj këshilloji** (njerëzit o Muhamed), **se ti je vetëm këshillues dhe nuk je ngarkuar t'i detyrosh ata me forcë!”** (Gashiye, 21-22)

Saffan b. Umejje, i cili kishte frikë se do të kapej dhe do të vritej kur u çlirua Meka, u arratis nga Meka për të shkuar nga ana e Jemenit dhe arriti në Xhidde. Por sahabi Umejr b. Vehbi pati marrë garanci për të nga i Dërguari i Allahut (a.s.), si ndërmjetësues. Kur Saffani arriti te i Dërguari i Allahut (a.s.), kërkoi kohë dy muaj për të pranuar Islamin dhe u shpreh se dëshironte të përdorte të drejtën e tij për të zgjedhur. Edhe i Dërguari

i Allahut, alejhi's-salam, i dha katër muaj kohë dhe i tha që ta përdorte të drejtën e tij për të zgjedhur.

Të gjithë e dimë se kur u çlirua Meka, Pejgamberi u tha kurejshëve që ishin mbledhur në Qabe: *"Shkoni! Të gjithë jeni të lirë."* Sikur të dëshironte, i Dërguari i Allahut (a.s.), mund t'i ekzekutonte mekasit të cilët i patën bërë atij tortura marramendëse. Por, nëse do vepronte në këtë mënyrë, atëherë nuk do kishte ndonjë ndryshim prej mbretërve apo komandantëve, sepse ai ishte Pejgamberi i mëshirës. Edhe lufta që bënte ishte mëshirë.

Xhabiri, i cili ishte prej sahabëve, transmeton: "Bashkë me të Dërguarin e Allahut (a.s.), gjendeshim në një luftë, e cila u quajt dha'tu'r-rika. Kur gjenim ndonjë pemë që kishte hije, e kishim si zakon për t'ia lënë të Dërguarit të Allahut (a.s.). Një burrë prej mushrikëve (politeistëve) shkoi, mori shpatën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), e cila ishte e varur në pemë dhe i tha:

-A ke frikë nga unë?- I Dërguari i Allahut (a.s.), iu përgjigj: *"Jo."* Burri i tha: "Kush mund të të shpëtojë tani nga dora ime? I Dërguari i Zotit i tha: *"Allahu."* Burrit i ra shpata nga dora. Këtë herë shpatën e mori Pejgamberi dhe i tha: *"Po tani, kush mund të të shpëtojë ty nga dora ime?"* Beduini iu përgjigj: *"Ji një ndëshkues i mirë!"* Pejgamberi i tha bedunit: *"A mund ta pranosh dhe të dëshmosh se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Allahut?"* Burri i tha: *"Jo, nuk pranoj, por të pretoj se nuk do të luftoj më dhe se nuk do gjendem në radhët e ndonjë populli që do luftojë kundër teje."* Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (a.s.), e la të lirë atë. Ai u kthye pranë shokëve të tij dhe u tha: *"Po vij nga njeriu më i mirë."* (Rijazu's-Salihin, Hadithi nr: 79.) I Dërguari i Allahut (a.s.), e fali këtë beduin dhe nuk e detyroi të pranonte Islamin. Kjo dha rezultate më të mira në ditët e ardhshme. Faktikisht, besimi që mbështetet në frikë dhe presion, nuk ka ndonjë dobi. Frika dhe presioni nxjerrin vetëm hipokritë. Besimi bazohet te bindja, ndërsa sistemet tirane bazohen te presioni dhe imponimi. Të besosh dhe të mendosh në ato sisteme, është e lidhur me lejen. Faraoni u pati thënë kështu magjistarëve që ranë në sexhde dhe besuan përballë mrekullisë së Musait (a.s.): *"...Ju guxoni ta besoni Atë pa lejen time? Në të vërtetë, ky është një komplot që keni përgatitur, me qëllim që të nxirrni nga qyteti banorët e tij! Keni për ta parë!"* (Araf, 123) Edhe babilonasit patën thënë kundër Ibrahimit (a.s.), i cili shprehej se adhurimi i idhujve nuk ishte gjë tjetër përveçse një budallallëk: *"...Digjeni atë dhe ndihmoni zotat tuaj, nëse doni të bëni ndonjë vepër!"* (Enbija, 68)

Bota perëndimore, e cila tenton të na japë ne mësim për tolerancën dhe të drejtat e njeriut, le t'i hedhë

një sy vetes dhe historisë së saj. Lëri kryqëzatat që kanë bërë kundër myslimanëve dhe shpirtin kryqtar që akoma e mbartin, por edhe ndërmjet tyre nuk kanë mundur të shfaqin tolerancën më të vogël. Në kohën e mbretit Charlesi i 9-të, të gjithë fëmijët, gratë dhe të moshuarit prej protestanëve që ranë në dorën e katolikëve, u vranë dhe u dogjën shtëpitë në Paris natën e 23 Gushtit të vitit 1572 për të parandaluar përhapjen e protestantizmit. Vetëm në një natë, u vranë pesë mijë vetë në Paris. (Ahmet Riza, Paturpësia e politikës së perëndimit, fq. 104.)

Pohimi i Gustave le Bonit është drithërues: "Historitë e vrasësve dhe të torturave të ndryshme që të krishterët u bënë myslimanëve të cilët kishin humbur, është e pamundur të lexohen pa t'u dridhur shpirti. Ata i pagëzonin myslimanët me imponim. I dorëzonin në gjykatat e inkuizicionit (gjykata të formuara në të kaluarën prej të krishterëve për të ndëshkuar ata që mbartnin besime të tjera) dhe i digjin të gjallë. Kryepriifti Toledo i vrau të gjithë arabët që nuk e pranuan krishterimin. U vranë tre milion arabë që përbënin klasën më të lartë, më intelektuale dhe industriale të Spanjës." (Ahmet Riza, Paturpësia e politikës së perëndimit, fq. 122.)

Kisha, e cila e ftonte popullin për në luftën e kryqëzatave, pati shpallur se edhe mëkatet e mëdha, si vrasja e një njeriu mund të falet duke derdhur gjakun e një myslimani.

Historia e Evropës, nga njëra anë është historia që vetëm tolerancën nuk e njeh. Kisha i pati ndaluar rreptësisht mjekët që të vizitonin apo mjekonin pacientin që nuk kishte dokument i cili vërtetonte se priifti ia kishte falur mëkatet. (Ahmet Riza, Paturpësia e politikës së perëndimit, fq. 255.) Filozofi Desarts (Dekarti) u detyrua ta lërë Francën për shkak të librit që kishte shkruar. Sikur të mos strehohej në Stokholm, do të digjej i gjallë. J. J. Roussou u syrgjynos nga Franca dhe vepra e tij me titull "Emill" u dogj me vendim parlamenti për shkak të urdhrat të kryepeshkopit të Parisit. (Ahmet Riza, Paturpësia e politikës së perëndimit, fq. 262.)

Të akuzosh Islamin dhe të gjithë myslimanët në përgjithësi për terrorizëm dhe intolerancë, duke parë ngjarjet e terrorit dhe dhunës që nuk kanë lidhje me Islamin dhe që në përgjithësi burojnë nga zemërimi dhe mungesa e rrugëzgjdhjes e disa myslimanëve që janë vënë në pozita të vështira, është pandërgjegjshmëri e madhe. Toleranca është baza e besimit islam. Rreshtat tona le t'i përfundojmë me deklarin e priiftit Abbe Michon: "E vërteta që tolerancën, e cila është rregulli bazë i humanizmit, të krishterët e kanë mësuar nga myslimanët, është shumë pikëlluese." (Ahmet Riza, Paturpësia e politikës së perëndimit, fq. 156.)



Ibrahim Arpaxhë

Kibla e zemrës, Kibla e trupit

Në fjalor, kuptimi i fjalës “kible” është drejtim apo anë nga e cila drejtohesh. Ndërsa si term nënkupton drejtimin nga i cili kthehemi kur falim namazin, pra Qabja. Drejtimi nga Qabja bëhet edhe gjatë ezanit, ikametit, therjes së kafshës, duasë dhe varrimit të xhenazes.

Në disa adhurime botëkuptimi i drejtimit është i rëndësishëm, si për nga aspekti i disiplinës, ashtu edhe nga aspekti i bashkimit në një qendër shpirtërore. Ky orientim shpreh, jo vetëm unitetin në planin shpirtëror me Allahun, i cili është i pavarur nga “hapësira”, por edhe unitetin e umetit islam dhe të njerëzve që drejtohen nga e njëjta qendër shpirtërore. Uniteti dhe bashkimi i njerëzve që kanë një qëllim dhe një besim, arrihet me demonstrime të përbashkëta materiale dhe shoqërore. Kibla është jashtëzakonisht e rëndësishme për nga aspekti i garantimit dhe shfaqjes së unitetit e bashkimit të umetit. Ajo është një nga kushtet e domosdoshme të namazit. Për shkak se myslimanët bashkohen në një kible të përbashkët, ata quhen edhe “Ehl-i Kible/ njerëzit e kiblës”. Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë:

“Kush e fal namazin tonë, kthehet nga kibla jonë dhe ha prej mishit të kafshëve që therim ne, ai është nën mbrojtjen/përgjegjësinë e Allahut dhe të Pejgamberit të Tij. Prandaj mos e prishni garancinë e Allahut.” (Buhari, Salat, 28.)

Fjala “kible” kalon shtatë herë në pesë ajete të Kuranit Fisnik. Meqenëse kibla shpreh një drejtim, një orientim, ky drejtim duhet të jetë patjetër i përsosur dhe duhet të synojë mirësinë dhe bukurinë. Kuptimi i vërtetë i kiblës, është të drejtohesh për të fituar kënaqësinë e Allahut. Ja si shprehet Allahu i Madhëruar në Kuran: **“Të Allahut janë Lindja dhe Perëndimi, pra, ngado që të ktheheni andej është Fytyra (ana/kënaqësia) e Allahut...”** (Bekare, 115) Ndërsa Rasulullahu (a.s.), e ka përkufizuar në këtë mënyrë qëllimin e kiblës: “Kur dikush prej jush drejtohet nga kibla, është drejtuar nga Allahu.” (Ebu Daud, Salat, 22.)

Orientimet, të cilat nuk kanë për qëllim fitimin e kënaqësisë së Allahut, nuk kanë asnjë të mirë. Ndërsa në drejtimin nga e mira, gjendet kënaqësia e Allahut. **“Çdokush ka një drejtim nga i cili kthehet. Pra, bëni garë me njëri-tjetrin për punë të mira. Kudo që të gjendeni, Allahu do t’ju mbledhë të gjithëve...”** (Bekare, 148) Pra, përdërisa mbledhja e fundit do të jetë para Allahut, në këtë rrugë, përfundimi i së cilës është mbledhja, duhet të hyjmë me dëshirë dhe të mbledhim sa më shumë të mira. Rruga e vërtetë dhe drejtë, është ajo që të çon në kënaqësinë e Allahut. **“Kjo është rruga lme e drejtë; prandaj ndiqeni e mos shkoni rrugëve të tjera, që ju shmangin nga rruga e Tij...”** (En’am, 153)

Kryesorja është drejtimi i zemrës, ndërsa drejtimi i trupit është kusht formal. Nëse e ke harruar qëllimin e vërtetë të drejtimit gjatë adhurimit, nuk ka rëndësi nëse i përshtatesh apo jo formës, duke e kthyer fytyrën nga lindja apo perëndimi. Nëse trupi është drejtuar nga Qabja e zemra nga idhujt, nuk konsiderohesh i kthyer nga Qabja, e cila është simboli i teuhidit. E rëndësishme është të thyesh idhujt në Qaben e zemrës dhe të kthehesh nga Qabja, e cila është simboli i materializuar i teuhidit.

“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, melekët, Librin dhe pejgamberët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirim të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zekatin;

dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun.” (Bekare, 177)

Ky ajet u jep përgjigje edhe grupeve që bënin thashe-theme dhe dëshironin të krijonin ngatërresa në kohën e kthimit të kiblës nga Mesxhidi Aksa, në Mexhidi Haram, por thekson edhe qëllimin kryesor të kiblës. Ai tregon se formalizmi që nuk përmban besim, moral dhe virtyte nuk ka asnjë rëndësi. Sinqeriteti në adhurime është si shpirti në trup. Trupi pa shpirt nuk ka asnjë kuptim. Kibla është legjitimuar për t’u kujtuar atyre që falin namaz se duhet t’ia kthejnë shpinën çdo gjëje përveç Allahut dhe se vetëm atij duhet t’i drejtohen për lutje e përgjërim. Kthimi i fytyrës në një drejtim, është shkak për kthimin e zemrës. Ajeti fillon me besimin në Allahun dhe botën tjetër, sepse këto janë themeli i çdo mirësie dhe fillimi i çdo pune të dobishme.

Kibla e trupit është Qabja, ndërsa kibla e zemrës është Allahu. Thelbi i të gjitha adhurimeve, është drejtimi nga Ai, arritja e kënaqësisë së Tij. **“Jepja të drejtën e tij të afërmit, edhe të varfrit, edhe udhëtarit! Kjo është më e mirë për ata që e duan kënaqësinë e Allahut...”** (Rum, 38) **“Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim!”** (Insan, 9)

Qëllimi i dhikrit është përkujtimi i Allahut. Gjuha është përkthyesja e zemrës. Kryesore është uniteti gjuhë-zemër. Adhurimet që nuk bëhen për hir të Allahut, që janë larg vetëdijes dhe sinqeritetit, shprehin ose shkujdesje, ose abuzim. Ibrahim (a.s.), në lidhje me kthimin e vërtetë shprehet: **“Unë e kthej fytyrën time nga Ai që i ka krijuar qiejt dhe Tokën, duke qenë besimtar i vërtetë dhe nuk jam nga idhujtarët!”** (En’am, 79) Qëllimi i kthimit të fytyrës nga Allahu, është drejtimi me gjithë qenie për nga Ai dhe kënaqësia e Tij. **Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i perkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve.”** (En’am, 162)

Të fokusohesh vetëm tek simbolet dhe të mos njohësh kuptimet që shprehin ato, nuk është vepër e një myslimani të vetëdijshëm. Haxhinjtë flasin gjithmonë për Qaben. Mirëpo, askush prej tyre nuk flet për pronarin e Qabes. Kush është kryesore, shtëpia apo i zoti i shtëpisë? Vizita i bëhet shtëpisë apo të zotit të shtëpisë? Haxhinjtë thonë edhe “vizitorët e Rahmanit”. E çfarë vizitorësh mund të jenë ata që e shohin shtëpinë dhe nuk e kujtojnë të zotin e saj? Edhe simbolet janë të rëndësishme. Mirëpo ato janë vetëm mjete përkujtimi.

Allahu dhe kënaqësia e Tij janë të përhershme. Të drejtohesh për nga e përhershëmja, është zgjedhje më e mençur se sa të mbash shpresat tek kalimtarja. **“Çdo**

gjë që është në Tokë, do të zhduket e do të mbetet vetëm Fytyra (Qenia) e Zotit Tënd, plot Madhësi dhe Nderim.” (Rahman, 26-27)

Fytyra dhe zemra janë duhet të jetë e kthyer gjithmonë nga Ai dhe kënaqësia e Tij. Nëse një devijim i çastit nga kibla gjatë namazit, e prish namazin, devijimi i zemrës sonë për një çast nga Allahu, cenon devotshmërinë tonë. Edhe nëse nuk arrijmë të jemi njëqind për qind të devotshëm, të paktën gjatë namazit nuk duhet ta largojmë fytyrën e zemrën tonë nga Allahu dhe Qabja, e cila përfaqëson Njëshmërinë e Tij. Kjo është gjëja më e vogël që duhet të bëjmë patjetër.

Pejgamberi ynë (a.s.), ishte i kthyer gjithmonë në drejtim të Allahut dhe kënaqësisë së Tij. Madje edhe në gjumë dëshironte të qëndronte në atë drejtim. Sipas një transmetimi të Bera bin Azib, kur Pejgamberi (a.s.), shtrihej në shtrat, kthehej në të djathtë dhe bënte këtë dua: **“O Allah! Shpirtin tim ta dorëzova Ty, fytyrën time e ktheva nga Ti, çështjen time ta besova Ty e shpinën time e mbështeta tek Ti. Vendstrehim dhe vendshpëtim tjetër përveç Teje nuk ka.”** (Buhari, Texhrid-i Sarih, Hadithi nr: 2071) Ja pra, ky është orientimi dhe kibla e vërtetë. Mbështetja e plotë shpreh kthimin e plotë.

Besimtari, në çdo fazë të jetës, si në kamje e në skamje, në rehati e në vështirësi, në varfëri e në pasuri, në sëmundje e në shëndet, fytyrën dhe zemrën e tij e kthen gjithmonë në drejtim të Zotit të tij. Madje edhe varrosja e xhenazeve me fytyrë nga kibla, shpreh po të njëjtin kthim e drejtim.

“Pra, vraponi drejt Allahut!..” (Dharijat, 50) Ecja dhe vrapimi ynë le të jenë gjithmonë në drejtim të kënaqësisë së Tij. Vrapimi në ndonjë drejtim tjetër do të thotë largim prej Tij.

Sido që të jetë, më në fund **“... Tek Ai do të ktheheni!”** (Ja-Sin, 83) Të kthehesh me dëshirë pa u kthyer me pahir, edhe të lehtëson, edhe të respekton. Padyshim se ai që dorëzohet vetë, nuk është i njëjtë me atë që kapet për leckash dhe sillet me zor. Kush kthehet tek Ai, sheh veprat e mirësitë e Tij dhe gjithmonë e falënderon Atë. Të gjitha adhurimet janë shprehje falënderimi. Të gjitha rebelimet dhe kundërshtimet janë kthim i shpinës ndaj Tij. Gjynahu është t’i kthesh shpinën Allahut, ndërsa pendimi është ta kthesh përsëri fytyrën nga Ai. Fjala pendim, nënkupton kthimin tek Ai.

Hixhret/Mërgim; do të thotë të shkosh në drejtimin që ka treguar Allahu dhe i Dërguari i Tij. **“...Ai (Ibrahimi) tha: ‘Unë do të mërgoj tek Zoti im!’”** (Ankebut, 26)

Shkurt e qartë; kibla e vërtetë është kibla e zemrës; është kthimi në drejtim të kënaqësisë së Allahut. Ndërsa Qabja, e cila është kibla e trupit, është simboli i këtij kthimi. Zoti i bëftë zemrat tona të kthehen në drejtim të kënaqësisë së Tij dhe jo në drejtime të tjera. Amin!..

Kuptimi i Jetës

Semih Jollaçan

Duhet të kuptojmë shkakun e ekzistencës sonë, që jeta të marrë kuptimin e vërtetë. Për sa kohë që nuk kuptohet ky shkak, atëherë jeta nuk do të jetë tjetër përveçse një pasuri që shpenzohet kot. Atëherë jeta është e hapur ndaj rreziqeve, si një copë trangu që e ka zënë vërshimi i ujit. Thua jse është e lidhur me një fije kashte. Ku dhe kur do të këputet e përcaktojnë më shumë ngjarjet që sjell koha sesa iniciativat personale. Ndaj dhe njeriu duhet t'i drejtojë pyetje të kësaj natyre vetes: "Përse ekzistoj unë? Cili është qëllimi i krijimit tim?"

Ndaj dhe Allahu i Madhëruar në Kuranin Famëlartë, kur na drejtohet neve duke thënë: **"Prandaj, nga po**

ia mbani?" (Tekvir, 26), na nxit të reflektojmë duke na bërë pyetje të kësaj natyre: **"Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?"** (Kijame, 36), **"Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t'ju gjykuar)?"** (Muminun, 115)

Sërish, vetë Zoti i Madhëruar u kthen përgjigje këtyre pyetjeve të koklavitura, me qëllim që njeriu të mos mbetet ngushtë, të mos heqë keq, të mos u hyjë rrugëve pa krye. Duke thënë: **"Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë."** (Dharijat, 56), u ndriçon rrugën besimtarëve. Ky ajet na tregon shkakun krye-



sor të daljes sonë në skenën e ekzistencës. Ky është shkaku i të qenit rob i Allahut të Madhëruar. Vetëm jeta që jetohet brenda kontureve të robërisë bëhet e kuptimshme. Përndryshe, jeta që është kopshti i pasurisë së pashoqe dhe i Ahiretit, shpërdoret në prehërin e përkohshëm të kënaqësisë dhe të epshit.

Robëria është një besë që i është dhënë Zotit të Madhëruar që në pafillimësi. Ajo është baza e asaj marrëveshjeje që është bërë atje. Ata që i kanë qëndruar besnikë kësaj fjale, e bëjnë të kuptimtë qenien e tyre. Kurse ata që e shkelin këtë besë, nuk do të kenë asnjëfarë vlere e kuptimi tek Zoti i Madhëruar, ata thuajse janë në statusin e inekzistentëve. Allahu nuk i sheh fytyrat e tyre, madje nuk flet aspak me ta, duke mos i pranuar si bashkëbisedues. Ndaj dhe kur tregohen skenat e Kiametit në Kuran, shprehet në këtë mënyrë gjendja mjerane e atyreve që kanë harruar robërinë ndaj Zotit:

“Vërtet, ata që e shkëmbejnë premtimin dhe betimin e tyre ndaj Allahut me një vlerë të vogël, nuk do të kenë asnjë të mirë në jetën e ardhshme. Allahu nuk do t’u flasë atyre, as nuk do t’i shikojë në Ditën e Kiametit dhe as nuk do t’i pastrojë prej gjynaheve e për ta do të ketë dënim të dhembshëm.” (Al’Imran, 77)

Edhe në ajetin: **“Thuaj: ‘Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj...’**” (Furkan, 77), theksohet se jeta merr kuptim në varësi të robërisë që kemi ndaj Allahut. Ndaj dhe Resulullahu (a.s.), ka thënë: **“Duaja është thelbi i ibadetit”** (Tirmidhiu, Daavat, 1.) Kësisoj, të kryesh siç duhet thelbin e robërisë ndaj Zotit bëhet shkak që të fitohet vlerë tek Zoti.

Krahas kësaj, ata që përvetësojnë statusin e “robërisë ndaj Zotit”, merren nën mbrojtjen hyjnore. Djallëzitë e shejtanit tek këta njerëz mbesin pa efekt. Shejtani nuk mund të ketë asnjëfarë pushteti mbi ta. Këtë sihariq e mësojmë në këto ajete:

“Por në të vërtetë, ti nuk ke kurrfarë pushteti ndaj robërve të Mi! Zoti yt mjafton si mbrojtës (i tyre)!” (Isra, 65)

Për shkak të kësaj të vërtete, ku i është kërkuar të Dërguarit të Allahut (a.s.), të zgjidhte mes profetësisë *melik* (mbret) dhe profetësisë *abd* (rob), ai ka zgjedhur profetësinë *abd*. (Ibn Hanbel, II, 231; Hajthemiu, IX, 18, 20.)

Ja si e shpreh entuziazmin e robërisë ndaj Zotit Mevlana, i cili e ka vlerësuar si një nga gradët më të larta ndjekjen e gjurmëve të Resulullahut (a.s.):

Allahu im; unë u bëra rob i Yti, rob i Yti,

Po ul kokën para Teje, ngaqë s’e kam kryer si duhet detyrën time si rob i Yt,

Çdo rob gëzohet kur lirohet,

Kurse unë gëzohem vetëm atëherë kur të bëhem një rob besnik i Yti.

Përmendet një dialog që ka ndodhur mes një personi dhe Musait (a.s.), i cili qe një njeri që i digjej zemra për të qenë një rob i Allahut të Madhëruar:

Kur po shkonte në malin Tur, Musait ia ndërpret rrugën një njeri dhe i thotë:

- O Musa! Kam një pyetje, që më ka munduar prej kohësh. Nëse nuk ia gjej përgjigjen, nuk do të jem kurrë i qetë. Kërkoji Zotit tënd ta di nëse jam prej pjesëtarëve të xhenetit apo prej atyre të xhehenemit.

Pas këmbënguljes së vazhdueshme të atij njeriu, Musai pranoi ta pyeste.

Në kthim, njeriu në fjalë e kishte pritur plot kureshtje dhe Musai kishte filluar të thoshte:

- Zoti më tha: “Thuaj atij robit Tim...”

Menjëherë ishte hedhur njeriu dhe kishte thirrur plot entuziazëm:

- Mos ma thuaj, o Musa! Mos ma thuaj vazhdimin! Ti vetëm më thuaj: “Zoti im vërtet ashtu tha? Tha që ‘thuaj atij robit Tim?’ A më ka thënë Zoti ‘robi Im’?”

Musai iu përgjigj:

- Po, ashtu tha.

Dhe njeriu përsëri pati thirrur nga gëzimi e hareja:

- Mos më thuaj më shumë, o Musa! Meqë Zoti më ka thënë “robi Im”. Atëherë, kudo që t’më hedhë, s’ka aspak rëndësi, qoftë në xhenet, qoftë në xhehenem...

Dhe u largua që aty, duke u hedhur nga gëzimi që e kishte mbështjellë, porsi një fëmijë.

Pas këtij veprimi të tij, Zoti e pati përcaktuar pozitën e tij në xhenet.

“Meqë e ka bërë kurorë për kokën e vet robërinë ndaj Meje, meqë e vlerëson si nderimin më sublim, ai atëherë është pjesëtar i xhenetit...”

Kësisoj, rruga e vetme për të qenë njeri me vlerë tek Zoti i Madhëruar, kalon përmes të qenit rob besnik i Tij. Zoti na bëftë prej atyre njerëzve që arrijnë në vetëdijen e robërisë ndaj Tij! Na bëftë prej atyreve që jetojnë si robër të Tij dhe që dorëzojnë shpirtin si të tillë, si dhe prej atyre që ringjallen në këto pozita! Le të na bëjë prej atyre që Zoti i Madhëruar u drejtohet: **“Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!”** (Fexhr, 28 – 30)

Thuaj: "O Zoti im!
Ma shto dijen!"
(Taha 114)

Allahu i Lartmadhëruar nuk e urdhëroi Pejgamberin (a.s.) që t'i lutej për shtimin e ndonjë gjëje tjetër përveç diturisë. Kjo pasi dija është një thesar i pafund. Dituria është frytdhënëse jo vetëm për zotëruetin e saj, por edhe për njerëzit e tjerë, madje edhe për të gjitha qeniet e gjalla. Dituria është mjeti më i rëndësishëm për të ndarë të vërtetën nga e shtrembra. Shtimi i diturisë s'është një peshë e rëndë për njeriun, përkundrazi është një virtut lartësues për të. Me shtimin e diturisë, tek njeriu rritet modestia, njeriu shpëton nga disa gjëra të panevojshme, kupton të vërtetën dhe tregon kujdes që të bëhet një njeri i mirë. E kundërta e dijes është injoranca, e cila është e papranueshme.

Thuaj: "A mund të jenë të njëjtë ai që di me atë që nuk di?" (Zumer 9)

Nëpërmjet këtij ajeti Kuranor, Allahu Teala na tregon se dituria është diçka e lavdërueshme, duke na shpjeguar vlerën dhe superioritetin e saj, ashtu sikurse tregon edhe se injoranca është diçka e ulët dhe e mangët. Njeriu i ditur i bindet Allahut, ndërsa injoranti është kryelartë. Këta janë të kundërtat e njëra-tjetrës, ndërkohë që bindja është virtut, kryelartësia është rrënim. Çdo lloj injorance është kundërshtuar dhe është nënvlerësuar në fenë tonë. Kjo pasi çdo element i injorancës ka mohim dhe kryelartësi. Arsyeja se pse është quajtur periudha para

Islamit si periudhë e injorancës, është se i gjithë populli mohonte njësinë e Zotit dhe tregohej kryelartë ndaj Tij.

Dituria e saktë dhe e vërtetë e pastron njeriun nga shirku dhe e bën atë të dalë para Allahut si një rob i vërtetë. Në të kundërt, individit ka të meta dhe mangësi në dijen e tij. Injorant nuk është vetëm ai që s'di shkrim e lexim, sikurse pandehin sot disa njerëz, por është edhe ai që nuk heq dorë nga mohimi i Zotit të Lartmadhëruar dhe nga shfaqja e kryelartësisë ndaj Tij.

"Allahu do t'i ngrejë në shkallë të lartë ata midis jush që besojnë dhe që u është dhënë dija." (Muxhadele, 11)

Allahu i lartëson gradët shpirtërore të atyre që besojnë tek Ai dhe të atyre që veprojnë në përputhje me urdhrat e Tij. Në këtë jetë ata i bën që të jenë të suksesshëm, ndërsa në ahiret do t'i shpërblejë me katet më të larta të xhenetit. Allahu Teala edhe dijetarin që jeton në përputhje me diturinë e tij, gjithashtu do t'i dhurojë gradët më të larta shpirtërore. Ajeti kuranor i mësipërm është një argument i qartë që tregon vlerën e diturisë dhe dijetarëve tek Allahu. Në Kuranin famëlartë ka shumë ajete që theksojnë epërsinë e diturisë dhe dijetarëve. Në lidhje me këtë temë ka me qindra hadithe të të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Transmetohet nga Ebu Musa el-Esh'arij (r.a.),
se Pejgamberi -sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem-, ka thënë:

*"Shoku i mirë ngjan me tregtarin e aromave të këndshme.
Prej tij mund të blihet parfum, mund të të vijë dhuratë
një parfum ose tekefundit, mund të të vijë era e parfumit.
Kurse shoku i keq është si farkëtari, qëndrimi pranë të cilit
ose të djeg teshat ose të mbyt nga era e keqe."*

Ky hadith është në përputhje të plotë me ajetet që këshillojnë besimtarët të shoqërohen gjithmonë me njerëz të mirë e të devotshëm. Shoqëria dhe miqësia, përtej një marrëdhënieje shoqërore natyrale, e ka të nevojshme sinqeritetin dhe sinqeriteti arrihet më së miri midis njerëzve që ndajnë besim dhe ideale të njëjta. Hadithi i mësipërm na këshillon të jemi të kujdesshëm në zgjedhjen e shokut, për vetë faktin se, edhe pse me besim të njëjtë, por me sjellje të papajtueshme, njerëzit ndikohen reciprokisht pozitivisht apo negativisht. E këshillueshme është shoqërimi me njerëz të mirë, për të përfituar nga edukata e morali i tyre dhe distancimi nga personat me sjellje të keqe, sepse shoqërimi sjell patjetër ndikim. Siç e shpreh më qartë hadithi tjetër: *"Personi është në fenë e shokut të tij, prandaj të shikojë çdonjëri prej jush se me kë shoqërohet"* (Ahmed. ibn. Hanbel, Musnedi, 2/334)

Ky hadith i mrekullueshëm, i thënë katërmbëdhjetë shekuj më parë, e ruan edhe sot aktualitetin. Tema e ndikimit zë një vend të

rëndësishëm, sidomos përsa i përket edukimit të fëmijëve dhe të rinjve. Sepse sjelljet që fitohen në këtë moshë, do të përbëjnë një pjesë të karakterit të tij në të ardhmen. Në shumicën e rasteve duhanpirja fillohet thjesht duke u nxitur nga një shok, për të vazhduar gjithë jetën. Përhapja e veseve të tjera të këqija, si alkooli, droga dhe kumari është e lidhur ngushtë me ndikimin e rrethit shoqëror. Prandaj, zgjedhja e shokut është shumë e rëndësishme, për më tepër në kohën tonë, ku komunikimi ka marrë përmasat e një zhvillimi marramendës duke bërë të mundur edhe krijimin e shoqërive virtuale. Familja duhet të tregohet shumë e kujdesshme për grupmoshat nga klasa e parë deri në moshën e pjekurisë, sepse kjo është moshë ku fillon të formësohet personaliteti, por është edhe moshë, e cila është shumë e prirur ndaj ndikimeve pozitive apo negative.

Mburoja më e sigurt për të mbrojtur fëmijët nga ndikimet negative është strehimi tek feja islame.

Një Hadith

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Nxitja për t'u shoqëruar me njerëz të mirë.
2. Njeriu ndikohet nga shoku me të cilin shoqërohet.
3. Qëndrimi larg shoqërisë së keqe.



SHPËRDORIMI I KOHËS

Të gjitha mirësitë e dhëna njeriut, si të dhuruarat ashtu edhe ato që i fiton me mundin dhe djersën e vet, janë një dhunti e Zotit pasi është vetë Zoti që i krijon ato dhe i jep forcë njeriut për t'i fituar. Nisur nga kjo, njeriu nuk duhet të harrojë se mirësitë janë dhunti e Allahut. Ai duhet të jetojë me vetëdijen se këto janë çështje për të cilat nesër do të japë llogari. Në një ajet Kuranor thuhet:

"Mos vallë, keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t'ju gjykuar)?" (Muminun, 115)

Për rrjedhojë, duhet të mendojmë dhe gjykojmë se nuk jemi plotësisht të lirë në përdorimin e mirësive materiale dhe shpirtërore dhe se këto jemi të detyruar t'i përdorim në përputhje me urdhëresat hyjnore.

Në një tjetër ajet Kuranor na bëhet e ditur përsëri llogaria e madhe dhe na theksohet përgjegjësia që kemi: **Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!** (Tekathur, 8)

Pra, ashtu siç ka përcaktuar rrugët e fitimit të mirësive të dhëna, Krijuesi

i gjithësisë ka vendosur po ashtu disa rregulla dhe parime që duhen plotësuar në përdorimin e këtyre mirësive dhe dhuntive, të cilat i ka përmbledhur në "haramë dhe hallallë". Edhe shpenzimi i tepërt është një nga këto haramë që të çon në humbjen e mëshirës së Allahut dhe të nxit të marrësh dënimin hyjnor. Në një ajet Kuranor thuhet:

"...Por mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë!" (Enam, 141)

Një nga gabimet më të mëdha që bën njeriu në mungesë të vetëdijes, është shpenzimi i tepërt i kohës.

Jeta është një mirësi tepër e vlefshme, të cilën Krijuesi i gjithësisë ia jep qenies për ta jetuar një herë dhe në kohë të caktuar. Është kusht i domosdoshëm ta shfrytëzojmë kohën me veprimet më pozitive, në përputhje me vlerat e saj. Në çdo moment ka shumë punë që mund të bëhen në jetë. Por t'u japësh rëndësi atyre që janë më të rëndësishmet për momentin dhe t'i radhitësh të tjerat sipas shkallës së rëndësisë për të bërë një çështje me vlerë për të përdorur kohën ashtu siç duhet.





P.sh, të ushqyerit e fëmijës me qumësht është një veprim mjaft pozitiv i domosdoshëm. Por të ushqyerit e fëmijës ndërkohë që në shtëpi bie flaka, është një veprim tepër negativ dhe ka një përgjegjësi të madhe. Në atë moment nëna duhet të përpiket të shuajë zjarrin qoftë edhe me një kovë ujë, pasi kjo detyrë ka një rëndësi shumë më jetike se ajo e mëparshmja. Por nëse nuk tregohet e shkathët, pas një farë kohe do ta gjejë veten dhe fëmijën në zjarr.

Të vlerësosh fenë e Allahut më shumë se gjërat e tjera për hir të kohës, është një përgjegjësi e kohës.

Momentet më kuptimplote dhe më të bukura të jetës për sahabët, të cilët e vlerësuan kohën në mënyrën më të mirë të mundshme ishin ato kohë në të cilat ata transmetonin tek njerëzit mesazhin e tevhidit, njësisë. Një sahab i cili ishte në prag të dënimit me varje e falënderoi fatkeqin që i dha tre minuta kohë dhe i tha:

-D.m.th. kam edhe tre minuta kohë për të predikuar Zotin. Shpresoj të udhëzohesh.

Çdo besimtar e ka obligim moral dhe shpirtëror që t'ua transmetojë bukuritë e islamit një pjese të njerëzve në ditët e sotme, të cilët kanë humbur ne erozionin e imoralitetit dhe të mosbesimit, duke iu afruar atyre me një gjuhë mjaft të ëmbël.

Të shpenzosh me gjëra absurde kohën e cila është në vetvete një pasuri me vlera të pakontestueshme, do të thotë ta futësh në rrezik jetën e ahiretit. Prandaj koha është një dhunti me vlera ta pakrahueshme me asgjë tjetër. Në suren Asr, Krijuesi i gjithësisë thotë:

“Pasha kohën! Nuk ka dyshim njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan,

që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.” (Asr, 1-3)

Në këtë sure, e cila fillon me një betim për kohën flitet për një shpenzim të tepërt të kohës, e cila nuk është shfrytëzuar për ripërtëritjen e besimit, për punët e mira dhe këshillimin për të shkuar tek Zoti dhe se një gjë e tillë bëhet shkak për humbje të mëdha. Edhe fakti që flitet për raste të posaçme, për ata që nuk dinë ta vlerësojnë kohën me të drejtë është një e vërtetë e hidhur, gjë që tregon se ata janë të mashtruar në këtë drejtim.

Krijuesi i gjithësisë i këshillon robërit e vet që ta përdorin me kujdes kohën, në mënyrë që t'i shpëtojnë humbjes dhe të fitojnë shpërblimet hyjnore:

“Prandaj, kur të çlirohesh (nga punët e ndryshme), përpiku fort (në adhurim) dhe vetëm ndaj Zotit tënd përkushtohu!” (Inshirah, 7-8)

Pra, sapo të përfundojmë një punë të mirë dhe një adhurim, të kalojmë menjëherë në një punë tjetër dhe mos t'ia lejojmë vetes të na kalojë asnjë pjesë e kohës pa u shfrytëzuar. Jeta është një mirësi e dhunti që na është dhënë për të fituar lumturi në shpirtërore. Ndërsa vdekja është si afati i pagimit të një fature huaje, e cila tregon kohën e kryerjes së veprimit. Një tregtar i jep blerësit një faturë si parapërgatitje për larjen e huasë. Afati i përcaktuar këtu është për të përgatitur sasinë që do të paguhet në këtë kohë. Jeta e kësaj bote është një kohë që na është dhënë për të fituar Ahiretin dhe pëlqimin hyjnor. Ashtu sikurse një tregtar i cili nëse nuk e merr seriozisht kohën e pagesës që do të bëjë, nëse nuk përgatitet gjatë kësaj kohe dhe si përfundim në fund vihet në siklet dhe telash, ashtu edhe njeriu është në

**“Pasha kohën!
Nuk ka dyshim njeriu
është në një humbje
të sigurt. Me përjashtim
të atyre që besuan, që
bënë vepra të mira, që
porositën njëri-tjetrin t'i
përmbahen të vërtetës
dhe që këshilluan
njëri-tjetrin të jenë të
durueshëm.”**

(Asr, 1-3)

humbje për sa kohë që nuk e përdor mirë kohën që i ka caktuar Allahu për të jetuar. Çdo njeri, që nga momenti kur vjen në jetë e ka një datë të vdekjes, kohë e cila nuk dihet. Ky është pikërisht momenti i takimit me Azrailin. Edhe pse është e qartë data e pagesës, nuk dihet se kur do përfundojë jeta e njeriut. Kjo është një e vërtetë e hidhur që na bën të bëhemi gati në çdo moment për dhënien e llogarisë.

Një nga bazat themelore të etikës mistike shpreh qartë se është shumë e domosdoshme që koha si një mirësi e madhe që na është dhënë të përdoret sa më me kujdes. Çdo besimtar që dëshiron të pastrojë zemrën dhe shpirtin e tij duhet të mendojë që llogaria mund të vijë në çdo moment, përderisa nuk dihet ardhja e vdekjes (exhel) dhe nisur nga kjo kohë duhet ta shfrytëzojë me vepra të mira. Ti lërë punët e panevojshme dhe mos të flasë gjëra të pakuptimta, pra e thënë ndryshe me shprehjen e Mevlanës, duhet ta mbrojë gjuhën nga të qenurit "Maskara i fjalës". Kështu e shpreh Allahu i Lartmadhëruar cilësinë e besimtarëve "të shpëtuar"

"Ata të cilët i shmangën të kotës (fjalë a punë)" (Muminun, 3)

"(Kështu janë) edhe ata që nuk dëshmojnë në mënyrë të gënjeshtërt e, kur kalojnë pranë kotësive, kalojnë me dinjitet." (Furkan, 72)

Besimtari i devotshëm duhet të jetë në çdo moment në dijeni për botën e tij të brendshme dhe të gjykojë se në ç'skallë ka arritur pendimi, falënderimi dhe pëlqimi. Ai duhet të pendohet për ato kohë që ka kaluar ashtu në pavetëdije, duke bërë një përlllogaritje për mirësitë që i janë dhënë. Duhet të shpëtojë nga ankthet e panevojshme të së ardhmes duke i kushtuar kujdes vetëdijes dhe të merret me gjendjen e tij shpirtërore. Pra duhet të jetë një njeri i pjekur i cili ia di vlerën kohës që jeton, thënë ndryshe edhe "ibnu'l-vakt", dhe të jetojë i përgatitur për botën tjetër. Harxhimi pa kriter i kohës është një humbje shumë e madhe. Vetë i Dërguari i Allahut ka thënë:

"Njerëzit e xhenetit nuk do ndjejnë keqardhje për asgjë tjetër, por vetëm për kohën që kanë kaluar në këtë botë pa përmendur Allahun." (Hejthem, X, 73-74) Njëpërmjet kësaj thënieje na ka kujtuar se duhet ta vlerësojmë kohën me punë të dobishme, që do të jenë

një pasuri e jona për jetën e përtejme. Nëse mirësitë të ikin nga dora, pendimi nuk ka më vlerë. Prandaj sa ta kemi mundësinë, le ta vlerësojmë jetën me punë të dobishme. Të përpiqemi t'i japim hakun çdo gjëje që kërkon falënderim. P.sh, mirësinë e të folurit le ta shfrytëzojmë me përmendjen e Zotit, si një shërim për zemrat tona.

Kështu e këshilloi Pejgamberi ynë Hafsanë:

-O Hafsa! Ki kujdes në të folurit e tepërt, pasi e folura e tepërt përveç përmendjes së Allahut e vret shpirtin. Përmende Zotin shumë! Kjo e ripërtërin zemrën! (Ali el Muttaki, 1, 439/1896)

Allahu i Lartmadhëruar na këshillon të jemi të kujdesshëm në dy çështje:

"Prandaj jepni prej atyre mirësive që ju kam dhënë Unë, para se t'i vijë vdekja ndonjërit, e ai të thotë:

O Zoti im, sikur të më kishe lënë edhe një kohë të shkurtër në jetë, do të kisha dhënë lëmoshë dhe do të bëhesha ndër të mirët!" (Munafikun, 10)

Ajeti i mëposhtëm tregon qartë se si kthehen mbrapa vajtimet dhe pretekstet e atyre që e shkatërruan jetën e tyre:

"Atje, ata do të thërrasin: O Zoti ynë, nxirrna se do të bëjmë vepra të mira e jo nga ato që kemi bërë. (Atyre do t'u thuhet): Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)? Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi? Andaj, shijoni

(dënimin)! Për keqbërësit nuk ka kurrfarë ndihmësi!" (Fatir, 37)

Një tjetër arsye e shpenzimit të tepërt të kohës, sikurse ndodh në të gjitha mirësitë e tjera në jetë është koshienca për të mos e kuptuar vdekjen siç duhet apo për t'i qëndruar larg saj. Në një hadith thuhet:

"Kujtojeni shumë vdekjen e cila zhduk rrënjësisht të gjitha dëshirat" (Tirmidhi, Kijamet, 26) Ata të cilët vazhdojnë në të tyren pavarësisht këshillave Pejgamberore, padyshim që do të kenë një fund të dhembshur.

Një ditë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), tha:

-Nuk ka asnjë njeri që do të vdesë dhe nuk do të pendohet.

Sahabët e pyetën:

-Për çfarë të pendohet, o i Dërguari i Allahut?



I Dërguari i Allahut, (a.s.), iu përgjigj:

"Bamirësi do pendohet për faktin që nuk ka shpenzuar më shumë, ndërsa keqbërësi që nuk ka hequr dorë nga të këqijat." (Tirmidhi, Zuhd, 59)

Kur njeriu sheh me syrin e zemrës rrjedhën e fuqisë hyjnore të pasqyruar në mbarë gjithësinë, e ndjen veten të detyruar të mendojë se si duhet të jetë në këtë jetë. E vërteta më e madhe që duhet ta lidh njeriun me jetën, është çështja e vdekjes. Sa pamje e mahnitshme për njeriun është ai moment lamtumire. Kush e njeh vdekjen dhe e kupton se është udhëtar i ahiretit, nuk bëhet pre e lojërave të kësaj jete dhe nuk humbet kohë me to. Në Kuran thuhet:

"Ne nuk i kemi krijuar qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre, për t'u zbavitur! Ne i kemi krijuar ato me qëllim të plotë, por shumica e tyre nuk e dinë." (Duhan, 38-39)

Sikur të gjitha mirësitë e për-kohshme të mblidhen tek një njeri, dhe sikur ky njeri të jetojë edhe një mijë vjet, ç'dobi ka! Në fund të fundit, vendi ku do të futet a nuk do të jetë kjo tokë të cilën e shkelim me këmbë? Si nuk merr njeriu mësim, ndërkohë që këshillohet përherë gjatë gjithë kohës ku vepron çdo qenie e përkohshme. Sa mashtrim i frikshëm është kjo botë kur ajo jetohe në mënyrë të painformuar në lidhje me Ahiretin, duke e ditur se lojërat e saj janë të vërteta!

Imam Shafiu thotë:

-A kanë leverdi karvanet të ndërtojnë shtëpi gjatë udhëtimit?

Një jetë e tillë nuk është gjë tjetër vetëm se një lojë në fëmijëri, një kënaqësi në rini, një papjekuri në moshë madhore, një mall për të shkuarën në pleqëri dhe një mijë e një përpjekje. Kurse vdekja e pret njeriun në çdo çast në pritë. Sa shpenzim i tepërt në jetë është gjendja e atyre që nuk lodhen me kënaqësitë e përkohshme deri në ditën e fundit, duke mos lënë mënjane zbulimet e kësaj bote, vetëm e vetëm për të fituar qetësinë që të jep jeta larg mendimit për Ahiretin!.. Sa mall do të ndjejnë një ditë për kohën e çuar dëm ata të cilët e shkatërruan kohën e tyre sikur nuk do të vdisnin asnjëherë!..

Ata të cilët e kanë dhënë veten e tyre pas kënaqësi-ve epshore i shmangen vazhdimisht të menduarit për jetën e varrit dhe atë të përtejmen duke u përpjekur të

jetojnë jetën e tyre mbi planin epshor. Prandaj vdekja për ta është një ankth për të ardhmen dhe një frikë e tmerrshme. Kjo pasi njeriu dëshiron të jetojë në një botë të cilën e ka imagjinuar dhe i ka dhënë shpirtin. A është e mundur që një njeri i cili ka shkatërruar ahiretin duke u përkujdesur për këtë botë, ta lërë vilën e tij luksoze dhe të kërkojë të jetojnë në një rrënojë? E kundërta e saj a mund të konceptohet një besimtar i cili mendon thellësisht ahiretin dhe të trembet nga frika për varrin?

Kështu na e tregon Mevlana rrugën për të shpëtuar nga të fshehtat e kësaj bote dhe për të arritur lumturinë e përhershme:

-Mos e përqafo shumë pasurinë, ashtu që kur të vijë koha ta kesh të lehtë ta lësh! Edhe e lehtë edhe fiton sevape! Mbështetu fort tek Ai që të qëndron më afër, Ai është i Pari dhe i Fundit!

Shumica e njerëzve frikësohen nga vdekja fizike e tyre. Në fakt ajo që duhet të frikësohen më shumë është vdekja e shpirtit.

Për çdo qenie të gjallë ka një frymë të fundit, e cila nuk mund të shtyhet më tutje. Koha ecën me hapa të shpejtë sipas përcaktimit të Zotit. Në jetën e kësaj bote pak a shumë është e mundur të marrësh çdo gjë dhe të kthesh prapa shumë gjëra, por kohën e kaluar kurrë... Askush nuk mund të qëndrojë indiferent kur një copëz e vogël floriri hidhet në kosh, por sa e habitshme është kur qëndrojmë indiferent ndaj kohës që kalojmë, për të cilën edhe po të japim miliona flori nuk mund ta marrim dot.

Feriduddin Attar thotë:

Janë katër gjëra që s'mund të të kthehen prapa pasi i ke humbur: fjala e dalë nga goja, shigjeta e gjuajtur, aksidenti i bërë dhe një jetë e harxhuar kot.

Një mik i ngushtë i Zotit për të kuptuar mirë vlerën e kohës dhe për ta vlerësuar atë sa më mirë jep këto këshilla:

Bëj vizita të herëpashershme në spital për t'u bërë vizitë të sëmurëve! Falëndero Zotin për gjendjen tënde shëndetësore dhe mendo për gjendjen e atyre të sëmurëve! Shko herë pas here në burgje dhe gjyko për jetën e përvuajtur të atyre njerëzve të burgosur! Mendoni për një çast se krimi është kryer për një moment të

**Një jetë
e tillë nuk është gjë
tjetër vetëm se një lojë
në fëmijëri, një kënaqësi
në rini, një papjekuri
në moshë madhore, një
mall për të shkuarën në
pleqëri dhe një mijë e
një përpjekje.**

caktuar, në mënyrë të pavetëdijshme, nga ana tjetër ashtu i rrënuar shpirtërisht hyni në burg e mendoni që edhe ju mund të ishit në vendin e tyre! Falëndero Zotin që të mbrojti dhe të ruajti për të mos rënë në këtë gjendje! Lutu edhe për shpëtimin e atyre që janë atje! Më pas shko në varreza, dije vlerën e kohës, duke menduar se nuk ka asnjë vlerë pendimi pasi të kesh humbur mirësinë e jetës! Lexo një Fatihë për të vdekurit dhe përpiku ta shfrytëzosh këtë kohë të mbetur duke falënderuar Zotin tënd!

Kjo do të thotë që një besimtar duhet të përpiket të bëjë një jetë të devotshme duke mos e harruar krijuesin e gjithësisë në asnjë kohë dhe vend. Allahu thotë:

“Mos u bëni si ata që e harruan Allahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten.”
(Hashr, 19)

Pasi shpjegon se çuarja dëm e kohës dhe harxhimi i tepërt i saj me njerëz që nuk kanë preokupime të tjera në jetë është një nga turpet më të mëdha të nefsit, Ebu Abdurrahman Sulemi tregon se si mund të kurohet një dukuri e tillë:

Ta kuptosh kohën si gjënë më me vlerë në jetë dhe ta shfrytëzosh atë me punët më të vlefshme siç është ajo vetë, pra duke përmendur Allahun, duke e adhuruar përherë dhe duke forcuar devotshmërinë në shpirtin tënd. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “Lënia mënjane e gjërave që nuk i interesojnë njeriut, është tregues i një myslimanizmi të mirë.” (Tirmidhi, Zuhd, 11)

Hadithi njofton se është një detyrim moral i yni për ta ditur sa më mirë vlerën e kohës dhe më pas vijon:

“Dija vlerën pesë gjërave para se të vijnë pesë të tjera: vlerën e rinisë para pleqërisë, vlerën e shëndetit para se të sëmuresh, vlerën e pasurisë para se të varfërohesh, vlerën e kohëve të lira para se të vijnë kohët e zëna dhe vlerën e jetës para se të vijë vdekja.” (Buhari, Rikak, 3; Tirmidhi, Zuhd, 25)

Në Ditën e Gjykimit robi nuk lëviz nga vendi pa u pyetur për katër gjëra:

1. Për jetën, me çfarë e konsumoi atë?
2. Për rininë, ku e harxhoi atë?
3. Për pasurinë, ku e fitoi dhe ku e shpenzoi?
4. Për diturinë, çfarë bëri me të? (Tirmidhi, Kijame, 1)

Ka dy mirësi të cilat shumica e njerëzve mashtrohen kur i përdorin: Shëndeti dhe koha e lirë. (Buhari, Rikak, 1)

Allahu na njofton në shumë ajete kuranore se në Ahiret do të pyetemi për të gjitha mirësitë materiale-shpirtërore që na janë dhënë. Dijetarët Islamë kanë dhënë mendime të ndryshme për sa i përket mirësive më të rëndësishme për të cilat do merremi në llogari Ditën e Gjykimit. Ibn Mesud thotë se këta janë “Siguria, shëndeti dhe koha e lirë” Muavije bin Kurre thotë: “Llogaria më e tmerrshme në Ditën e Gjykimit është ajo e kohës së lirë” (Bursevi, X, 504)

Kjo këshillë e Gazaliut në lidhje me shpenzimin e tepërt të kohës, ka shumë domethënie:

“Bir! Mendo që sot ke vdekur. Sa do të mërzi-tesh për kohët që i ke kaluar ashtu i pavetëdijshëm. Ah sikur! - do të thuash, por pa kuptim.”

Xhunejd Bagdadi ka thënë:

“Një jetë e kësaj bote është më me vlerë se një mijë vite të Ahiretit. Fitorja dhe humbja i përka-sin kësaj bote. Në Ahiret nuk ka të fitosh apo të humbësh.”

Koha e humbur është një humbje e madhe që nuk zëvendësohet. Kjo pasi të gjitha dosjet e të kaluarës janë mbyllur. Të paktën të përpiqemi t'i zëvendësojmë ato nëpërmjet anës shpirtërore, duke bërë lutje dhe adhurime për Krijuesin tonë.

Lumi i jetës rrjedh shumë shpejt. Ditët e kësaj jete të për-kohshme të kufizuara nga vullneti hyjnor, janë si pikat e ujit në një gotë. Të mos harrojmë se për çdo ditë që kalon ndodh një pakësim i ujit në gotë, largohemi një ditë më shumë nga kjo botë dhe i afrohem një ditë më shumë jetës tjetër. Meqenëse exheli nuk dihet se kur vjen, duhet të kujtojmë se në çdo moment mund të takohemi me Azrailin, në mënyrë që në frymën e fundit të mos shohim dramën tonë. Nexhip Fazël thotë:

“Në atë moment të frymës së fundit, kur perdet e jetës ulen dhe ngrihen, të mund t'i themi Azrailit “Mirë se erdhe!”

Zoti na mundësoftë ta kalojmë këtë jetë të mbetur me adhurime ndaj Zotit dhe ta japim frymën e fundit si myslimanë. Zoti na e mundësoftë ta kuptojmë mirësinë e kohës që na është dhuruar, në të cilën jetojmë botën tonë të brendshme dhe të jashtme, për të bërë kështu një jetë larg shpenzimeve të tepërta.



STREHOHEM TEK ALLAHU PREJ SHEJTANIT DHE DJALLËZIVE

Prof. dr. Omer Çelîk



Strehohemi tek Allahu prej çdo të keqeje. Kërkojmë që Ai të na marrë nën mbrojtjen e Vet dhe të na mbështjellë me mëshirën e Tij. Nga Ai e kthejmë fytyrën tonë, me Atë e lidhim zemrën tonë dhe Atij i drejtohem me gjithë shpirt.

Në gjuhën e Kuranit, kjo quhet “Istiadhe”, pra të kërkoj strehim dhe ndihmë. Ndërsa të thuash:

أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ

Eudhu bil-lahi mine’sh-shejtani’rr-raxhim”, do të thotë të kërkoj strehim tek Allahu prej shejtanit të dëbuar nga mëshira hyjnore.

Kjo shprehje përmendet në suren Nahl:

فَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ

“Kur dëshiron të lexosh Kuranin, kërko mbrojtjen e Allahut kundër shejtanit të mallkuar.” (Nahl, 98)

Në fakt, qoftë nga shejtani dhe qoftë nga të këqijat e tjera, ne duhet të strehohemi vazhdimisht tek Allahu. Ne kemi shumë nevojë për këtë, sepse jemi të rrethuar me rreziqe nga çdo anë. Padyshim se forca e vetme që mund të na mbrojë nga këto rreziqe, është Allahu i Madhëruar.

Atëherë, përse ajeti i cili urdhëron për të kërkuar strehim tek Allahu, e kërkon këtë veçanërisht “kur do të lexojmë Kuranin” dhe përse prej “shejtanit”?

Pikësëpari, na tërhiqet vëmendja e marrëdhënies së Kuranit me shejtanin. Shejtanët nuk e durojnë dot aspak Kuranin Fisnik dhe armiqësia e tyre ndaj Kuranit është mjaft e egër. Sapo Pejgamberit tonë (a.s.), filloi t’i shpallej Kurani, shejtanët u hidhëruan shumë dhe u

ndaluan të ngjiten në qiell. Atyre iu ndalua të përgjojnë bisedat e melekëve dhe të vjedhin ndonjë informacion prej tyre, duke u gjuajtur e dëbuar me shkëndija zjarri (meteorë). Pra, Allahu i Madhëruar e ka ruajtur fjalën e Tij (Kuranin) nga ndërhyrjet e shejtanëve.

Nuk ka asgjë tjetër që i djeg shejtanët më tepër se drita e Kuranit. Shejtanët nuk i duan as peygamberët. Ata ushqejnë armiqtë të jashtëzakonshme ndaj tyre, sepse peygamberët janë udhëzues në rrugën e drejtë. Pra, me lejen e Allahut ata i orientojnë njerëzit në rrugën e drejtë.

Sa interesant është ky ajet në lidhje me sulmin e shejtanëve ndaj peygamberëve:

“Ne nuk kemi sjellë para teje (o Muhamed) asnjë të dërguar e asnjë profet që djalli të mos i ndërhynte në leximin e tij (nga shpallja). Por Allahu e zhdukte ndërhyrjen e djallit dhe më pas i forconte shpalljet e Veta. Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.” (Haxhxxh, 52)

Shejtanët të cilët bezdisin kaq shumë peygamberët, kushedi se çfarë na punojnë neve njerëzve të dobët? Por në radhë të parë, duhet të theksojmë se Shejtani e ngacmon njeriun më tepër në lidhje me leximin e Kuranit. Kjo, sepse ai që lexon Kuranin, kujton dhe mëson urdhrat e Allahut. Ai mundohet t’i zbatojë këto urdhra. Po ashtu, ai mëson haramet dhe përpiqet të ruhet prej tyre me gjithë forcën që ka. Me një fjalë, bëhet i vetëdijshtëm ndaj detyrave që ka kundrejt Allahut. Gjithashtu, ai mëson edhe se nga ka ardhur dhe ku do të shkojë. Duke u nisur nga kjo urtësi, ai është urdhëruar të kërkojë istiadhe (strehim tek Allahu) veçanërisht kur fillon të lexojë Kuranin Fisnik.

Kuptimin dhe rëndësinë e istiadhes, mund ta shpjegojmë më mirë me disa përngjasime:

“Istiadhe”, ngjan me trokitjen e derës dhe kërkimin e lejes për t’u takuar me një personalitet të rëndësishëm. Për rrjedhojë, ai që kërkon të lexojë Kuran, për shkak se do të fillojë të flasë me Allahun e Madhëruar, duhet të qëndrojë larg çështjeve që nuk i përkasin atij, duke e pastruar gjuhën nga gjynahet, si përgojimet, talljet dhe shpifjet. Dhe pastrimi i gjuhës prej këtyre gjynaheve, bëhet i mundur vetëm me përsëritjen me gjithë shpirt të shprehjes “Eudhu bil-lahi mine’sh-shejtani’rr-rraxhim”, pra të kërkojë strehim dhe mbrojtje tek Allahu ndaj të gjitha këtyre të këqijave.

Istiadhe, është një marrëveshje midis Zotit dhe robit. Allahu i Madhëruar, urdhëron: ***“...Përmbushni premtimin që Më keni dhënë, që edhe Unë të përmbush premtimin që ju kam bërë...”*** Kur robi thotë “Eudhu bil-lahi mine’sh-shejtani’rr-rraxhim”, është sikur t’i thojë Allahut: “O Allah, unë po e çoj në vend premtimin tim të devotshmërisë ndaj Teje, edhe pse kam shumë të meta, prandaj strehohem tek Ti dhe kërkoj falje prej teje. Ti je Bamirës dhe Bujar. Prandaj më merr në mbrojtjen Tënde, duke çuar në vend premtimin Tënd.”²

Të strehohesh tek Allahu, do të thotë të kthehesh tek Krijuesi. Ky është kthimi tek Allahu i Madhëruar, i Cili posedon çdo mirësi dhe nuk ka nevojë për asgjë. Istiadhja, që bëhet me një vetëdije të tillë, nxjerr në pah të fshehtën e ajetit; ***“Vraponi tek Allahu!”*** (Dharijat, 50)

Por, përse kërkojmë strehim dhe mbrojtje nga Shejtani duke përdorur në mënyrë të veçantë emrin “Allah”, ndërkohë që Zoti ynë i Madhërishtëm

1. -Bekare, 40.

2. - Fahreddin er-Razi, Mefatihul-gajb, I, 85-86.

zotëron edhe emra të tjerë si Rrahman, Rrahim, Gaffar, Settar, etj?.. Arsye e kësaj është sepse “Allah”, është emri më i madh i Zotit tonë të Madhëruar, që do të thotë “Qenia Madhështore që adhurohet; i vetmi Zot”. Ky emër ka përmbledhur në vete të gjithë emrat dhe atributet e Zotit. Emri Allah është më i madhi. Ndërsa Shejtani është një armik aq i madh dhe i fuqishëm, saqë prej të keqes së tij, njeriun mund ta ruajë vetëm Allahu, i Cili posedon fuqi të pakufishme. Askush tjetër nuk mund ta bëjë këtë.

Kush është Shejtani, çfarë lloj krijese është ai?

Ashtu siç kuptohet qartë edhe nga fjala Shejtan, ai është Iblisi me ndihmësit e tij. Ai e mori këtë emër, pasi u dëbua nga mëshira e Allahut, për shkak se nuk iu bind urdhrat të Tij për t’i bërë sexhde Ademit (a.s.). Këtë tregon edhe cilësia e tij “rraxhim”, e cila zë vend në shprehjen “Eudhu bil-lahi mine’sh-shejtani’rr-raxhim”. Pra, Shejtani i dëbuar dhe i hedhur nga katet e qiejve prej melekëve në momentin që u mallkua. Mirëpo, është fakt se emri Shejtan përdoret për t’iu referuar edhe njerëzve e xhindëve, të cilët braktisin rrugën e drejtë dhe devijojnë në rrugë të shtrembër. Kjo kuptohet edhe nga shprehja që ka përdorur Allahu i Madhëruar në Kuran: **“...shejtanët prej njerëzve dhe xhinëve”** (En’am, 112)

Strehimi i vërtetë tek Allahu i Madhëruar nuk realizohet vetëm me fjalë. Për realizimin e kësaj kërkohet përshtatja e zemrës me fjalët dhe veprat. Nëse me gjuhë thuhet “strehohem tek Allahu”, ndërsa me vepra strehohet tek Shejtani, atëherë kjo nuk quhet një istiadhe e pranuar. Kjo mund të duket vetëm si një bashkëpunim i egos me Shejtanin në gjynahe dhe kalim kufijsh.

Nisur nga kjo, njerëzit strehohen tek Allahu vetëm në bazë të gjendjes së tyre shpirtërore. Njerëzit e thjeshtë e përsërisin shprehjen e istiadhes pa qenë të vetëdijshëm ndaj kuptimit të saj të vërtetë. Ndërsa njerëzit e ditur kërkojnë strehim tek Allahu duke mos njohur asnjë forcë tjetër përveç Tij. Për këtë arsye, Shejtani nuk mund t’i afrohet dritës së besimtarit të devotshëm e të ditur, madje ikën prej tij. Një shembull i bukur i kësaj gjendjeje, është edhe ajo e Ebu Said Harrazit (Allahu e mëshiroftë):

Ebu Saidi sheh në ëndërr Iblisin dhe mundohet ta gjuajë me shkopin që ka në dorë. Ndërsa Iblisi i thotë: “O Ebu Said, unë nuk kam frikë nga shkopi yt, por nga drita e diellit që lind prej horizontit të zemrës së njeriut që e njeh Zotin e tij.”

Ndërsa Hasan Basriu (Allahu e mëshiroftë), thotë: “Kush strehohet tek Allahu i Madhëruar me qetësi të madhe shpirtërore, Allahu vendos treqind perde midis tij dhe Shejtanit”.

Kjo analizë që ka bërë mufesiri Fahreddin er-Razi, na ndihmon të kuptojmë më mirë rëndësinë që ka për besimtarin strehimi tek Allahu nga Shejtani dhe djallëzitë:

“Besimtari ka dy armiq, një të hapët dhe një të fshehtë. Armiqtë e hapët janë mohuesit, ndërsa armiku i fshehtë është Shejtani.

Ndërkohë që kundër mohuesve urdhërohet lufta, kundër Shejtanit urdhërohet strehimi tek Allahu.

Në të dy këto luftëra, Allahu është ndihmësi i besimtarit. Kur besimtari vritet nga armiku i hapur, ai quhet dëshmor. Por kur vritet nga armiku i fshehtë (Shejtani), ai dëbohet nga mëshira e Allahut. Për rrjedhojë, ruajtja prej të keqes së armikut të fshehtë është parësore.

Zemra e besimtarit është vendi i tij më dinjitoz dhe më i pastër. Prandaj, besimtari duhet ta ruajë zemrën e tij të pastër nga çdo lloj vesvesi të Shejtanit dhe në të duhet të vendosë njohjen e Allahut, me qëllim që edhe Allahu t’ia dhurojë Xhenetin e Tij, që është vendi më i pastër dhe më i bukur. Pra, rob duhet t’ia përkushtojë të gjithë zemrën Allahut, që edhe Allahu t’i falë atij Xhenetin në botën tjetër.” (Fahreddin er-Razi, Mefatihul-gajb, I, 81-83.)

Në këtë mënyrë, në sajë të begatisë së fjalës “Strehohem tek Allahu prej Shejtanit të dëbuar prej mëshirës hyjnore”, ne kemi mundësinë të strehohemi tek Zoti ynë i Madhëruar prej të gjitha vesveseve dhe të këqijave të Shejtanit. Po ashtu, mbrohemi prej të këqijave të këtij armiku të përbetuar dhe duke u larguar prej haramëve, përpiqemi të bëjmë vepra të mira dhe të shkojmë drejt një synimi të lartë, që do ta ndriçojë të ardhmen tonë.

**Të strehohesh
tek Allahu, do të thotë të
kthehesh tek Krijuesi.
Ky është kthimi tek Allahu
i Madhëruar, i Cili posedon
çdo mirësi dhe nuk ka nevojë
për asgjë. Istiadhja, që bëhet
me një vetëdije të tillë,
nxjerr në pah të fshehtën e
ajetit; **“Vraponi
tek Allahu!”****



Dhikri

Salih Zeki Meriç

Dashuria ndaj Allahut Teala është një ndjenjë që përbën kulmin e besimit të besimtarit. Besimi shtohet dhe thellohet me këtë dashuri. Nëse dashuria kalon nga gjuha në zemër dhe reflekton nga zemra në vepra, bëhet sublime. Siç duhet që besimi të pranohet me zemër edhe dashuria e vërtetë është ajo që vjen nga zemra. Ato që zemra ndjen në qendrën e saj, e lartësojnë shpirtin. Kjo ndodh me funksionimin e një mekanizmi në botën e brendshme, që mund t'i ndryshojë ndjenjat dhe perceptimet e besimtarit. Ky mekanizëm i botës së brendshme është dhikri, që fillon nga gjuha, zbret në zemër dhe nga aty, përhapet në të gjithë trupin. Dhikri është një shfaqje e dashurisë së vazhdueshme. Kur robi bën dhikër, e percepton nënshtrimin e tij ndaj Zotit dhe e reflekton në pasqyrën e zemrës admirimin që ka ndaj Tij. Dhikri është dëshira për të qëndruar me Allahun Teala në çdo kohë.

Ai që do, nuk e harron atë që do, qoftë edhe për një çast. Ai kënaqet kur e përmend atë. Një moment shkujdesjeje në përkujtimin e tij, e konsideron padrejtësi të bërë ndaj atij që do.

Ajo që e ushqen dashurinë, është gjendja e dhikrit deri në frymën e fundit. Dashuria është si një lumë që rrjedh nga robi për te Zoti (xh.sh.). Ndërsa shpërblimi

për atë dashuri është si lumenjtë që rrjedhin nga Zoti (xh.sh.), te robi. Mirësia e dashurisë është e pafundme, siç është e pafundme çdo mirësi që vjen nga Zoti (xh.sh.). Risku i vërtetë është risku i dashurisë. Lutja për furnizimin me dashurinë e Allahut Teala, çdo moment duhet të jetë në gjuhën e besimtarit, siç thuhet edhe në duanë e Pejgamberit (a.s.). Allahu i Madhëruar shprehet në suren Bakara se përkujtimi është i dyanshëm: **“Prandaj, më kujtoni Mua (me namaz e lutje) që Unë t’ju kujtoj (me shpërblime) dhe falënderomëni Mua (duke m’u bindur) e mos i mohoni dhuntitë e Mia (me mosbindje)!”** (Bakara, 152)

Dhikri që robi bën për Zotin, është falënderim për mirësitë, durim kundrejt sprovave dhe nënshtrim ndaj urdhrave. Është një rregull jete për të mos u ndarë nga orientimi që na ka treguar Zoti (xh.sh.). Një tjetër synim i dhikrit, është edhe pastrimi i nijetit dhe zhvillimi i vazhdueshëm i pjekurisë shpirtërore. Ndërsa kujtimi i robit nga ana e Zotit, do të thotë se Zoti është i kënaqur me të, e ka marrë nën mbrojtje, e ka udhëzuar, i ka dhënë largpamësi, i ka dhënë vetëdijen e nënshtrimit dhe ato që ia ka premtuar në jetën e kësaj bote dhe të Ahiretit. Në suren Maide, Allahu Teala shprehet se dashuria është e dyanshme: **“O ju që keni besuar! Nëse ndokush prej jush braktis besimin e vet, dijeni**

se Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan, të përulur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit, që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi. Kjo është mirësia e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Bujar i madh dhe i Gjithëditur.” (Maide, 54) Po ashtu, ka edhe prej robërve që ia kthejnë shpinën dhikrit të Allahut Teala. Kjo është fatkeqësia më e madhe për robin. Kthimi i shpinës ndaj dhikrit të Allahut (xh.sh.), është neglizhencë ndaj Allahut, duke qenë në detin e mëshirës së Allahut. Për këtë arsye, udhëzimi është mirësia më e madhe që Allahu i Lartësuar u ka dhënë robërve të Tij. Udhëzimi është si port për një besimtar. Në fillim të çdo lutjeje të besimtarit, duhet të jetë kërkimi i udhëzimit prej Allahut Teala, siç është edhe në suren Fatiha, që e lexojmë dyzet herë në ditë: **“Na udhëzo në rrugë të drejtë!”** (Fatiha, 6)

Privimi nga dhikri, nga meditimi në lidhje me krijimin e Allahut Teala dhe nga ibadeti, është privimi më i dhimbshëm. Shndërrimi i dynjasë dhe i interesave të saj në synim të vetëm, duke u humbur në pasionet mashtruese të saj, është pengesë për zbritjen e mirësive hyjnore. Kjo gjë ia shkapet lidhjet njeriut me Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Në këtë mënyrë, nuk e percepton mesazhin që i vjen dhe nuk shqetësohet për gjendjen në të cilën gjendet. Allahu Teala na njofton se ata që e harrojnë, do t'i ndëshkojë me vështirësi në këtë jetë dhe do t'i tubojë të verbër në Ahiret. Këto ajete në suren Taha, e tmerrojnë njeriun:

“Kushdo që i kthen shpinën këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër.” (Taha, 124)

“Ai do të thotë: ‘O Zoti im, përse më ringjalle të verbër, kur unë shikoja më parë?’ (Taha, 125.)

(Allahu) **do t'i thotë: “Kështu të erdhën shenjat Tona dhe ti i harrove ato e po kështu sot do të jesh i harruar.”** (Taha, 126)

“Kështu e ndëshkojmë Ne atë që e tepron (me gjynahe) dhe nuk beson shenjat e Zotit të tij. Ndërsa dënimi në jetën tjetër, në të vërtetë, është më i ashpër dhe më i qëndrueshëm.” (Taha, 127)

Allahu (xh.sh.), na tregon për fundin e keq të atyre që e harrojnë Atë. Po ashtu, na ka njoftuar se njeriu ka një zemër (Ahzab, 4). Në zemër ka formuar një ekuilibër fizik. Në zemër duhet të ketë vetëm një dashuri. Allahu i Madhëruar nuk dëshiron që rob i të ketë ndonjë dashuri më të madhe se ajo që ka për Të. Në suren ez-Zumer, thotë: **“A është njëllor si ai që Allahu ia ka hapur kraharorin për të pranuar Islamin, duke qenë kështu në dritën e Zotit të vet, (ashtu edhe ai që e ka zemrën të mbyllur ndaj besimit?) Prandaj, mjerë ata që e kanë zemrën të pandjeshme, kur përmendet Allahu! Njerëz të tillë janë në humbje të qartë!”** (Ahzab, 22) Siç shihet edhe në ajetin fisnik, zemra e mbushur me dashurinë ndaj Allahut Teala, zotëron dritë hyjnore.

Zoti, (xh.sh.), thotë në suren Bejjine se është i kënaqur prej atyre që besojnë dhe bëjnë punë të mira dhe i cilëson ata si robër të kënaqur nga Ai: **“Shpërblimi i tyre është te Zoti: Kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. Allahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet.”** (Bejjine, 8)





Edukimi fetar dhe këndimi i Kuranit

Nurullah Dag

Edukimi përkufizohet si procesi i ndryshimit dhe zhvillimit të sjelljeve. Bazuar në këtë edhe edukimi fetar konsiston në zbatimin e këtij procesi ndryshimi me anë të elementeve fetare. Ka shumë elemente islame, të cilat ndikojnë në personalitetin e njeriut. Prandaj, në emër të edukimit të personalitetit njerëzor, është e nevojshme që edhe këto elemente të përdoren më shumë. Këto elemente, si dashuria, siguria, liria, meditimi, drejtësia, durimi dhe vullneti, formohen kur njeriu edukohet njëkohësisht nga të gjitha aspektet, si ato shpirtërore, ashtu edhe ato fizike. Nëse elemente të tilla funksionojnë në mënyrë të suksesshme, padyshim se do të kontribuojnë jashtëzakonisht shumë në fitimin e lumturisë personale dhe shpëtimin në botën tjetër.

Në këtë shkrim, krahas parimeve të edukimit fetar që duhen zbatuar për të arritur lumturinë e kësaj bote dhe botës tjetër, dëshirojmë të ndalemi edhe në rëndësinë e “Këndimit të Kuranit”. Këndimi i Kuranit zë një vend të rëndësishëm në edukimin fetar. Nuk ka dyshim se Kurani Fisnik është elementi më kryesor i shpëtimit të myslimanit dhe vlerësohet shumë, si për nga përsosmëria e shprehjeve origjinale, ashtu edhe për nga kuptimi që bart. Kjo veçori e tij ka shtyrë shumë dijetarë që ta përkufizojnë atë me shprehje magjepsëse.

Në lidhje me fjalën e përjetshme të Allahut të Madhëruar, janë bërë përkufizime të mrekullueshme. Disa nga këto përkufizime janë në lidhje me përsos-

"Kurani është litari më i fortë i Allahut. Ai është një fjalë e mbushur me urtësi... dhe një rrugë që të çon tek Allahu. Ai i ruan nga rrëshqitja ata që e ndjekin atë dhe nga ngatërrimi, gjuhët që e lexojnë atë. Dijetarët nuk ngopen kurrë me të. Ai nuk e mërzit dhe nuk ia heq shijen atij që e lexon shumë. Anët e tij, që i mahnitin njerëzit, nuk kanë të sosur..."

mërinë e tij në këndim e disa të tjera në lidhje me dijet që burojnë nga thellësia e tij. Por këtu do të mjaftohemi me përkufizimin që bën Kurani për veten e tij dhe përkufizimin e bërë nga vetë Pejgamberi (a.s.), të cilat e shprehin më së miri madhësitinë e tij. Në Kuratin Fisnik urdhërohet: **"Elif Lâm Râ. Këtë Libër ta kemi shpallur ty (o Muhamed), për t'i nxjerrë njerëzit me lejen e Zotit të tyre, nga errësira në dritë, në rrugën e të Plotfuqishmit, të Denjit për çdo lavd."** (Ibrahim, 1) Ky përkufizim tregon qartë se Kurani është një libër edukimi.

Ndërsa, sipas Pejgamberit tonë të dashur (a.s.), Kurani: *"...është litari më i fortë i Allahut. Ai është një fjalë e mbushur me urtësi... dhe një rrugë që të çon tek Allahu. Ai i ruan nga rrëshqitja ata që e ndjekin atë dhe nga ngatërrimi, gjuhët që e lexojnë atë. Dijetarët nuk ngopen kurrë me të. Ai nuk e mërzit dhe nuk ia heq shijen atij që e lexon shumë. Anët e tij, që i mahnisin njerëzit, nuk kanë të sosur..."* (Tirmidhi, **Fedailu'l-Kuran**, 14; **Musned**, 1/91.)

Ky është një hadith shumë i gjerë, i cili tregon qartë shpirtin e Kuranit, përmbajtjen gjithëpërfshirëse të tij dhe faktin se ai është një thesar i pashtershëm. Pejgamberi (a.s.), e ka përkufizuar atë nga shumë aspekte, pasi e ka mësuar, kuptuar dhe jetuar në mënyrë të përsosur. Ata që bëjnë një jetë në përputhje me këtë përshtetë, kanë hapur velat e lumturisë në një det të madh shpirtëror.

Nëse një burim kaq i rëndësishëm, paraqitet në mënyrë që të reflektojë kuptimin e saktë në aspektin e leximit, padyshim se kjo paraqitje do të hapë në zemrën e atij që e dëgjon një dashuri për këtë libër të pasqor dhe do ta ndihmojë njeriun të përfitojë nga urtësia e pashtershme e Kuranit.

Sipas një shprehjeje, e cila vlerëson aspektet e këtij libri madhështor, thuhet: "Kurani u zbrit në Arabi, u këndua në Egjipt dhe u shkrua në Stamboll." Dhe me të vërtetë që zërat më të bukur dhe më të përsosur të Kuranit janë nga Egjipti. Përfaqësuesja kryesore

e këndimit të Kuranit, është zona e Egjiptit. Ky vend ka edukuar dhe ka nxjerrë njerëz të tillë, që kanë arritur gradën e përfaqësuesve në fushën e këndimit dhe të cilëve mjafton vetëm t'u përmendësh emrat dhe menjëherë do të lindë një lidhje dhe dashuri e veçantë për Kuratin.

Për shembull, kur kujton Abdussamedin, kupton se këndimi i Kuranit ka nevojë për një zë të bukur, kur kujton Mustafa Ismailin, kupton se në këndim ka nevojë për art dhe kur kujton Siddik Minshauin, kupton se në këndimin e Kuranit ka nevojë edhe për një lexim melankolik.

Nuk mjafton që Kurani të lexohet vetëm me fjalë. Atmosfera që duhet të japë melodia e tij, padyshim që duhet të jetë atmosfera që jep kuptimi i tij. Të ndjesh kuptimin e tij në një pikë, varet nga këndimi i tij me një stil të veçantë. Këndimi i Kuranit duhet ta bartë njeriun në horizonte të tjera. Ai duhet të reflektohet në zemrën e njeriut si një thirrje që vjen prej Allahut. Një këndim që nuk të ledhaton shpirtin, nuk të rehaton zemrën dhe nuk ndikon në fjalët dhe veprat e njeriut, nuk mund të arrijë sukses. Një këndim melankolik, është si një letër hyjnore. Po kështu, është edhe një këndim që përmban thellësi dhe art. Për këtë arsye, një letër që paraqitet në një format hyjnor, patjetër që do të bëhet shkak i shumë ndryshimeve në personalitetin e njeriut dhe do të marrë vlerë në edukimin fetar të njeriut.

Duke u nisur nga sa thamë më sipër, është e mundur të bëjmë këto vlerësime nga ana e edukimit fetar: Dëgjimi i këtyre leximeve kuptimplote që përmbajnë një art të veçantë, e kënaq njeriun nga ana shpirtërore. Dhe kjo kënaqësi shpirtërore do ta bëjë njeriun ta dëgjojë veten në lidhje me jetën fetare dhe ta detyrojë atë deri në pikën e frenimit të gjynaheve të ndryshme. Me kalimin e kohës, tek njeriu do të zhvillohet ndjenja e mirësisë dhe gjithmonë do të korrigjojë fjalët dhe veprat e tij, duke qenë i vetëdijshëm se në çdo moment vëzhgohet nga kamerat hyjnore.



Si u bënë sahabë?

Adem Saraç

Njohja e jetës së të Dërguarit të Allahut, alejhi's-selam, deri në detajet më të vogla të saj apo më sak-të, njohja e të Dërguarit të Allahut (a.s.), nga shumë afër, është dëshira më e madhe e çdo myslimani. Në të njëjtën kohë, kjo dëshirë është edhe për shokët e Tij të dashur, domethënë, për sahabët e nderuar. Jeta e të Dërguarit të Allahut (a.s.), me sahabët dhe jeta e sahabëve me të Dërguarin e Allahut (a.s.), është një unitet i përjetuar bashkërisht.

Studimi i ngjarjeve që kanë ndodhur në kohën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), pa nënvlerësuar qoftë edhe detajin më të vogël, është mënyra më e lehtë për të formuar një lidhje serioze me ata njerëz të zgjedhur. Kurani dhe Suneti kanë marrë formë në jetën e atyre personaliteteve të larta.

Secili prej sahabëve të nderuar është një model në vete, jo vetëm për myslimanët, por për të gjithë njerë-zinë. Bisedat, sjelljet dhe mënyra e jetesës së tyre që kanë bërë në çdo kohë dhe në çdo vend, janë të mbu-shura plot me shembuj të shkëlqyer. Siç e kanë edhe emrin, ata janë sahabë, sahabë... Sahabë, njerëzit që bënin luftë për dritë ndërmjet një mentaliteti të zymtë dhe njerëzve të errët!

Sahabët janë ushtarët e besimit, që e panë të Dër-guarin e Allahut, (a.s.), i besuan, i dhanë zemrën Atij, e morën për shembull dhe për prijës Pejgamberin (a.s.), jetuan me atë besim dhe vdiqën me atë besim.

Sahabët janë ata që flijuan jetën me gjithë dëshirë për Atë, duke thënë: "Pasuria, nëna, babai, familja, jeta,

gjaku dhe çdo gjë e imja të qofshin falë, o i Dërguari i Allahut!"²

Me diellin e Islamit, errësira u shndërrua në dritë, anarkia u shndërrua në rregull dhe dobësia u shndërrua në fuqi. Shoqëria kaloi nga poshtërimi i tmerrshëm në një rregull të lartë. Në vendet ku injoranca shkatërronte çdo gjë, filloi të lindë mirësia dhe humanizmi. Në këtë mënyrë, të gjithë njerëzimit i lanë trashëgiminë më të mirë. Ne duhet të mendojmë shumë mirë dhe ta anali-zojmë thellë se si ata i kanë kultivuar këto vlera në një kohë kaq të shkurtër.

Për ta kuptuar Islamin, Kuranin dhe Sunetin në for-mën më të mirë, duhet të shohim sahabët e nderuar. Duke i njohur ata, do t'i afrohem më shumë të Dërgua-rit të Allahut, alejhis's-selam. Kur t'i afrohem Hazreti Pejgamberit, i afrohem Allahut të Madhëruar. Kur t'i afrohem Allahut Teala, do të kemi mirësinë dhe mundë-sinë për të arritur kënaqësinë e Tij inshallah...

Sahabët, të cilët rilindën me besimin ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, u bënë shembujt më të lartë për historinë e njerëzimit. Shembujt më të lartë i për-faqësuan në mënyrën më të shkëlqyer. Edhe pse nuk ngeli gjë pa u ndodhur, rezistuan pa u lëkundur dhe duke shfaqur shembullin më të madh të sakrificës.

Ja pra, ne duhet t'i njohim dhe t'i duam sahabët e nderuar. Duhet t'i duam me gjithë zemër e shpirt. Duhet t'i duam aq shumë, sa që ata të bëhen një pjesë prej nesh. Ata duhet t'i njohim më mirë se farefisn tonë.



Sa bukur është të duash

Sadik Dana

Imam Buhari, rahimehullah, thotë: "Ndërmjet lajmeve që na kanë ardhur është edhe lajmi që Allahu Teala i ka shpallur Xhebrailit, alejhi's-selam dhe i ka thënë: 'O Xhebrail! Çfarë do të bëje sikur të të dërgoja në dynja dhe të të bëja prej banorëve të saj?' Xhebraili, alejhi's-selam, u përgjigj: 'Ti e di gjendjen time më mirë se unë, o Zot! Por sikur të isha prej banorëve të dynjasë, do përpqesha të bëja këto tri vepra: **E para**, do të ndihmoja ata që janë bërë me familje dhe e kanë të vështirë të sigurojnë të ardhura për të. **E dyta**, do t'i vija detyrë vetes t'ua mbuloja mëkatet dhe gabimet njerëzve, që të mos i shikonte askush përveç Teje. **E treta**, do t'u jepja ujë të eturve."

Aq sa t'i japësh një robi për të pirë nga dashuria jote, aq të do edhe Zoti. Domethënë, për të dashur një njeri, është farz të duhet Zoti. Lum për atë që e do Zotin, që ia di vlerën kësaj dashurie, e cila i është dhënë dhe e vlerëson. Vetëm robërit që i do Allahu Teala, e arrijnë përsosmërinë. Zoti ua ka hequr nga zemrat e tyre çdo lloj dëshire për këtë botë. Për këtë arsye, ata duan vetëm Atë. Ata që duan Atë, arrijnë çdo qëllim. Ata janë zhytur në shpresën që kanë te Ai dhe zemrat e tyre i kanë të pushtuara vetëm nga Ai. Në këtë mënyrë, në zemrat e tyre gjen vendosmëri vetëm dashuria ndaj Allahut Teala. Pastaj, këto zemra u kthehen në një det dhe thesar të paçmueshëm.

O Zot! Mos na privo nga mirësia e dashurisë, sepse çdo gjë gjelbëron, gjallëron dhe forcohet me dashurinë Tënde.

Kur kjo dashuri të arrijë në pikën kulminante të saj,

e deh njeriun, sepse vetja e tij del nga aty dhe ai ekziston me Atë që do. Kur vetja e njeriut del nga aty, ai arrin çdo lloj nderimi dhe mirësie të Rabbu'l-Alemin, domethënë, të Atij.

O Zot! Na bëj t'i duam ata që do Ti! Siç na ke bërë të duam të Dërguarin Tënd, (a.s.), na bëj të duam edhe çdo mik Tëndin! Na bëj të duam të gjithë Ehli Bejtin, sahabët e nderuar dhe të gjithë ata që e duan dhe i shërbejnë Islamit!

Sa bukur është të duash! Kështu që mjerë për atë që s'do! Ai që do, del nga kafazi dhe bëhet i lirë. O Zot! Ne të duam Ty në sajën Tënd. Po ashtu, në sajën Tënd i duam ata që i duam. Në sajën Tënd i duam ata që do Ti. Në sajën Tënd i duam ata që të duan Ty. O Zot! Ata që të duan Ty, edhe pse e kanë nxjerrë nga zemra çdo gjë përveç Teje, prapëseprapë i duan ato, por me masë. Në këtë mënyrë, kjo dashuri, nuk është pengesë për dashurinë që kanë ndaj Teje, sepse dashuria që kanë ndaj gjërave të kësaj bote, përbëhet vetëm nga thërrimet dhe grimcat e vogla të dashurisë që kanë ndaj Teje.

O Zot! Na bashko dhe mos na ndaj nga të dashurit e Tu! Sepse qëndrimi pranë tyre është xhenet, ndërsa qëndrimi larg tyre është xhehenem. Mos na ndaj prej të dashurve të Tu, në mënyrë që të përfitojmë sa më shumë nga nuri i tyre! Kënaqësia Jote arrihet vetëm duke të të adhurar Ty. Ndërsa kushti që ke vendosur për këtë adhurim, është zbatimi i përpiktë i urdhrave me dashurinë dhe orientimin që na ke dhënë dhe largimi nga ato që ke ndaluar.



VËLLAI I QUMËSHTIT I PROFETIT (A.S.), EBU SELEME MAHZUMI (R.A.)

Mustafa Erlsh

Ebu Seleme Mahzumi, (r.a.), ishte prej sahabëve të parë që hynë në Islam, sakrifikues, guximtar dhe trim!.. Ishte një ushtar besimi që zgjodhi Islamin dhe rezistoi në imanin e tij, edhe pse e kishte kundër popullin e vet!.. Ishte djali i hallës dhe vëllai i qumështit i të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Ishte prej trimave të parë muhaxhirë, që së pari shkoi në Abisini (Etiopi) dhe më vonë në Medine!.. Ai u lind dhe u rrit në Mekë dhe i përkiste fisit Beni Mahzum. Ishte një djalë trim dhe i fortë. Emri i vërtetë i tij është Abdullah ibn Abdulased. Ai njihet më shumë me llagapin se sa me emrin e tij.

Nëna e tij është halla e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), Berre binti Abdulmuttalib. Nëna e tij e qumështit është robëresha e Ebu Lehebit, Suvejbjja. Ebu Sulejme Mahzumi, (r.a.), ishte vëlla qumështi me të Dërguarin e Allahut, (a.s.) dhe me dajën e tij, Hamzanë, (r.a.). (Usdu'l-Gabe, VI, 148.) Ai u martua me bijën e Ebu Umejes, Hindin. Kur u lindi fëmija i parë, emrin ia vendosën Seleme. Pastaj atë e thirrën me llagapin Ebu Seleme. Edhe bashkëshorten e tij e thirrën Umme Seleme. Kur zbriti ajeti fisnik: **“(Së pari) paralajmëro më të afërmit!”** – Ebu Seleme Mahzumi iu përgjigj thirrjes së Diellit të dy Botëve (a.s.). Në këtë mënyrë, arriti nderin të ishte njëri prej dhjetë myslimanëve të parë. (Isabe, IV, 131-133.)

Populli i Ebu Seleme Mahzumit, (r.a.), ishte armik i

Islamit. Velid ibn Mugire dhe Ebu Xhehli, ishin kryetarët e këtij populli. Këta injorantë dhe politeistë të humbur, e torturuan shumë atë, por ai kurrë nuk e la besimin e tij. I përballoi dhe rezistoi kundrejt torturave dhe vështirësive. Nuk hoqi dorë nga Islami. Kur ngeli në pozitë të vështirë, u detyrua të strehohej te daja i tij, Ebu Talibi. Ebu Talibi mori nën mbrojtje nipin e tij, të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe Ebu Seleme Mahzumin. Politeistët u zemëruan dhe i thanë: “Nipin tënd, Muhamedin e more nën mbrojtje dhe nuk të thamë gjë, por marrjen nën mbrojtje të Ebu Selemes nuk do ta lejojmë kurrë.” Ebu Talibi shpalli se e kishte marrë nën mbrojtje duke thënë: “Po! Siç është Muhamedi nipi im, edhe ai është nipi im. Askënd nuk lejoj që ta prekë atë.”

Pas një kohe, mushrikët e tërbuar nuk dëgjonin më askënd. Ata filluan t’u bënë tortura të papërballueshme myslimanëve të pambrojtur. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut, (a.s.), u dha leje për të shkuar në Abisini (Etiopi). Ebu Seleme Mahzumi, (r.a.), për t’i inkurajuar myslimanët, së pari vendosi të bënte hixhret me bashkëshorten e tij. Bashkë me familjen doli fshehurazi nga Meka dhe shkoi në Abisini. Atje u lindi një djalë, të cilin e quajtën Umer. Pas një kohe, erdhën lajmet se disa prej të parëve të Mekës ishin bërë myslimanë dhe gjendja ishte qetësuar. Ebu Seleme, (r.a.), bashkë me disa myslimanë, u kthyen në Mekë. Për fat të keq, lajmet që kishin dëgjuar, nuk kishin qenë të vërteta. Ata nuk kishin mundësi të

ktheheshin prapa. Ngaqë nuk kishin asnjë zgjidhje tjetër, dikush hyri në qytet fshehurazi dhe dikush duke u marrë nën mbrojtje. Myslimanët ishin marrë nën bllokadë dhe ishin burgosur në një lagje. Padrejtësitë dhe torturat vazhdonin akoma. I Dërguari i Allahut (a.s.), për shkak të këtyre kushteve të vështira, dha leje për të emigruar në Jethrib (Medine).

Ebu Seleme, (r.a.), përsëri bashkë me familjen e tij, doli një natë fshehurazi nga Meka, por pa kaluar shumë, njerëzit e Beni Mugires i arritën. Ata ishin kundër largimit të tyre nga Meka. Ata morën Selemen, i cili ishte akoma një foshnje dhe Ummu Selemen, ndërsa Ebu Selemes (r.a.), i dhanë leje të largohej. Kur Abduledsedët dëgjuan për këtë, u zemëruan shumë dhe thanë: "O Beni Mugire! Ju ia morët bashkëshorten nga duart birit tonë. Për Zotin, edhe ne nuk ua lëmë Selemen." Pastaj ua morën fëmijën duke e tërhequr. Babai në Medine, nëna në Mekë te Beni Mugire, ndërsa fëmija te fisi i tij Beni Esedët. Kështu qëndruan rreth një vit në vende të ndryshme. Pasi Beni Mugire i dhanë leje Ummu Selemes (r.a.), për të bërë hixhret, edhe Beni Abduledsedët e dorëzuan djalin te nëna e tij. Pa humbur aspak kohë, Ummu Seleme bëri hixhret në Medine dhe shkoi te bashkëshorti i saj. (Ibn Hisham, Sire, 2/468.)

Kur Ebu Seleme Mahzumi, (r.a.), shkoi në Medine, qëndroi si mysafir në shtëpinë e Mubeshir ibn Mundhirit, (r.a.), në Kuba. (Ibn Sa'd, Tabakat, III, 241.) I Dërguari i Allahut, (a.s.), e shpalli vëlla me Sa'd ibn Hejsemen, (r.a.), i cili ishte prej ensarëve. (Ebu Nuajm, Hiljetu'l-Evlja, II, 3.)

Ebu Seleme Mahzumi, (r.a.), ishte një trim hero dhe i aftë për të komanduar. Mori pjesë në luftën e Bedrit dhe të Uhudit. Në Uhud ishte komandanti i anës së majtë. Përgjatë betejës u plagos rëndë dhe humbi shumë gjak. Pastaj u mjekua dhe plaga iu mbyll. Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), pa se ishte shëruar, e bëri komandant të ushtrisë, që u dërgua në një operacion në anën e fisit Beni Esed, në Katan. Në një kohë agimi, Ebu Seleme, (r.a.), i sulmoi Beni Esedët dhe u kthye me shumë plaçkë lufte. Por kur u kthye në Medine, plaga filloi t'i rridhte gjak dhe të përkeqësohej. Më së fundi, nuk u ngrit më nga shtrati.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), e vizitonte atë shpesh, e pyeste për gjendjen dhe kërkonte rrugëzgjidhje për shërimin e tij. Por ai ishte drejtuar nga Zoti dhe shpirtin po ia dorëzonte Atij. Ky hadith fisnik, që tregon çastet e fundit të jetës së tij, transmetohet nga bashkëshortja e tij Ummu Seleme, radijallahu anha, në përkthimin dhe shpjegimin e Rijazu's-Salihin. Transmetohet se Ummu Seleme, radijallahu anha, ka thënë: "I Dërguari i Allahut, (a.s.), hyri te Ebu Seleme (i cili kishte ndërruar jetë).

Sytë i kishin ngelur hapur dhe ia mbylli. Pastaj tha: "Kur shpirti del, sytë e ndjekin atë." Pikërisht në atë moment, disa pjesëtarë të familjes së Ebu Selemes (r.a.), filluan të qanin me dënësë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), tha: "Lutuni vetëm për mirësi, sepse engjëjt u thonë amin lutjeve tuaja!" Pastaj u lut kështu: "O Zot! Fale Ebu Selemen! Lartësoje atë në shkallën e të udhëzuarve! Mbroji edhe ata që ka lënë pas! O Zot i botëve! Na fal neve dhe atë! Zgjerota varrin dhe ndriçoja atë!" (Muslim, Xhenaiz, 7.)

Në shpjegimin e këtij hadithi janë theksuar këto çështje: Bashkëshorti i parë i nënës sonë, Ummu Selemes, radijallahu anha, Ebu Seleme Abdullah bin Abduledsed Mahzumi (r.a.), kishte vdekur. I Dërguari i Allahut (a.s.), kishte shkuar dhe ia kishte mbyllur sytë që i kishin ngelur hapur, duke thënë: "Kur del shpirti, sytë e ndjekin atë." Kështu veprohet, ngaqë pas vdekjes, sytë ngelin të fiksuar në një pikë dhe japin një pamje jo të mirë, nëse nuk mbyllen. Meqë Krenaria e Gjithësisë, (a.s.), e ka bërë vetë këtë, kjo është shndërruar në një sunet për umetin. Të afërmit e xhenazes nuk është e drejtë të thonë ndonjë gjë negative për veten e tyre. Pejgamberi (a.s.), duke u lutur pikërisht vetë për Ebu Seleme Mahzumin (r.a.), ka treguar se si duhet të lutemi për myslimanët kur të ndërrojnë jetë. Në këtë dua që ka bërë i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ka tri mirësi. Këto janë një ngushëllim jashtëzakonisht i rëndësishëm për atë që ka ndërruar jetë dhe për të afërmit që ka lënë pas. Përballë një rasti vdekjeje, njerëzit, veçanërisht në çastet e para, nuk arrijnë ta kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë apo çfarë duhet të thonë. Ja pra, në ato çaste hutimi, është shumë e rëndësishme të shfaqim nënshtrim ndaj Zotit dhe të lutemi për mirësi pa na kapur paniku. I Dërguari i Allahut, (a.s.), më vonë i kërkoi Allahut Teala falje për atë që kishte ndërruar jetë dhe për njerëzit që gjendeshin aty. Në këtë mënyrë, theksoi se të gjithë kanë nevojë për mëshirën e Allahut (xh.sh.). Lutja për zgjerimin e varrit dhe ndriçimin e tij është kërkim për largimin e shqetësimeve në lidhje me çështjen e varrit, që është stacioni i parë i njeriut. Kjo është një lutje shumë qetësuese për të afërmit e të vdekurit. Zgjerimi dhe ndriçimi, s'ka dyshim se janë zgjerim dhe ndriçim shpirtëror. Për këtë arsye, humbja e vetëdijes në një ngjarje vdekjeje dhe fjalët që thuhën sikur njerëzit mallojnë veten, nuk është e drejtë.

Ebu Seleme Mahzumi, (r.a.), i cili dinte shkrim e këndim edhe para Islamit dhe i cili ishte prej shkruesve të shpalljes, ndërroi jetë në vitin e katërt hixhri. Namazin e xhenazes ia fali i Dërguari i Allahut, (a.s.) dhe u varros në varrezat Bakia. Allahu qoftë i kënaqur prej tij! Amin!



Asketizmi dhe pasuria

Nuredin Nazarko

Jeta e qenies njerëzore, është simbiozë e qartë mes dy përbërësve dhe pa këtë simbiozë nuk do të ishte as njerëzore. Natyra e dyfishtë e ka kushtëzuar njeriun në jetën dhe veprimtarinë e tij për të përballur sfidat e të jetuarit. Natyra e dyfishtë e ka kushtëzuar njeriun në ushqimin që duhet të marrë për të mbajtur jetën në jetë. Pjesa e tij fizike kërkon ushqimin e përshtatshëm për të dhe pjesa shpirtërore kërkon ushqimin e përshtatshëm për të. Meqenëse këta dy përbërës janë shkrirë mrekullisht në

një qenie të vetme, atëherë një jete të ekuilibruar i nevojitet domosdoshmërisht një ushqyerje e ekuilibruar, në mënyrë që çorientimi të mos jetë përmasa sunduese e qenies njerëzore. Për të përmbushur secilin përbërës, secilin dimension njeriu duhet të punojë, pasi që puna është shkaku kryesor që i mundëson njeriut sigurimin e ushqimit të nevojshëm për të jetuar. Kjo jetë është përcaktuar të jetë e tillë dhe si e tillë duhet përballuar, me durim dhe shpirtin e sakrificës. Njeriu është një qenie e errët dhe

kësisoj askush nuk mund të parashikojë se çfarë me të vërtetë mund të ndodhë me të, por ajo që ne dimë për veten dhe për të cilën nuk ka dyshim askush është fakti që duhet të ushqehemi për të mos vdekur në dy dimensionet tona. Sigurimi i ushqimit fizik është pjesë e pandarë e jetës së njeriut, derisa të shkelë horizontin e fundëm të jetës së tij. Për këtë çdokush duhet të lodhet, të djersijë, të sakrifikojë çdo ditë të jetës së vet. Nuk duhen ngatërruar gjërat dhe të mendojmë se njeriu jeton për tu ushqyer. Ky perceptim do të ishte faktor çekuilibruës në jetën e njeriut, pasi që do t'i jepte më tepër peshë dhe rëndësi kahjes së mbisundimit të materiales tek ai. Është mëse e vërtetë që pa ushqim rrezikojmë vdekjen, por mbi të gjitha duhet që përpjekjeve për sigurimin e ushqimit fizik, dhe jo vetëm, tu japim kahjen e duhur, duke i vendosur këto përpjekje nën dritën e parimeve themelore dhe shkakësive parake. Kësisoj do të jemi të qetë, në sakrificën tonë, në djersiten tonë, në lodhjen tonë dhe nuk do të ndiejmë peshën e rëndë të sigurimit të ushqimit fizik jo në mënyrën e duhur, jo në mënyrën e pranueshme nga parimet themelore dhe shkakësitë parake.

Njeriu është një qenie, që për realizmin e dimensionit material duhet të përballet me dëshirat e tij për konsum. Në këtë përpjekje shumë syresh përfunden nën peshën e dëshirave të tyre e disa syresh luftojnë për të mos rënë pre e tyre. Lufta është e hapur dhe askush nuk i shpëton dot kësaj lufte. Lufta është e hapur dhe askush nuk mund të largohet nga pataloku i jetës pa bërë një nga dy gjërat; ose luftë të vazhdueshme për të mposhtur logjikën e stomakut, ose kapitullim dhe nënshtrim ndaj dëshirave për konsum fizik. Në këtë luftë të ethshme mbushur me 1001 beteja, me rëndësi sikundërse e thamë është mbajtja e kahjes së duhur dhe boshtimi rreth saj. Njeriu është qenie që e dëshiron së tepërmi qënien si i pasur, pavarësisht se është apo jo i suksesshëm për të qënë i tillë. Aq i dëshiruar është ndaj pasurisë, sa që, po të kishte një luginë me flori, do të kërkonte të siguronte dhe një tjetër. Kur ta siguronte dhe luginën e dytë do të dëshironte të kishte të tretën. Kjo gjendje na kumton qartë se çfarë prove ka njeriu me veten e tij, për të mos u kolonizuar nga përmasa materiale e vetvetes. Po kështu kjo gjendje na kumton se pasuria është tepër e dashur për shpirtin njerëzor dhe se njeriu i është zbukuruar në shikimin e tij, zotërimi i sasisë. Për të patur sa më tepër pasuri njeriu punon gjithë jetën e vet, edhe pse e di se ajo

çfarë do të grumbullojë nuk do ta ndjekë atë nga pas, kur ai të mos ekzistojë më. E megjithatë ai punon për ta kaluar tek brezat pasardhës që do të vazhdojnë pemën e tij gjenealogjike. Zotërimi sasior duket se e kënaq paq njeriun, veçanërisht kur ndjen fëshfërimën e kartmonedhave teksa i numëron, apo kur sheh kapitalin fizik në zotërim të tij. Shumë syresh përhumben në mes të këtij zotërimi, madje përhumben aq shumë sa që nuk kanë më kontroll mbi pasurinë e tyre. Kjo sepse ata tashmë kontrollohen prej saj. Njeriu i mbërthyer nga etja për sasi çdokënd e sheh si mjet prej të cilit sheh si të përfitojë financiarisht. Çdokush i duket si një gur me lëvizjen e të cilit do të dalin në dritë monedhat flori, që do t'i shtohen shifrave që zotëron. Rrjedhimisht, ritmi i jetës së këtij njeriu është tërësisht i përcaktuar nga forca e materies, kundër së cilës nuk mund të rebelohet, sepse ndihet thellësisht i mbërthyer pas saj.

E çfarë duhet të bëjmë përballë këtij rreziku jo pak të vogël? Të mos punojmë që të pasurohemi? Të kënaqemi me pak dhe më pas të mos kemi as për të plotësuar nevojat minimale të të jetuarit? Të braktisim mjedisin që nxit dhe stimulon vazhdimisht të jetuarit nën ritmin e dimensionit material dhe të shndërrohemi në eremit? Të punojmë sa për të sigurojmë mbijetesën dhe të mos mendojmë për brezat që do të na trashëgojnë? Çfarë të bëjmë që të shpëtojmë nga molepsja me zilepsje për sasi?

Çdokush ka në dorë të zgjedhë, por jo të zgjidhë dhe çdokush është përgjegjës mbi mënyrën se si zgjedh të veprojë, të luftojë, për të mos u molepsur nga zilepsja për sasi. Natyrisht që nuk është e lehtë të realizosh një luftë të çmendur aty ku gëlojnë paudhësitë nga përfundja nën peshën e materies. Megjithatë, dorëzimi nuk duhet të jetë pjesë e atyre që ritmin e jetës e përcaktojnë nën dritën e parimeve themelore dhe shkakësive parake. Largimi nga të punuarit për tu bërë i pasur me frikën se do të humbim luftën me veten dhe do të përfundemi nga dëshira e ethshme për sasi nuk duhet të jetë bashkëshoqëruesja e njeriut në jetën e tij, përkundrazi duhet punuar për të qënë i pasur edhe ekonomikisht, edhe financiarisht. Kjo, që t'i jepet mundësi njeriut të tregojë se forca që buron nga parimet themelore dhe shkakësitë parake është e pamposhtur nga forca e verbër e materies. Por që të ndodhë kjo, një çmenduri aty ku gëlon materialistikja, njeriu nuk duhet të jetë asket ekzotërik, por asket ezotërik.

Në kuptimin leksikor, shprehja "karzi hasen" do të thotë hua e mirë, pra, borxh pa kamatë. Dome-thënë, një mysliman që e ka gjendjen materiale të mirë, të përpiket të nxjerrë nga vështirësia vëllain mysliman duke i dhënë borxh pa kamatë. Ky është njëri prej urdhrave të Allahut Teala që duhet kryer dhe një ibadet që ka shumë sevap. Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin Fisnik: **"Kush është ai, që do t'i japë vullnetarisht Allahut një hua të mirë, që Ai pastaj t'i a kthejë shumëfish?"** (Veç kësaj), **për atë do të ketë shpërblim fisnik.**" (Hadid, 11) **"Kush do t'i japë Allahut një hua të bukur, që Ai t'i a kthejë shpërblimin shumëfish? Allahu e shtrëngon (riskun) dhe e liron. Tek Ai do të ktheheni."** (Bakara, 245) Edhe i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem, ka thënë në lidhje me këtë çështje: *"Kush e shpëton vëllain e tij mysliman nga një vështirësi e kësaj bote edhe Allahu do ta shpëtojë atë nga vështirësia e Ahiretit."*

Në ditët e sotme, për fat të keq, bankat zënë ndërtesat më kryesore në rrugët më funksionale të qyteteve myslimane, sepse bankat po fitojnë më shumë se njerëzit që bëjnë reklama për të inkurajuar konsumin e tepërt dhe që prodhojnë e shesin mall me dëshirën për t'u bërë sa më të pasur në sistemin kapitalist, duke u kapluar nga lakmia e kësaj bote. Njëri prej shkaqeve më kryesore që kanë detyruar njerëzit të përfundojnë në banka dhe i ndyrjes së tyre me kamatë në mënyrë të pavetëdijshme, është mosnjohja e rregullave të marrjes së borxhit. Myslmani nuk duhet të marrë borxh, përderisa nuk është i detyruar, përveçse për ato gjëra që kanë nge-lur jashtë çështjes së zekatit në Islam, si një shtëpi për të banuar, një mjet udhëtimi, mobilitet e nevojshme të shtëpisë, mjetet e artit dhe të profesionit, librat, veshmbathja dhe sigurimi i ushqimit për një vit. I Dërguari i Allahut (a.s.), nuk ua falte namazin e xhenazes atyre që vdisnin dhe kishin borxh, derisa të shlyhej borxhi. Edhe njëri prej shkaqeve që myslimanët drejtohen te bankat, është harrimi i ibadetit të dhënies borxh pa kamatë ndërmjet myslimanëve. Them ibadet, sepse, sipas ajeteve dhe hadithit të mësipërm, nxjerrja e një myslimani nga vështirësia ka më shumë sevape se të gjitha ibadetet nafile pas ibadeteve farz. Në lidhje me këtë çështje, mund të përmendim edhe lënien e itikafit nga ana e Ibn Abbasit (r.a.), në muajin e Ramazanit dhe në Xhaminë e Pejgamberit, për të nxjerrë një vëlla mysliman nga vështirësia. Ky është njëri prej shembujve që duhet të mendohet seriozisht për sa i përket temës sonë.

Huaja

Ahmet Basher



Pa u tharë batakut i kam
bujqësi frytdhënëse, tregti
dhe ekonomi dinamike. Tregtar
në dyqane disa metra katrorë
"pak, ama e imja", të bas
dhe të hapin punishte ap

e mirë



amatës, nuk mund të ketë
fitimprurëse, ushqim hallall
të mysli-manë, që shtrëngohen
sh, duhet ta lënë mentalitetin
shkohen me njëri- tjetrin
o markete më të mëdha.


Mysli-manët nuk i besojnë njëri-tjetrit në lidhje me borxhet pa kamatë që mund të marrin ndërmjet tyre, sepse borxhet që jepen për një kohë të caktuar, nuk paguhet në kohë dhe nuk respektohen rregullat e borxhit që shprehen qartazi në ajetin e dyqindetëdhjetedytë të sures Bakara dhe i cili është ajeti më i gjatë i Kuranit Fisnik, si përcaktimi i sasisë së borxhit kur merret dhe kur jepet, të shkruarit e tij dhe dëshmia nga dy dëshmitarë burra etj. Ne i dimë shumë mirë pasojat e trishtueshme të atyre që nuk e respektojnë ditën e fundit të pagesës që duhet të bëjnë në bankë. Përse mysli-manët nuk ua paguajnë borxhin në kohën e duhur vëllezërve të tyre në fe, ndërkohë që shfaqin kujdes dhe përpjekje të madhe për të mos u ikur dita e fundit e pagesës në bankë?

Kjo është e pakuptueshme. Rindërtimi i vakëfeve të parave, që gjyshërit tanë kanë formuar në të kaluarën, për t'i bashkuar fort mysli-manët njëri me tjetrin dhe për t'u dhënë borxh atyre që ishin në vështirësi e që kishin nevoja urgjente për ndonjë aksident apo sëmundje, është shumë i domosdoshëm, në mënyrë që njerëzit të shpëtojnë nga fatkeqësia e borxhit.

Shumë mysli-manë nuk shpëtojnë dot nga bataku i kamatës dhe e humbasin kështu shtëpinë, makinën, dyqanin dhe çdo gjë të tyre, madje edhe jetën. Në këtë çështje kanë përgjegjësi mysli-manët e pasur, që nuk i ndihmojnë vëllezërit e tyre në vështirësi dhe ata që e shkatërrojnë ndjenjën e besimit në shoqërinë mysli-manë, duke mos e paguar borxhin që kanë marrë.

Pa u tharë bataku i kamatës, nuk mund të ketë bujqësi frytdhënëse, tregti fitimprurëse, ushqim hallall dhe ekonomi dinamike. Tregtarët mysli-manë, që shtrëngohen në dyqane disa metra katrorësh, duhet ta lënë mentalitetin "pak, ama e imja", të bashkohen me njëri- tjetrin dhe të hapin punishte apo markete më të mëdha. Nëse bashkohen punishtet apo marketet, mund të hapin edhe fabrika më të mëdha. Po ashtu, tre-katër shokë mund të bashkohen dhe të blejnë makinë pa u futur në kamatë. Në këtë mënyrë, mendoj se mund të shpëtojmë nga shtypja e çarqeve të kapitalizmit të pamëshirshëm dhe nga rënia në vepra haram, siç është kamata. Të gjitha këto që thamë, kanë lidhje me zbatimin e përpiktë të ibadetit të huasë së mirë.

Allahu i Madhëruar na mundësoftë të jetojmë të bashkuar e të fortë dhe të bëjmë një jetë të qetë, duke fituar pëlqimin e Tij. Po ashtu, na mbrojtë nga kundërshtimi i urdhrave të Tij! Amin!



Xhafer Durmush

NDRIÇIMI I AJETEVE PËRGËZUES



Njeriu është i gatshëm të motivohet me përgëzime, për të kryer punë që janë të vështira për egon e tij dhe dëshirues për t'u ruajtur nga punët e këqija, që i pëlqen egoja e tij. Lidhur me këtë, Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë: "Allahu i Madhëruar, nuk më ka dërguar si despot e inatçi, por si lehtësues e mësues." (Muslim, Talak, 29.) Tani le t'i freskojmë zemrat tona me disa ajete përgëzuese prej Kuranit Fisnik, duke dëshiruar që këto ajete të bëhen dritë shprese që ndriçojnë rrugën tonë.

Në suren Ahzab, ku përcaktohen vijat kryesore të shpalljes, urdhërohet: **"O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, përgëzues dhe paralajmërues. Njëkohësisht (të kemi çuar) si thirrës, që i fton njerëzit në rrugën e Allahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues. Jepu lajmin e mirë besimtarëve se Allahu ka (përgatitur) për ata dhunti të madhe!"** (Ahzab, 45-47)

Ndërsa në suren Bekare, lajmërohen shpërblimet që do t'u jepen besimtarëve që u vënë veshin ajeteve të Allahut: **"Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, gëzoji me kopshte të Xhenetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Sa herë që atyre t'u jepet si ushqim ndonjë frut i kopshteve, ata do të thonë: 'Këtë e kemi ngrënë**

edhe më parë'. Por atyre do t'u jepen vetëm fruta të ngjashme me ato të Tokës. Në Xhenet ata do të kenë bashkëshorte të pastra dhe atje do të jetojnë përgjithmonë." (Bekare, 25)

Siç shihet, në këto ajete fisnike janë treguar shpërblimet që do të marrin ata që kanë bërë punë të mira në këtë botë, duke qenë myslimanë dhe kanë shkuar në botën tjetër po si myslimanë. Po ashtu, theksohet se të mirat që do të jepen në xhenet, ngjajnë me të mirat e kësaj bote. Megjithatë, nuk duhet menduar se mirësitë në botën tjetër janë njësoj me të mirat e kësaj bote. Këtë e vërteton edhe një hadith fisnik, në të cilin thuhet: **"Banorëve të xhenetit do t'u jepen mirësi që nuk ua ka parë syri, nuk ua ka dëgjuar veshi dhe nuk u ka kaluar (menduar) në zemër."**...

Ndërsa në suren es-Saff, urdhërohet: **"O besimtarë, a doni t'ju drejtoj në një tregti, e cila ju shpëton nga një dënim i dhembshëm? Besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij dhe luftoni në rrugën e Allahut me pasurinë dhe jetët tuaja. Kjo, nëse do ta dini, është më mirë për ju. Ai do t'ju falë gabimet tuaja dhe do t'ju shpjerë në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe në banesa të mrekullueshme në Xhenetin e Adnit. Kjo është fitorja më e madhe. Ai do t'ju falë edhe dhunti të tjera që i dëshironi; ndihmën e Tij dhe një fitore të afërt! Andaj, përgëzoji besimtarët!"** (Saff, 10-13)

Besojmë se nën dritën e këtyre ajeteve dhe haditheve që përmendëm, mund të pajisemi përsëri me "vlerat që na bëjnë ne këta që jemi". Veçoritë që u shkojnë besimtarëve të devotshëm, mund t'i përvetësojmë

1. -shih. et-Taxh, Xhamiu li'l-Usul, fī ahadisī'r-Rasul, V, 402.

me një entuziazëm të ri. Një besimtar i devotshëm ka besim të plotë në të fshehtë; ai e beson Allahun sikur e sheh dhe mundohet të zbatojë me përpikëri fjalët e haditheve të Pejgamberit tonë të dashur (a.s.), sikur i dëgjon ato. Besimi i tij në botën tjetër, është pa mëdyshje dhe vepron gjithmonë me vetëdijen se do të japë llogari për çdo gjë që bën dhe flet. Ai mundohet që të gjitha fjalët, veprat dhe mendimet e tij të jenë në cilësinë e "punës së mirë". Dhe për këtë bën gjithmonë atë që duhet.

Ai kënaqet me atë që i ka caktuar Allahu dhe duke thënë: "në çdo gjë ka një mirësi", përpiket që çdo ngjarje ta shohë në mënyrë pozitive. Ai mendon pozitivisht për çdo gjë, përveç harameve dhe punëve të këqija. Çdo gjë e sheh me syrin e urtësisë dhe prej çdo gjëje merr mësim. Gjithashtu, çdo gjë që bën, dëshiron që të jetë një mundësi për ta afruar atë tek kënaqësia e Allahut.

Në marrëdhëniet njerëzore ai përpiket të përhapë buzëqeshjen dhe respektin. Mundohet të ringjallë vlerat tona të hershme të solidaritetit dhe ndihmës reciproke. Ai tregon rëndësinë e dashurisë së njërit-tjetrit për hir të Allahut dhe mëson faljen. Mundohet të jetë përqafues dhe gjithpërfshirës. Po ashtu, ai mundohet të gjallërojë virtytet islame, të cilat sigurojnë qetësinë në jetën e tij shpirtërore dhe paqen në jetën shoqërore...

Shpresojmë se, nëse përparojmë me entuziazmin që do të marrim prej ajeteve dhe haditheve, ne mund t'i shpjegojmë më lehtë virtytet islame, që e bëjnë jetën më të jetueshme. Për shembull, mund të shpjegojmë vëllazërinë, bindjen, dashurinë dhe respektin për të mëdhenjtë. Mund të shpjegojmë se haramet janë të shëmtuara dhe të dëmshme. Mund të themi se liria e vërtetë nuk arrihet me ndjekjen e dëshirave të egos, por me devotshmërinë ndaj Allahut.

Për ndërtimin e sigurisë në shoqëri, pikësëpari, mund të theksojmë se njerëzit duhet t'i japin rëndësi me besim të plotë fjalës së Allahut. Mund të themi se respekti që do të fitohet në sajë të besimit në Allahun, do të jetë më e lehtë dhe më e begatshme të përçohet në marrëdhëniet njerëzore. Mund të nxjerrim në pah frymën ringjallëse të punëve të mira dhe të dobishme, të cilat përhapin energji pozitive rreth e qark. Mund të japim mesazhin e ajeteve dhe haditheve që përgëzojnë dhe ushqejnë shpresë. Mund t'i prijmë përhapjes së mirësive pa u marrë me gjërat negative. Pra, në këtë mënyrë, mund të arrijmë ta ngushtojmë fushën e së keqes.

Ditën që do ta realizojmë këtë, të gjitha ajetet do t'i përqafojmë me mall si myzhde të veçanta. Gjithashtu, do të shohim se edhe ajetet paralajmëruese/frikësuese, janë përkujtime që kanë vlerën e përgëzimeve.



MARRËDHËNIA FALËNDERIM-MIRËNJOHJE

Në Kuranin Fisnik, gjenden shumë ajete që ftojnë në falënderimin e Allahut. Nisur nga kjo, duke filluar që prej besimit, të gjitha mirësitë që na ka dhënë Allahu i Madhëruar, si duart, këmbët, sytë, veshët etj., duhet ta nxisin njeriun në mirënjohje; duhet ta bartin atë në besnikëri dhe vlerësimin e mirësisë. Në një ajet fisnik, ku Allahu i Madhëruar i drejtohet popullit të Musait (a.s.), urdhërohet:

(Kujtoje) **kur Zoti juaj kumtoi: "Nëse tregoheni mirënjohës, Unë do t'ju shtoj edhe më shumë begatitë e Mia..."** (Ibrahim, 7)

Ndërsa Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Gjysma e besimit është durimi, ndërsa gjysma tjetër është mirënjohja" (Dejlemi, Musned, 378.) Po ashtu, në një hadith

tjetër, për të bërë të qartë dimensionin njerëzor të kornizës së mirënjohjes, thuhet: "Ata që janë shumë mirënjohës ndaj Allahut, falënderojnë edhe njeriun që u bën mirë." (Dejlemi, Musned, 1455.)



Mund të themi se mëshira zbret nga lart poshtë. Por ajo që e tërheq atë poshtë, është ndjenja e mirënjohjes dhe falënderimit që shfaqet nga poshtë lartë. Nisur nga kjo, mirënjohja dhe vlerësimi i mirësisë, duhet të jetë parimi i besimtarit, si në marrëdhëniet me Allahun, ashtu edhe në marrëdhëniet me njerëzit. Nuk duhet harruar se falënderimi është një shkallë drejt mirënjohjes, ndërsa mirënjohja është çadër për falënderimin. Mirësjellja që tregon njeriu kur falënderon tjetrin, e bën atë të jetë në paqe me vetveten dhe ata që e rrethojnë.

Besimtari është njeri i

Shprehja “kemi një dynja me punë”, të cilën shpesh e përdorim për të treguar se jemi shumë të zënë me punë, është tepër elementare për të na pasqyruar. Thënia jonë “kemi një dynja me punë”, nuk e pasqyron identitetin tonë të besimtarit. Për dikë që e sheh botën si një pemë nën hijen e së cilës pushon pak dhe ikën, “të ketë një dynja me punë”, padyshim se është një përngjasim zvogëlues. Nëse do të bënim një përkufizim nisur nga ky përngjasim, e vetmja shprehje që do ta pasqyronte punën tonë do të ishte, “kemi punë sa për këtë botë dhe botën tjetër”. Nëse dëshirojmë dhe jetojmë për botën tjetër, si është e mundur që angazhimet tona të jenë veç “një dynja me punë”?

Ne kemi shumë punë, fusha e punës sonë është e gjerë dhe qëllimi ynë në punë, është i mrekullueshëm. Ne jemi besimtarë dhe besimtari ekziston për të ndër-tuar këtë botë dhe për të fituar botën tjetër. Besimtari është një njeri që ka punë më tepër se kohë. Sapo të ketë mbaruar një punë, ai është i detyruar të fillojë një punë tjetër. Njeriu që punon për të larguar lodhjen, është njeriu që na këshillon edhe Kurani. Për këtë arsye, njeriu i cili e sheh çdo punë si një punë që duhet ta bëjë vetë, është njeriu i cili punon me vetëdijen dhe

pjekurinë e besimtarit.

Kështu del në pah edhe fakti se për sa kohë të jetë në punën e tij, njeriut i konsiderohet si adhurim. Kështu duhen parë edhe veprimtarët, si puna në arë, aktivitetet sportive, shëtitjet, vizitat, pushimet dhe punët brenda familjes. Besimtari jeton në një botë të shndërruar në xhami; në xhami fal namazin, në arë punon për të fituar furnizimin, i cili do t'i japë fuqi të kryejë adhurimet në xhami. Madje edhe aktivitetet sportive i bën me qëllim që ta ndihmojnë në adhurimet që kryen në xhami. Për këtë arsye, besimtari nuk është njeri që shëtit se nuk ka çfarë të bëjë; ai është njeri që edhe shëtitjen e kthen në punë. Në këtë mënyrë, edhe shëtitja e tij është e dobishme.

Sa shumë punë ka për atë që e sheh jetën me këtë sy... Çdo punë që bëhet, patjetër është e duhur dhe e dobishme. Nuk ka punë të padobishme, nuk ka papunësi. Koha është e pakët, puna e shumtë.

Besimtari është njeri i angazhuar. Në xhami është i angazhuar, sepse ndodhet në namaz. Natën në dhomën e tij, është i angazhuar, sepse përmend Zotin e tij. Ai është i angazhuar edhe nëse punon në punishten apo



angazhuar

në bahçen e tij. Është i angazhuar, edhe kur luan me fëmijën e tij. I angazhuar është edhe kur argëton nipërit e tij duke i marrë mbi kurriz dhe duke luajtur rolin e kalit. I angazhuar është edhe kur ulet e pi një kafe, duke bërë muhabet me gruan e tij, sikur të jenë çift i ri, edhe pse mund të ketë dyzet vjet që është martuar. Edhe nëse ndodhet në ndonjë mbledhje për të zgjidhur probleme të shoqërisë myslimane me aq sa ka aftësi e mundësi, ai konsiderohet i angazhuar në atë moment. Ai është i angazhuar edhe kur merr lapsin për të shënuar diçka nga një libër që po lexon. Besimtari është shumë i angazhuar edhe kur shkon në ndonjë vend për të vizituar vëllain e tij, një të sëmurë, një të afërm apo dikë për të cilin është mërziur. Gjithashtu, ai është i angazhuar edhe kur pret në ndonjë stacion autobusi apo merr ndonjë mjet udhëtimi për të shkuar në ndonjë veprimtari ku merren dije.

Ndërkohë që bën durim kur e kupton se Zoti i tij i ka caktuar të bëjë durim e të jetë i qëndrueshëm; ndërkohë që është i qëndrueshëm kur shejtani i thur hile për t'i rrëshqitur këmbën dhe e ruan besimin e tij kur fitnet/ngatërresat janë shtuar shumë, atëherë ai është i angazhuar me punë.

Besimtari është njeri që nuk ka kohë të lirë. Ai është i mbushur me punë, në xhami, në punë, në shtëpi, në rrugë, në vendin ku bën pushime, në ambientin ku pi kafe me vëllezërit, në vendin ku thuhet Allah dhe ku dëgjon atë që thotë Allah. Ai është i angazhuar dhe është serioz në angazhimin e tij. Asnjë punë e tij nuk është e nivelit të dytë.

Aq sa të rëndësishme janë mihrabi, minberi, safi dhe xhamia në sytë e tij, po aq të rëndësishme janë dhoma e ndenjes, kuzhina, dhoma e gjumit dhe shtëpia e tij. Edhe pse rrugët ku ecën nuk janë të shtruara me tapet, edhe pse vendi ku punon nuk është i pastër, në sytë e tij ato kanë rëndësi të nivelit të parë.

Besimtari, është njeri i angazhuar. Ai është i angazhuar me Zotin e tij. Mendja e tij, dora, këmba, gjuha, syri, veshi, interesi, përpjekja, durimi, qëndrimi, buzëqeshja, qarja, marrja dhe dhënia, ecja dhe ulja e tij, janë të gjitha të angazhuara me Zotin e tij. Besimi është një çadër e madhe për besimtarin; ai e mban atë nën hijen e punëve dhe angazhimeve të tij. Mjafton që besimtari ta dijë se është i angazhuar. Madje, mjafton të dijë se është i angazhuar edhe kur pi një kafe...



Zoti nuk i do SHPËRDORUESIT

Zoti thotë në Kuranin fisnik: **“Mos shpërdoro, se shpërdoruesit janë vëllezërit e shejtanëve dhe shejtani e ka mohuar Zotin e tij.”**

Zoti ynë ka cilësitë më të larta dhe emrat më të bukur. Ai është i Urti, Përcaktuesi. Ai e krijoi tokën në formën më të bukur dhe në një balancë të mahnitshme. Nëse përqindja e oksigjenit në tokë do të ishte pak më e madhe, toka do të digjej, ndërsa po të kishte më pak oksigjen asnjë gjallesë nuk do të jetonte në tokë. Toka ka largësinë perfekte ndaj diellit. Po të ishte pak më afër, do të digjej, po të ishte pak më larg gjithçka në tokë do të ngrinte. Allahu (xh.sh.), e ka vendosur gjithçka në vendin e duhur.

Po të shohim trupin tonë, këtë krijesë të Zotit, do shohim se çdo gjymtyrë dhe organ është në vendin e duhur, përderisa njeriu nuk e prish trupin e tij. Nëse një organ ka probleme, gjithë trupi ka probleme. Zoti ka vendosur çdo gjë brenda njeriut në një ekuilibër perfekt.

Po ashtu edhe feja jonë është e ekuilibruar. Ajo është fe e mesme, e cila gjithçkaje i ka dhënë hakun e saj. Po ashtu kjo fe kërkon që myslimani t'i japë gjithçkaje hakun e saj, të jetë mesatar dhe i ekuilibruar, as mos ta teprojë e as të mos e lërë mangët.

Një nga kërkesat thelbësore të fesë sonë, të cilën do ta shqyrtojmë në këtë temë, është **“Të ruhesh nga shpërdorimet”**. Ajetet kuranore dhe hadithet e profetit (a.s.), tregojnë, se shpërdorimi është punë e rrezikshme, punë që nuk e do as Zoti, as feja islame. Zoti thotë në Kuran: **“Hani e pini e mos e teproni, se Allahu nuk i do ata që e teprojnë.”** Unë dhe ti mund të jemi nga ata që shpërdorojnë, por nëse veprojmë kështu, le ta dimë se nuk na do Zoti dhe kur nuk na do Ai, ç'vlerë mund të

kemi ne si njerëz.

Ndërsa profeti Muhamed (a.s.), thoshte: *“Ju hani, pini, vishuni dhe jepni lëmoshë, por mos u hiqni mendje-mëdhenj.”* Zoti ka lejuar ngrënien, pirjen, veshjen dhe dhënien e sadakasë, por nuk duhet t'i bëjmë këto duke shpërdoruar, se Zoti nuk e do shpërdorimin. Kur Profeti (a.s.), mernte abdest, çdo gjymtyrë e lante tri herë dhe pastaj thoshte: *“Kjo është rruga ime. Kush vepron më shumë se kaq, e ka tepruar dhe kush e tepron, bën padrejtësi.”* Dikush mund të thotë: “Profeti (a.s.), i lante gjymtyrët vetëm tri herë, sepse jetonte në një tokë ku nuk kishte ujë.” Por profeti (a.s.), ka thënë: *“Nëse je në breg të një lumi, mos shpërdoro, se Zoti nuk i do shpërdoruesit.”*

Shpërdorimi fatkeqësisht është një kancer që ka kapur të gjitha nyjet e jetës tonë dhe habia më e madhe është se edhe të varfrit po shpërdorojnë. Shikojmë dhe dëgjojmë përditë se si shpenzojnë yjet e muzikës, kinematografisë dhe sportit. Habitesh nga mallrat që blejnë, nga veshjet që kanë, nga makinat e tyre. Ne habitemi dhe themi: “Si ka mundësi që një palë këpucë të kushtojë 1 milion dollarë, një bluzë të kushtojë 5 milion dollarë”. Ky është shpërdorim në rang ndërkombëtar, shpërdorim i atyre njerëzve që sot mbahen si yje të kësaj bote, të cilëve duhet t'u shkosh pas. Shpeshherë shikojmë ankande, ku shiten piktura, që ndoshta nuk kanë ndonjë gjë të madhe, ato nuk janë bërë as prej floriri e as prej argjendi, por megjithatë ato shiten me miliona dollarë dhe njerëzit normalë thonë: “Çfarë bëhet kështu! Si ka mundësi që një pikturë të kushtojë miliona dollarë, në një kohë që ka popuj të tërë që vdesin për bukën e gojës”.

Por më e rëndë se kjo është fakti, që disa të tjerë u

përgjigjen duke thënë: "Ti nuk merr vesh nga jeta moderne". Mund t' u them këtyre njerëzve: "Ndoshta nuk kuptoj gjë nga jeta moderne, ndoshta nuk kuptoj se si harxhohen kot miliona dollarë, por e kuptoj fare mirë, se sot 1 milion njerëz vdesin çdo vit për bukën e gojës, ndërsa miliona të tjerë vdesin për një ilaç, i cili kushton shumë pak". Ky është shpërdorim, të cilin nuk e do Zoti dhe aty ku ka shpërdorim, dije se ka padrejtësi në një krah tjetër, se Zoti i ka balancuar gjërat dhe po u teprua diku, do të jetë mangët diku tjetër.

Nuk shpërdorjnë vetëm yjet e "botës moderne". Shpërdorjnë edhe njerëzit e thjeshtë, madje ka shpërdorim edhe në shtëpitë e besimtarëve. Fatkeqësisht sot në vendet me popullsi më të madhe myslimane, atje ku ka naftë dhe para, bëhet një jetë vërtet e frikshme. Njerëzit shpërdorjnë nga mëngjesi deri në darkë, duke menduar se të jesh i zhvilluar, do të thotë të shpërdorosh, të kesh makina të shtrenjta e shtëpi luksoze.

Zoti dhe feja islame e urrejnë atë tavolinë, e cila është e shtruar me të gjitha llojet e ushqimeve, që mund t'i mjaftojnë një fisi të tërë, por në atë shtëpi janë vetëm dy – tre vetë, të cilët marrin diçka, ndërsa pjesa tjetër hidhet në koshin e plehrave dhe shikojmë përditë se ata kosha nuk mbushen me miza, por mbushen me njerëz që kontrollojnë për kafshatën e tyre. As atyre nuk u bën përshtypje dhe as ne nuk na bën përshtypje.

Islami e urren atë gardërobë, e cila është e mbi- mbushur me rroba, por vetëm çereku i tyre vishen, ose vishet maksimumi një herë në jetë dhe pastaj del nga moda. Kështu ato rroba mbeten aty ose hidhen në koshin e plehrave. Ndërsa nga ana tjetër, ka njerëz që nuk kanë se ç'të veshin.

Islami e urren atë pasuri, e cila mblidhet dhe nuk shpenzohet në rrugën e hajrit. Zoti thotë në Kuran: **"Ata njerëz që grumbullojnë florin dhe argjendin, ditën e Kiametit ajo pasuri nxehet në zjarrin e Xhehenemit dhe me të lyhen ballët dhe shpinat e tyre."** Pra, është shpërdorim kur atë pasuri që ta ka lënë Zoti, ta lësh të vdekur në shtëpinë tënde.

Dikush mund të pyesë me plot të drejtë: "Çfarë është shpërdorimi?"

Sipas fesë sonë, shpërdorimi është dy formash:

1- Ta shpenzosh pasurinë atje ku nuk duhet ta shpenzosh, qoftë edhe pak. Ibn Abasi (r.a.). thoshte: "Nëse e shpenzon një qindarkë aty ku nuk duhet, ti je shpërdorues. Por nëse e shpenzon gjithë pasurinë aty ku duhet, atëherë ti nuk je shpërdorues".

2- Ta shpenzosh aty ku duhet, por ta teprosh. Zoti na ka lejuar shumë gjëra, por na ka paralajmëruar që të mos jemi shpërdorues.

Ta teprosh në ushqim: Të hash aq shumë, sa të të dhembë barku, është shpërdorim. Sot shumë njerëz

ve u dhemb barku nga ushqimi i tepërt, ndërsa pjesa tjetër e botës ka dhimbje barku, sepse nuk ka se ç'të hajë, pasi vuan për kafshatën e ditës. Jo vetëm kaq, por janë hapur sa e sa klinika, të cilat japin receta dhe dieta pa fund, në mënyrë që njeriu të dobësohet, por askujt nuk i shkon në mendje (ose nuk e përmend qëllimisht) të pakësojë ushqimin që ha çdo ditë. Sot po vuajmë me sëmundje nga më të ndryshmet, që vijnë si pasojë e abuzimit me ushqimin. Kurse Profeti (a.s.), thoshte vetëm dy fjalë të shkurtra: **"Vallahi, nuk ka besuar në Zot ai njeri, që fle me barkun plot, ndërkohë që komshiu i tij fle i uritur."** Ndërsa sa i përket konsumimit të ushqimit, profeti (a.s.), ka thënë: **"I mjaftojnë birit të Ademit disa kafshata sa për të mbajtur shpinën drejt. Por nëse i duhet të hajë, le ta mbushë 1/3 me ushqim, 1/3 me ujë dhe 1/3 me ajër."**

Ta teprosh në veshje: kur të shkosh për të blerë një rrobë, pyete veten: "A e kam të nevojshme ta blej këtë rrobë dhe me këtë çmim". Nëse nuk e ke të nevojshme, mos e bli atë rrobë. Mos e bëj këtë gjë as për mendjemadhësi e as për inat të dikujt tjetër që e ka blerë atë rrobë.

Ka shpërdorim edhe në shumë gjëra të tjera:

- **Shpërdorim në argëtim:** Zoti e lejon argëtimin, por pa e tepruar, duke kaluar orë të tëra me dëfrime e qejfe.

- **Shpërdorim në kohë:** pra të rrish me orë të tëra duke pirë kafe me dikë, pa pasur produktivitet as nga muhabeti që bëhet. Në raste të tilla biseda degjeneron duke marrë të tjerët nëpër gojë, për të mbushur kohën. Koha është gjëja më e shtrenjtë që të ka dhënë Zoti dhe Ai do të të kërkojë llogari për të.

- **Shpërdorim në kritika:** kur ta kritikosh dikë, mos e tepro, se pastaj i humbet vlera edhe kësaj kritike.

- **Shpërdorim në zemërim:** zemërimi është diçka normale, është njerëzor, por po e teprove, dije se ke shpërdoruar dhe ai që më së shumti shpërdoron në zemërim është mynafiku (dyfytirëshi). Ndërsa besimtari edhe kur zemërohet, mundohet ta kontrollojë veten e tij.

- **Shpërdorim në hakmarrje:** Ti ke të drejtë të marrësh hak kur të bëhet padrejtësi, megjithëse po fale është më mirë për ty. Por mos i bëj padrejtësi tjetrit, mos i bjer në qafë më shumë sesa të ka rënë ai ty, se Zoti nuk e pëlqen padrejtësinë, qoftë edhe mbi armikun tënd.

- **Shpërdorimi në hallall:** shumë njerëz lënë bashkëshortet e tyre dhe rendin pas haramit. Po ta shikosh jetën e këtyre njerëzve, do vëresh se ata i kanë hyrë dikujt në hak, sepse kush lë hallallin dhe shkon në haram, ai bën padrejtësi.

Dikush mund të pyesë: "Ç'na thua për shpërdorimin, kur nuk plotësojmë dot nevojat elementare të jetës". U përgjigjem këtyre njerëzve: "Vallahi edhe fukarenjtë

shpeshherë janë shpërdorues. Shpërdorojnë atëherë kur shpenzojnë më shumë sesa kanë nevojë, duke mos e administruar mirë atë pasuri të pakët që u ka dhënë Allahu (xh.sh.). Madje, pjesa më e madhe e shpërdoruesve janë ata persona, që deri dje kanë qenë fukarenj. Ata që Zoti deri dje i sprovoi me varfëri, sot shpenzojnë pa kriter, duke mos menduar se sprova e pasurisë është më e rëndë se ajo e varfërisë.

Le të ruajmë një ekuilibër, se jeta nuk shkon njësoj si sot nesër e pas një viti. Sot je pasanik dhe nesër të sprovon Zoti me varfëri, por njeriu që është gjithmonë i ekuilibruar, ai gjithmonë di të jetojë. Ndërsa ai që shpërdoron, jeton mirë kur është i pasur, por vuan shumë kur bëhet i varfër dhe Zoti nuk i merr leje askujt kur ia jep apo kur ia merr pasurinë.

Kujdes tek fëmijët tanë, sepse për ata punojmë e rropatemi. Harrojmë se duke shpërdoruar për ta, ne i edukojmë keq dhe kjo gjë do të ketë pasojë për ne dhe për ta. T'ia mbushësh fëmijës xhepin me para, është shpërdorim, se ai nuk e merr vesh ç'do të thotë të kesh pasuri. T'ia plotësosh të gjithë tekat fëmijës, është shpërdorim. Plotësoji nevojën, por jo të gjitha tekat, pasi historia ka treguar se shumë njerëz janë munduar t'i bëjnë qejfin fëmijës, por më vonë e kanë paguar shtrenjtë këtë veprim.

Profeti Jusuf (a.s.), u bë ministër ekonomie në Egjipt, por kur hante, nuk ngopej asnjëherë. Shokët që kishte përreth e pyesnin: "Pse nuk ngopesh"? Ai ua kthente: "Kam frikë se po u ngopa, do t' i harroj nevojtarët, se i ngopuri nuk e ndjen mirësinë që i ka dhënë Zoti".

Populli ynë vuajti nga një regjim i egër si nga ana ideologjike, ashtu edhe nga ana ekonomike dhe mund të themi se jemi një nga popujt e varfër të botës. Por mendoj se përsëri po shpërdorojmë shumë, madje më shumë sesa pasanikët. Ne duhet ta kapim në kohë këtë fenomen, që ta ruajmë veten tonë dhe të ndikojmë për mirë edhe tek të tjerët. Ja disa fakte të dhimbshme:

- Në Shqipëri, në një nga vendet më të varfra evropiane, gjen makinat më të shtrenjta të Evropës. Si ndodh kjo? Dije se në një formë apo në një tjetër këtu ka shpërdorim.

- Në Shqipëri, ku rroga mesatare është 250 mijë lekë të vjetra në muaj, gjen celularët më të shtrenjtë që mund të ekzistojnë, në një kohë që njeriu mund të mos e ketë të nevojshëm këtë lloj celulari.

- Në Shqipëri shpërdorohet me dritat. Ka shumë njerëz që nuk paguajnë faturën e dritave. Por shtëpitë e këtyre njerëzve duken si kështjella mbretërore me drita nga të katër anët, nga çatia deri në oborr. Nga ana tjetër, këtë shpërdorim e paguan pjesa tjetër, që i

paguan ato drita. Atyre u vjen fatura e pesëfishuar dhe kjo krijon stres, zemërim dhe prishje të ekuilibrit.

- Në Shqipëri shpërdorohet uji. Jemi një vend që noton mbi ujë, por uji na vjen në shtëpi me orar. Shikon shtëpi që kanë javë të tëra që nuk u vjen uji, por nga ana tjetër, sapo del në rrugë, shikon lavazhe pa fund, që me tuba të gjatë uji lagin rrugën kot së koti. Askush nuk e merr mundimin të njoftojë autoritetet përkatëse. Madje edhe kur vjen uji në shtëpi, çezma rri gjithë kohën e hapur, sepse shumë njerëz nuk e paguajnë ujin. Ky është problemi. Kur paguan ujin, e kursen atë, përndryshe shpërdoron pa kriter. Kjo do të thotë të jesh rob i ligjit, por ne nuk jemi robër të ligjit, por të Allahut (xh.sh.).

- Është mirë që shtëpia të jetë e kompletuar, por habitesh kur shikon se çfarë luksi ka brenda shtëpisë së dikujt dhe çfarë papastërtie ka përreth shtëpisë së tij. Pak më larg shtëpisë së tij vazhdon me qetësinë më të madhe kanali i ujërave të zeza, i cili i mbyt fëmijët, i prish jetën atij personi, por ai nuk mbledh 20-30 lekë të vjetra bashkë me njerëzit e tjerë për të rregulluar kanalin apo rrugën e prishur.

Ky është shpërdorim, të shpenzosh për atë që nuk e ke të nevojshme dhe të mos shpenzosh në atë që është jetike për ty. Prandaj shkollat tona janë shkollat më të prishura. Të gjithë presin ndihma dhe shumë njerëz që vijnë nga jashtë për të ndërtuar shkollën, habiten dhe ikin duke thënë: "Shikoni shtëpitë e këtyre njerëzve. Ata kanë blerë çdo mobilie që mund të të shkojë mendja dhe nuk paskan para për të rregulluar shkollën e fëmijëve të tyre?"

Njerëzit sot shikojnë vetëm oborrin e shtëpisë së tyre, duke mbjellë pemë e lule, kur pak metra jashtë shtëpisë së tyre shkulen pemët e rrugëve dhe askush nuk e prish terezinë e tij. Pak më larg fatkeqësisht digjen me qindra dhe mijëra hektarë pyje e askush nuk pyet me muaj të tërë. A nuk është tokë e vendit tonë kjo, a nuk ka pasur njerëz në këtë vend? Pasi ndodh hataja të gjithë e paguajnë faturën pastaj.

Profeti (a.s.), tha: "Dijeni o besimtarë, se Zoti i urren për ju tri gjëra: 1- Zoti urren thashethemet. 2- Zoti urren shpërdorimin e pasurisë që ua ka dhënë amanet dhe për të cilën do të pyeteni. 3- Zoti urren që të pyesni shumë e të mos veproni."

Zoti na ruajtë nga shpërdorimi. Zoti na bëftë prej atyre që as nuk e teprojnë, as nuk e lënë mangët. Zoti na bëftë myslimanë të mirë për veten tonë, për familjet tona dhe të mirë për gjithë botën mbarë. Zoti i faltë gjynahet, mangësitë tona dhe na mëshiroftë të gjithëve.

Amin!..




ÇADRA PREJ AJRI

Ndërsa ndodhemi në sezonin e reshjeve të shiut dhe borës, një kompani kineze i ka marrë masat duke krijuar një çadër prej ajri.

Çadra prej ajri, e projektuar në tri modele, ka formën e një shufre me një piramidë të përmbysur në majë, nga e cila del ajër i fortë që mban larg shiun. Avantazhi i kësaj pajisjeje të teknologjisë së lartë është se nuk ka një shtresë të lidhur me tela, që ndodh shpesh herë edhe prishen, dhe përdoruesit nuk kanë përse të shqetësohen se do të pengojnë të tjerët me çadrën e tyre. Avantazhi tjetër është se nuk pengon shikimin e rrugës.

Kompania që ka krijuar këtë çadër thotë se ajo mund të mbrojë dy njerëz nga reshjet e shiut dhe të dëborës, dhe nëse reshjet janë të pakta, ajo mund të mbulojë edhe tre persona.

Ka tri versione të çadrës me ajër, një për femra që



është 30 cm e gjatë, peshon 500 gramë dhe bateria e saj mund të zgjasë 15 minuta. E dyta, për meshkuj, do të jetë 50 cm e gjatë, 800 gramë dhe bateria zgjat 30 minuta. E treta, e krijuar për të gjithë njerëzit, do të jetë e gjatë nga 50 cm deri në 80 cm, peshon 850 gramë dhe bateria do të zgjasë 30 minuta. Të gjitha këto versione të çadrave do të përdorin bateri litiumi-ion. Kjo çadër prej ajri kushton 108 dollarë.

MICROSOFT BËN GATI TË SFIDOJË IPHONE 6



Kompania Microsoft është duke punuar në telefonin e ri Lumia 1030, i cili po cilësohet se mund të jetë më i suksesshëm sesa iPhone 6 nga Apple. Një prototip i pasardhësit të Lumia 1020 është shfaqur përkrah iPhone 6, duke paralajmëruar se kjo pajisje do të ketë ekran më të madh sesa telefoni i Apple. Në fotografirinë e publikuar nga PhoneArena, gjithashtu vërehet kamera PureView, e cila dominon në pajisjet e Microsoftit. Më parë ishte bërë e ditur se telefoni misterioz do të ketë një ekran 1920x1080 Full HD dhe 2 gigabajt ram. Pajisja gjithashtu do të jetë e fuqizuar nga sistemi i ri operativ Windows Phone 8.1. Microsoft besohet se është duke zhvilluar telefonin e ri nën emrin e koduar McLaren, por ende nuk e ka zyrtarizuar atë.

NASA, PLANE PËR NJË SONDË TË RE 1.5 MILIARDË DOLLARSHE PËR NË MARS

Në përpjekjet e pafundme për të eksploruar planetin e kuq Mars, NASA ka njoftuar për plane të reja për në Mars. Të Martën, NASA ka bërë të ditur planin për të ndërtuar një sondë të re 1.5 miliardë dollarshe për të dërguar në Mars brenda 2020-s. Sonda e re do të jetë shumë e ngjashme me atë të tanishmen, 'Curiosity'.

Sonda nuk është emëruar ende, por do të jetë misioni i dytë i Marsit, edhe pse kohët e fundit NASA ka pasur shumë shkurtime në fonde dhe në buxhet. Për shkak të këtyre kursimeve, sonda e dytë do të bazohet në atë të parën, dhe madje do të jetë pothuajse e njëjta.

"Sfida për të ristrukturuar Programin e Eksplorimit të Marsit është kthyer nga shtatë minuta terrori për uljen në Mars të 'Curiosity'-t, në fillimin e shtatë viteve novacioni," ka thënë në një deklaratë John Grunsfeld,

shefi i shkencës së NASA-s.

"Koncepti i misionit të ri përputhet me projektet e buxhetit të tanishëm të eksplorimit të planetit të kuq, dhe do të ndërtohet mbi zbulimet e 'Curiosity'-t," ka shtuar Grunsfeld pas njoftimit për misionin e ri.

"Sonda e re do të mund të bëhet realitet falë dhe pjesëve që na kanë mbetur nga ndërtimi i sondës së tanishme që kemi," ka thënë Grunsfeld. "Ekuipazhi jonë është akoma bashkë, dhe do të përfitojmë për të ndërtuar sondën e 2020-s."

Buxheti fiskal i administratës Obama për 2013-s ka sjellë një ulje prej 20% në fonde për eksplorimet e NASA-s, me uljet më të shumta në programin për në Mars. Ulje të tjera priten të vijnë edhe në vitet e ardhshme.

HARMAT E ARABISË, TË SHIJSHME DHE TË SHËNDËTSHME

Këto fruta tropikale ndihmojnë të ruani shëndetin e përgjithshëm dhe të luftoni një varg të sëmundjeve dhe çrregullimeve tjera shëndetësore.

Studimet kanë treguar se hurmat janë të pasura me shumicën e vitaminave, ndërsa përmbajnë edhe shumë përbërës tjerë me efekt antioksidues.

Antioksiduesit janë substanca që luftojnë radikalet e lira dhe mbrojnë nga shumë probleme shëndetësore, duke luftuar kështu procesin e plakjes së organizmit.

Ato ndihmojnë edhe në ruajtjen e një lëkure më të butë dhe më të freskët.

Hurmat përmbajnë edhe disa përbërës me efekt anti-kanceröz, të cilët në gjendje të vrasin ose frenojnë rritjen e qelizave kanceroze.



Konsumi i hurmave po ashtu është shumë i mirë edhe për sytë.

ÇAJ SHTOGU PËR LEHTËSIMIN E FTOHJES DHE GRIPIT



Shtogu është një nga pak bimët mjekuese që ndihmon jo vetëm në lehtësimin e simptomave të ftohjes dhe gripit, por që shkurton edhe kohëzgjatjen e tyre.

Studimet kanë treguar se simptomat e personave që vuajnë nga gripi ishin shkurtuar për katër ditë te pacientët të cilën kishin përdorur shtog.

Hulumtuesit besojnë se efekti i shtogut në trajtimin e simptomave të ftohjes dhe gripit u vishet antioksiduesve të veçantë që përmban kjo bimë. Ato ulin inflamacionin dhe stimulojnë sistemin imun.

Shtogu mund të përdoret në formë të çajit të luleve ose shurupit të nxjerrë nga frutat e bimës. Ju mund ta përdorni atë tre deri në katër herë në ditë.

Kur është fjala te frutat e shtogut, gjithmonë duhet të keni kujdes të mblidhni ato pasi të jenë të pjekura mirë, pasi frutat e papjekur mund të jenë helmuese. Po ashtu, para përdorimit frutat duhet të gatohen ose zihen në bazë të udhëzimeve.

SHERBELA DHE LIMONI MBROJNË TRURIN

Shkencëtarët britanikë kanë analizuar efektin e ekstrakteve të ndryshme bimore të cilat shfrytëzohen në mjekësinë tradicionale dhe kanë vërejtur se ekstrakti i bimëve të sipërpërmendura ka dhënë rezultate shumë pozitive në disa studime të tyre.

Autorët thonë se janë të dyja bimët që kanë përmirësuar memorien, dhe derisa sherbela ka ndikuar edhe në vëmendjen dhe sjelljen, ekstrakti i limonit ka ulur shqetësimin dhe ka përmirësuar kualitetin e jetës të moshuarit me Alzheimer.

Përdorimi i tyre te personat vullnetarë po ashtu ka dhënë efekte anësore minimale.

Alzheimeri është forma më e shpeshtë e demencës nga e cila vuajnë miliona njerëz. Kjo sëmundje karakterizohet me humbjen e të mbajturit mend, gjë që përkeqësohet në mënyrë progresive.



SHEQERI, MË I RREZIKSHËM SE KRIPA PËR HIPERTENSIONIN

Sheqeri i shtuar në ushqimet e përpunuara dhe në pijet me gaz përbën një rrezik më të madh për zemrën sesa kripa. Doktorët thonë se udhëzimet ushqimore duhet të përqendrohen më shumë në rrezikun nga sheqeri sesa nga kripa.

Një studim i ri paralajmëron se sheqeri ndikon më shumë në rritjen e tensionit të gjakut, si dhe nxit sëmundjet e zemrës dhe goditjen në tru. Në luftën për të parandaluar sëmundjet e zemrës, ekspertët paralajmërojnë rreziqet, sidomos atë të lidhura me fruktozën.

Sëmundjet e zemrës janë shkaku i parë në botë për vdekjet e parakohshme. Tensioni i lartë i gjakut është faktori i rrezikut më i madh.

Këshillat e mjekëve për të ulur tensionin e lartë të gjakut janë përqendruar gjithnjë në uljen e sasisë së kripës. Por mjekët tashmë thonë se ulja e konsumit të kripës ndikon më pak sesa sheqeri në uljen e tensionit të gjakut. Disa tregues sugjerojnë se 3-6 g kripë në ditë janë mjaftueshëm për shëndetin, por në fakt, gjithçka më pak se 6 g është e dëmshme.

Shumica e kripës në ushqimin e njeriut vjen nga ushqimet e përpunuara, të cilat gjithashtu përbëjnë një burim për marrjen edhe të sheqerit.

"Sheqeri mund të jetë më i lidhur me tensionin e gjakut sesa sodiumi. Provat bindëse tregojnë se sheqeri dhe veçanërisht fruktoza monosakaride luan një rol të madh në zhvillimin e hipertensionit.

Për më tepër, studimet tregojnë se sheqeri në përgjithësi dhe fruktoza në veçanti mund të kontribuojnë në një rrezik më të madh për sëmundjet e zemrës përmes mekanizmave të ndryshëm.

Kërkuesit e vënë gishtin sidomos tek ëmbëlsuesi që përdoret për ushqimet e përpunuara, veçanërisht tek lëngjet e frutave dhe pijet e gazuara.

Në studim thuhet: "Në gjithë botën ëmbëlsuesi i pi-jeve është i përfshirë në 180 000 vdekje në vit".



Arbëria
Design



Të gjitha në një vend!

- Studio dizajni
- Shtypshkronjë
- Shtyp - sitë (screen printing)
- Shtypi në format të madh
PVC • Tekstil • Billboard
- Reklama ndriçuese
- Organizimi i fushatave
promovuese
- PR dhe Marketing

TETOVË - R. e Maqedonisë
Tel. +389 44 35 33 70
www.arberiadesign.com



N.T.P. MAHMUT-HOLDING

Samettin Taç - Nazim Taç

Dewilux®
SPECIALIST IN PAINT
NGJYRA DHE LLAQE E SPECIALIZUAR

NGJYRNA - LLAQE - PJESE TË MOBILAVE DHE MEDIJAPAN
BOYA - VERNIK - MOBILYA AKSESUARI VE MEDIYAPAN

- SAMET LLAGERA PËR FIOKA
- MEDIJAPAN
- KËND MALLTERIT
- KËND ME RRJET
- KËNDE KNAUFIT NGA ALUMINI
- RRJETA PËR FASADË



KALE
SUNTA VIDASI

YapaS



MOBELLUX



eskim

smirdex
COATED ABRASIVES INDUSTRY



Mob: +377 044 242 468
+377 044 230 751
+377 044 339 452
+377 044 390 538

Turk/Mob: +90 537 887 1210

Lagja Arbanë Prizren
mahmut_holding@hotmail.com



Hayatın Tatlı Yanı...





"LUX DEKOR"

Lux Dekor është firmë private e specializuar për prodhimin e kuzhinave si dhe orendive të ndryshme shtëpiake dhe të zyreve. Bën shitjen e materialit: iverëpllaka, MDF, folje për vakumpress, dhe të aksesuarëve përcjellëse për mobiljeri. Bën prodhimin e balloreve – mvëshjen me ultrplast – laminat, si dhe plastifikimin vakumpres – ballonpress të balloreve me folje të pvc-se në dimensione të kerkuara nga klienti, gravirimin e fronteve me makinë CNC, kandimin –qitjen e shiritëve pvc dhe abs, prerjen e pllakave, të gjitha keto kryhen me makina të persosur kualitet dhe cilësi të lart.



Gravirimin e fronteve
me makinë CNC
Aksesora për mobiljeri
Folje për vakumpress
Shirit PVC
Shirit ABS
Iverëpllaka
MDF



Kuzhina



Paradhoma



Komoda



Tavolina




Dhoma e thjeshtë




MDF panelet dekoruese

*Blerësi / kënaqur
ne edhe më të kënaqur!*



ÇAPA[®] musluk



REYHAN

Kosovë për herë të parë
me 5 vjet garanci

N.T.SH. REYHAN
Distributor për KOSOVË

Të gjitha llojet e baterive, rubinetave të CAPA mund
t'i gjeni tek firma N.T.Sh. REYHAN - Prizren.
Si dhe mund të gjeni edhe nëpër lokale të tjera
në KOSOVË

**ELEGANCË, BUKURI, CILËSI
DHE 5 VJET GARANCI
ME ÇMIME TË VOLITSHME**



ISO 9001



5 ★★★★★
Yıl Garanti

www.capamusluk.com.tr

www.reyhan-ran.com

Armatürde Dünyaya Vurulan Marka

Rr:UCK, Pn Tel: + 381 29 225 555
Prizren - KOSOVË Mob: + 377 44 115 238

Shitje me shumicë mund të kontaktoni
përmes telefonave dhe web faqes.

Prodhimet me të cilat kemi fituar SHPËRBLIMIN KOSOVAR TË PRODUKTIT TË QUMËSHITIT 2005



KONSUMONI PRODUKTE ME CILËSI TË VËRTETUAR

CILËSI E VËRTETUAR



Jogurtat me përmbajtje
të kulturave *Bio Active*
Në Kosovë prodhohet
vetëm nga qumështorja "ABI"

Probiotic
drink



www.abimilk.com

Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

Adresa-Address: "Tirana" N:9, Prizren
Tel & Fax: +381 29 622 356
E-mail: abi@abimilk.com

www.abimilk.com

Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

"ABI" është licensuar nga ana e Agjencisë Veterinare e Ushqimit të Kosovës

Numri i licencës : AVUK-001

"ABI" ka fituar të drejtën për eksport me numrin eksportues : KS-033